



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 195 Akti

Nr. 287 Vendimi
Tiranë, më 4.8.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z.Branko Hrvatin, në datën 16.7.2020, ora 15:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anita Mici**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i

rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Durrës referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë/Gjyqësor (në vijim KLGj).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 17.9.2018, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, do t’i nënshtruhej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Olsi Komici, dhe Brunilda Bekteshi. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 24.9.2018, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Anita Mici, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 12.11.2018, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjektii rivlerësimit deklaroi përmes postës elektronike marrjen dijeni për njoftimin dhe trupin gjykues dhe në datën 16.10.2019, deklaroi dhe mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 26.6.2020 Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Mici, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 29.6.2020, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe për të sjellë prova për

të provuar të kundërtën brenda 10 (dhjetë)ditëve. Në datën 9.7.2020, subjekti i rivlerësimit dërgoi prapësimet/observacionet në mënyrë elektronike dhe zyrtare¹.

8. Në datën 13.7.2020, trupi gjykues, me vendimin nr.3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Mici, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.7.2010, në orën 15:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Në datën 24.7.2020, me kërkesë të anëtarit të trupit gjykues, me vendimin nr. 4, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ dhe po në të njëjtën datë njoftoi dhe subjektin e rivlerësimit.

10. Në datën 30.7.2020, trupi gjykues, me vendimin nr.5, vendosi mbylljen e hetimit administrativ, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit po në të njëjtën datë me këtë vendim, si dhe duke e njoftuar se seanca për shpalljen e vendimit do të rifillonte në datën 4.8.2020, ora 9:30.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Mici, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtare, z.Branko Hrvatit. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Mici. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 16.7.2020, për të rifilluar në datën 4.8.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Anita Mici ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe kreun IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në

¹ Me nr. hyrje në Komision nr. *** prot., datë 10.7.2020.

Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja, është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, e cila është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2004, me nr.04773 indeksi, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2004 – 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (dh) argumentimet me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

³ Me nr. ***prot., datë 21.5.2018.

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 25.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:

1. Automjet tip “Fiat Cinquecento”, blerë me kontratën nr. ***, datë 8.9.2003, në vlerën 100.000 lekë. Burimi i krijimit: nga të ardhurat. Pjesa zotëruese: 100%.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁴ kontratë shitje nr. ***, datë 8.9.2003.

1.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: përputhet deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur, me përgjigjen e DPSHTRr-së.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ dhe vlerësimi i trupit gjykues

1.2 Subjekti e deklaron për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2004 me përshkrimin “*autoveturë tip Fiat Cinquecento, targa ***, vlera 200.000 lekë*”.

1.3 Për këtë automjet subjekti ka depozituar kontratë shitje nr***, datë 8.9.2003, me palë shitëse shtetasin Z. H. dhe blerës A. H., me çmim 100.000 lekë, shumë kjo që sipas aktit kontraktor i është likuiduar shitësit nga blerësi, jashtë zyrës noteriale. Automjeti i deklaruar është pasqyruar me targa *** dhe nr. shasie ***.

1.4 DPSHTRr-ja me shkresën nr. ***, datë 21.12.2018, informon se shtetësja Anita Mici ka pasur në pronësi mjetin me targa *** (i cili figuron me statusin çregjistrim i përhershëm).

1.5 Nga dokumentacioni i administruar nga kjo drejtori, rezulton se automjeti tip “Fiat Cinquecento” është zhdoganuar në datën 24.10.2003. Në deklaratën doganore, vlera e automjetit është 200.000 lekë dhe mbi këtë vlerë janë përlllogaritur detyrimet doganore, të cilat rezultojnë në shumën 151.250 lekë.

1.6 Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se shuma e detyrimeve doganore (tvsh+taksa) është paguar po në këtë datë (24.10.2003) nga shtetësja Anita Mici në Bankën e Kursimeve.

1.7 Në praktikën e dërguar nga DPSHTRr-ja, për të njëjtin automjet (me nr. shasie ***) rezultoi se ekzistonte, gjithashtu edhe një kontratë shitje nr***, datë 20.10.2003, me palë shitëse shtetasin E. K. dhe palë blerëse shtetasen Anita Mici me çmim shitje 120.000 lekë.

1.8 Subjekti, pasi është pyetur⁵, ka depozituar përsëri kontratën e shitjes nr. ***, datë 8.9.2003, me palë shitëse Z. H. dhe blerës A. H., si dhe kontratën e mëparshme nr. ***, datë 14.5.2003, me palë shitëse shtetasin E.K. dhe blerës shtetasin Z.H. . Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 8.9.2003, çmimi i shitjes figuron 100.000 lekë.

1.8.i Nga Komisioni u konstatua se subjekti kishte nënshkruar dy kontrata për të njëjtën pasuri me shitës të ndryshëm, por edhe në vlera të ndryshme. Subjekti pasi është pyetur, ndër të tjera, ka shpjeguar⁶: “...ishte nevoja e zhdoganimit të automjetit që çoi në përpilimin në atë kohë të një kontratë formale (pa pagim çmimi) me shtetasin E. K., pasi vetëm personi që ka futur mjetin nga jashtë mund ta shiste, ku shifra e vendosur 120.000 lekë nuk përfaqëson çmim shitje, pasi vlera e shitjes i ishte paguar shitësit Z. H. . Nga dosja e automjetit, del qartë se ky automjet nuk mund të kishte kurrsesi vlerë më të madhe, pasi dhe në origjinë nga shtetasja italiane E.C., i është shitur shtetasit E. K. në vlerën e 500 euro (gjashtëdhjetë mijë lekë sipas kursit të kohës), sepse automjeti kishte nevoja riparimi.

Rideklaroj se unë automjetin e kam blerë nga shtetasi Z. H. për çmimin 100.000 lek dhe automjeti më pas është zhdoganuar dhe rregjistruar në emrin tim, duke u përdorur kontrata

⁴ Aneksi nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Pyetësor nr.2, datë 9.1.2020.

⁶ Në pyetësorin nr. 5, datë 6.4.2020.

formale e nënshkruar me shtetasin E. K. ...përsa kërkohet të saktësohet nga ana Juaj, deklaroj se për këtë automjet kam shpenzuar masën e çmimit të blerjes prej 100.000 lek, plus vlerën e zhdoganimit 151.250 lek dhe shpenzimet për taksat dhe riparimet e nevojshme të automjetit për t'u bërë funksional, të cilat shkojnë në total në shumën e deklaruar në deklarin periodik të vitit 2004...Në deklaratën Vetting kam deklaruar vetëm çmimin e blerjes sipas kontratës së datës 08.09.2003 (pa përfshirë shpenzimet e tjera), sipas mënyrës së të kuptuarit të ligjit në bërjen e këtij deklarimi, në referim të kontratës së shitblerjes, ndërsa në deklarin periodik kam deklaruar të gjithë shumën e shpenzuar për këtë automjet, ku janë përfshirë çmim blerje, doganë e paguar, taksa rregjistrimi dhe shpenzime riparimi, duke qenë në çdo rast në kushte sinqeriteti në raport me deklarin”.

1.8.a Trupi gjykues, pas shpjegimeve të subjektit në pyetësor dhe analizimit të veprimeve të kryera prej saj për kalimin e automjetit në pronësi, i konsideron bindës argumentet e subjektit lidhur me nënshkrimin e dy kontratave. Vlerësohet se subjekti është gjendur në kushtet e diktimit të lidhjes së kontratës me pronarin e parë të automjetit, shtetasin K., me qëllim zhdoganimin e mjetit, fakt i provuar me pagesën prej saj në datën 24.10.2003, vetëm katër ditë nga lidhja e kontratës me këtë shtetas, pavarësisht marrëdhënies së formalizuar për blerjen e automjetit me shtetasin Z. H., sipas të cilës edhe ka shlyer pagesën prej 100.000 lekësh. Për sa kohë u provua që shtetasi E.K. kishte shitur më parë automjetin te shtetasi Z.H., është e kuptueshme që subjekti marrëdhënien reale të blerjes së pasurisë do të duhej ta bënte me pronarin e fundit, sikurse edhe ka vepruar. Ndërsa për veprimin e radhës, për zhdoganimin e automjetit, subjektit i duhej t'i drejtohej pronarit të parë të automjetit (si administruesi i dokumentacionit përkatës të tij), pasi sipas ligjit⁷ ai ose blerësi prej tij, mbartin detyrimin ligjor për të kryer këtë veprim dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit mbi veprimet e kryera.

1.9 Për sa më sipër, Komisioni përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare sipas të dhënave të pasqyruara në kontratën e datës 8.9.2003, ku çmimi i shitjes rezulton në vlerën 100.000 lekë dhe sipas dokumentacionit të DPSHTRr-së ku detyrimet doganore për zhdoganimin e këtij mjeti janë në shumën 151.250 lekë. Pra, në total vlera e shpenzuar për këtë pasuri të luajtshme rezultoi të ketë qenë në shumën 251.250 lekë.

1.9.i Në përlllogaritjet e kryera nga Komisioni janë marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga viti 2000 – tetor 2003, shpenzimet e qirasë⁸ dhe blerja e automjetit. Shpenzimet e jetesës nuk janë marrë në konsideratë për këtë periudhë si balancim i ndihmës së dhënë nga vjehri⁹ i subjektit për djalin e tij (bashkëshorti i subjektit) gjatë kohës që ishte me studime në vitet 2001 – 2005.

- ✓ Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave për këtë pasuri, si dhe përlllogaritjeve financiare të kryera, trupi gjykues arrin në konkluzion se në tërësi nuk konstatohen problematika për këtë pasuri dhe se subjekti ka pasur burime të ligjshme për përfitimin e saj.

2. Llogari rrjedhëse, në “Alpha Bank”, me gjendje në vlerën 2.095 lekë, në datën 23.1.2017. Pjesa zotëruese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur¹⁰ deklaratës, deklaratën datë 23.1.2017, nga “Alpha Bank”, ku konfirmohet se znj. Anita Mici disponon llogari me gjendje në vlerën 2.095 lekë.

⁷ Të kohës, nr. ***, datë 27.1.1999, si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.

⁸ Referojuni përgjigjes së dhënë nga subjekti në pikën 5.2, te pasuria nr.5.

⁹ Kontributi i dhënë është trajtuar në pikën nr.13 dhe pasqyrohet sikurse këtu edhe në analizën financiare të kryer për gjithë periudhën e rivlerësimit.

¹⁰ Aneksi nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

2.1 ILDKPK-ja në raportin e saj është shprehur: përputhet deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur, me përgjigjen nga “Alpha Bank”.

2.2 Nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni, “Alpha Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2018, konfirmon gjendjen në vlerën 2.095,59 lekë në logarinë e znj. Anita Mici në datën 23.1.2017.

- ✓ Trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e marrë nga “Alpha Bank”.

3. Llogari rrjedhëse, në “Raiffeisen Bank”, me gjendje në datën 23.1.2017, 1.324 lekë, në pjesë zotëruese 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur¹¹ deklaratës, nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 23.1.2017, ku konfirmohet se znj. Anita Mici disponon llogari, me gjendje në vlerën 1.324 lekë.

3.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht deklarimi i përket datës 23.1.2017, ndërsa përgjigja i përket datës 25.1.2017.*

3.2 Nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni, “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, informon se gjendja në datën 23.1.2017 rezulton në shumën 924,3 lekë.

- ✓ Trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ, konstatoi se deklarimi i subjektit nuk përputhej me statement të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, për shkak se subjekti nuk kishte përfshirë në deklaram komisionet e fund muajit të mbajtuara nga banka, pasaktësi për të cilat konkludon se për qëllim të vlerësimit të këtij procesi, nuk sjellin pasoja ndaj subjektit.

Deklarimi i detyrimeve

4. Kredi e përfituar në NBG, sipas kontratës së kredisë nr***, datë 10.4.2006, në shumën 45.000 euro, për blerje apartament banimi. Subjekti ka deklaruar se detyrimi i mbetur pa shlyer në datën 16.1.2017 është në vlerën 30.414 euro. Subjekti ka depozituar, vërtetimin datë 16.1.2016 të NBG-së, si dhe i ka bashkëlidhur deklaratës¹² disa dokumente.

4.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: përputhet deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur, me përgjigjen e NBG-së.

4.2 Nga korrespondenca e mbajtur nga Komisioni, ABI Bank (ish-NBG) me shkresën nr. *** prot., datë 24.12.2018, ka konfirmuar kredinë¹³ e marrë në shumën 45.000 euro, me detyrim të mbetur deri në datën 16.1.2017 në shumën 30.414 euro.

- ✓ Trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e marrë nga ABI Bank.

5. Në lidhje me shtëpinë e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. J. H., me adresë: Blv. “***”, pranë KESH, Tiranë, për të cilën subjekti ka deklaruar se ka jetuar prej vitit 2006 së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët. Kjo rrethanë është vërtetuar nëpërmjet deklaratës noteriale, nr. ***, datë 24.1.2017, të lëshuar nga vëllai i subjektit.

¹¹ Aneksi nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Kontratë kredie me NBG, nr. ***, datë 14.3.2006+ praktika e kontratës; Vërtetim nr. ***, datë 16.1.2016, nga NBG Aneksi nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³ Për të cilën arsyetohet në vijim në pikën nr. 9.8.1

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se *kolateral* për marrjen e kredisë në NBG, në shumën 45.000 euro është po kjo banesë, pasi apartamenti i porositur nuk ka qenë dhe nuk është regjistruar në hipotekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹⁴.

5.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

5.2 Subjekti ka deklaruar vendbanimet e saj nga viti 2004– 2006, si vijon :

- Në deklaratën e vitit 2004, subjekti ka deklaruar : *Njësia Administrative nr. ***, Bashkia Tiranë, adresa Rruga “***”, pranë KESH.*

- Në deklaratën e vitit 2005, subjekti ka deklaruar : *Njësia Administrative nr. ***, Bashkia Tiranë, adresa Rruga “***”, pranë KESH.*

- Në deklaratën e vitit 2006, subjekti ka deklaruar : *Njësia nr. ***, Rruga “***”, pranë KESH.*

Në funksion të këtij deklarimi, subjekti është pyetur¹⁵ se ku ka jetuar përgjatë periudhës 2002 – 2005, nisur edhe nga fakti se shtëpia e vëllait rezulton të jetë blerë në dhjetor të vitit 2005.

- Në përgjigjen e dhënë subjekti ka sqaruar se *në periudhën 2002–2005 ka jetuar me qira (marrëdhënie juridike verbale e ripërtërirë) në një banesë tjetër, me qiradhënës shtetasit A. S. dhe V.S. (bashkëpronare të banesës). Shuma e qirasë mujore e paguar gjatë gjithë kësaj periudhe ka qenë 7.000¹⁶ lekë/muaj. Me shtetasit A. dhe V. S. gjatë periudhës së mësipërme, bazuar në nenin 83/4 të Kodit Civil, i cili parashikon se: “Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë”, kemi lidhur kontrata verbale, me ripërtëritje verbalisht çdo vit. Ligji civil ka lejuar dhe lejon lidhjen pa shkresë të kontratës së qirasë për kohëzgjatje deri në një vit dhe ne si palë kemi vepruar bazuar në këtë dispozitë ligjore, duke ripërtërirë veprimin juridik vit pas viti.*

- Subjekti për të provuar këtë fakt, ka depozituar deklaratën noteriale të shtetasve A. dhe V. S. me nr. ***, datë 30.4.2020, si dhe kontratën e porosisë së këtyre shtetasve, datë 5.10.2000.

5.3 Në vijim të hetimit për këtë pasuri, Komisioni nisur nga fakti që subjekti dhe vëllai i saj reciprokisht kanë deklaruar përdorimin e apartamentit nga subjekti prej dhjetorit 2005, bazuar në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr.84/2016, ka vlerësuar se shtetasi J. H. kategorizohet në rrethin e personave të tjerë të lidhur dhe jo vetëm për këtë shkak, por edhe për të shteruar çdo mundësi hetimi gjithë përfshirës me qëllim verifikimin e ekzistencës së mundëshme të ndonjë tjetër rrethane që mund të ngrinte dyshime mbi përfshirjen e subjektit *de facto* në të drejtat reale të kësaj pasurie, ka zgjeruar, më tej hetimin administrativ lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në emër dhe për llogari të tij.

5.3.1 Komisioni e ka pyetur¹⁷ subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Nëpërmjet përgjigjeve përkatëse, subjekti ka depozituar sa vijon:

- Deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.1.2020, të shtetasit J.H. ku deklaroi se për blerjen e pasurisë nr. ***, z.k. ***, me sip. 95.2 m², Tiranë, ka përdorur kursimet nga puna përgjatë viteve 2002– 2005 në Itali, në shumën 15.000 euro dhe pjesën tjetër prej 18.000 euro ia ka marrë hua motrës, znj.B.H. .

¹⁴ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.1.2017; permesso di Soggiorno nr. ***; vërtetim hipotekor për pasurinë e llojit apartament me sip. 95.12 m², në pronësi të J. H. + fotokopje letërnjoftimi + fotokopje letërnjoftimi italiane (Aneksi nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së).

¹⁵ Referojuni pyetësorit nr.5, datë 6.4.2020.

¹⁶ E përlllogaritur në zërin *shpenzime* në analizën financiare.

¹⁷ Me pyetësorin nr. 2, datë 9.1.2020.

- Deklaratën noteriale nr. ***, datë 17.1.2020, të shtetases B. H. ku deklarohet se nga të ardhurat dhe kursimet që ka siguruar nga puna përgjatë viteve 2001– 2005 si rezidente në Itali ka ndihmuar vëllain J. H. duke i dhënë *cash* shumën prej 18.000 euro për blerjen e një apartamenti banimi të ndodhur në Tiranë.
- Dokumentacion nga INSP Itali¹⁸ për shtetasit J.H. dhe B. H. në lidhje me të ardhurat e siguruar për periudhën 2001 – 2005 .
- Kontratë shitblerje nr. ***, datë 27.12.2005, me palë shitëse V. A. dhe blerës J. H. . Apartament me sip.95.12 m². Çmimi i shitjes është 3.950.000 lekë, shumë e cila pasqyrohet të jetë paguar tërësisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës.
- Mandatarkëtimi nr. ***, datë 7.7.2006, sipas të cilit është paguar shuma 39.500 lekë nga shtetasi V. A., për kontratën e shitjes nr***, datë 27.12.2005, si 1% mbi shumën e shitjes së pasurisë në vlerën 3.950.000 lekë.

5.3.1.a Komisioni ka vërejtur se me deklaratën nr***, datë 14.1.2020, dhënë nga vëllai i subjektit gjatë hetimit administrativ, deklarohet se në blerjen e pasurisë ka përdorur kursimet e tij nga puna përgjatë viteve 2002 – 2005 në shumën 15.000 euro dhe pjesën tjetër prej 18.000 euro e ka marrë hua nga motra e tij, znj. B.H. . Në ILDKPKI është depozituar deklarata nr. ***, datë 24.1.2017, ku ka deklaruar se apartamenti është blerë me të ardhurat nga puna e tij si emigrant në shtetin italian.

- Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime¹⁹, lidhur me këto deklarime.

- Në parashtrimet e saj, subjekti ka sqaruar: “ ...në vitin 2017, J., vëllai i saj, e ka sqaruar se në datën 24.1.2017 ka deklaruar burim të ardhurash për blerjen e apartamentit kursimet e tij nga puna në Itali, pa u thelluar në huan që kishte marrë nga motra B., *fakt për të cilën dhe unë (ka thënë ajo) nuk kam qenë në dijeni si një marrëdhënie mes tyre si motër e vëlla. Në momentin që nga Komisioni u vlerësua se rasti i vëllait konsiderohej person tjetër i lidhur, kam komunikuar me vëllain për detaje mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave për apartamentin e blerë nga ai, dhe bashkë me motrën më kanë deklaruar marrëdhënien e huasë ndërmjet tyre, ku për pasojë nga ana Juaj janë verifikuar me provat e paraqitura nga ana ime, edhe mundësia e motrës B., për të huazuar vëllanë tonë në këtë shumë”.*

5.4 Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve dhe dokumentacionit të administruar, përse kohë ka konstatuar se titullar i pasurisë është vëllai i subjektit dhe njëkohësisht për shkak të marrëdhënies së krijuar mes tyre ka marrë edhe tagrin e personit tjetër të lidhur, vlerëson se deklaratat e bëra në raport me këtë të fundit i përkasin një marrëdhënie të posaçme familjare. Në këtë rast huaja e dhënë nga motra B. në favor të vëllait të subjektit, ndikon në një pasuri të cilën subjekti e ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike se e ka përdorur pa krijuar kështu dyshime mbi legjitimitetin e vëllait të saj në këtë pasuri.

5.5 Në vijim, Komisioni hetoi mbi mundësinë financiare të vëllait të subjektit, shtetasit J. H., si dhe të huadhënëses shtetases B. H. .

5.6 Në analizim të të ardhurave për shtetasin J.H., sipas dokumentacionit të depozituar, Komisionit i rezultoi siç pasqyrohet në tabelën, si vijon:

¹⁸ Instituti i sigurimeve shoqërore, Itali.

¹⁹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Tabela nr. 1

J. H.		
Data	Shuma në euro	Përshkrimi
10/06/2002-09/09/2002	2,043.00	punë vartëse
01/09/2002-31/12/2002	5,206.00	punë vartëse
01/01/2003-03/07/2003	8,437.00	punë vartëse
01/07/2003-31/12/2003	1,547.00	Stazhist
01/01/2004-31/12/2004	3,316.00	Stazhist
01/01/2005-07/01/2005	156.54	Stazhist
TOTALI	20,705.54	

5.7 Komisioni ka konstatuar se shuma e të ardhurave prej 20.705,54 euro është e mjaftueshme për të kursyer shumën prej 15.000 euro dhe se nga kjo shumë mbeten rreth 5.700 euro për të përballuar jetesën.

5.8 Duke iu referuar EUROSTAT²⁰ mbi minimumin jetik për nivel varfërie për një person në Itali, u vërejt që shpenzimet vjetore të jetesës janë më të larta se sa çfarë kishte në dispozicion shtetasi H. pas kursimit prej 15.000 euro.

Tabela nr. 2

Minimumi jetik për një person (sipas Eurostat)	
Viti	Vlera në euro
2001	6,240
2002 ²¹	
2003	
2004	8,179
2005	8,584

5.9 Në këtë kontekst, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime²²:(i) lidhur me mundësinë e përballimit të shpenzimeve jetike të vëllait të saj, z.J. H., duke iu referuar minimumit jetik sipas EUROSTAT, në raport me të ardhurat e përfituara dhe kursimin e realizuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

5.10 Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e saj ka shpjeguar se vëllai i saj, z.J. B. H., është kthyer nga Italia në gusht të vitit 2005 dhe në datën 27.9.2005 ka çelur llogari bankare në “Tirana Bank”, duke depozituar *cash* shumën 15.000 euro, me burim të ardhurash kursimet e tij për periudhën 2002– 2005 në shtetin italian. *Kjo depozitë bankare rezulton të jetë krijuar në kohë, para fillimit definitivisht të detyrës sime si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku unë kam marrë emërimin përfundimtar, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës.*

*- Nga ana tjetër, kjo shumë për blerjen e apartamentit nga vëllai im, pasi J., vëllai vendosi të blejë një apartament, duke lidhur kontratë shitblerje nr. ***, datë 27.12.2005, me palë shitëse shtetasin V. A. dhe blerës J. H., në datën 5.12.2005 ka tërhequr cash shumën 14,000 euro (dhe diferencat rreth kësaj kohe), të cilat i ka përdorur për blerjen e apartamentit. Në vetë përmbajtjen e kësaj kontrate, përcaktohet qartë se çmimi i shitjes është paguar nga blerësi*

²⁰ https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li01&lang=en.

²¹ Nuk ka të dhëna për vitin 2002 dhe 2003.

²² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

paraprakisht jashtë zyrës noteriale. Në të njëjtën mënyrë ai ka paguar të gjithë çmimin e shitjes, pra, edhe shumën prej 18.000 euro të marra hua nga motra B. H. .

- Përsa i përket shpenzimeve të jetesës së vëllait të saj në Itali, përgjatë periudhës që ka kursyer shumën prej 15.000 euro, për të cilat i janë kërkuar shpjegime, subjekti ka parashtuar se siç e ka sqaruar i vëllai (ka vënë në dispozicion dhe prova), që nga momenti i vajtjes së tij si emigrant në Itali (vetëm 17 vjeç në atë kohë) dhe deri në largimin e tij në gusht të vitit 2005, për gjithë periudhën e qëndrimit, shpenzimet e jetesës përfshirë dhe banimin e tij, janë përballuar nga djali i xhaxhait të tyre, shtetasi R.H. H., i cili jetonte dhe ishte rezident më parë në kohë dhe ka pasur mundësi të plota e të ligjshme financiare për të mbuluar shpenzimet jetike të vëllait të saj.

- Subjekti ka paraqitur dokumentacion për të provuar bashkëjetesën e vëllait me shtetasin R.H., si dhe mundësinë financiare të këtij të fundit për të mbuluar shpenzimet e jetesës. Subjekti ka sqaruar, gjithashtu, se në atë periudhë emigrimi, vëllai i saj ka pasur mbështetjen e kushëririt të tij, në kuadër të marrëdhënieve të afërta ndërmjet tyre, ka qenë dhe i punësuar prej tij, si dhe në vijimësi për periudhën më pas, është zënë me punë në mënyrë sezonale nga djali i xhaxhait, duke plotësuar dhe kushtet ligjore të shtetit Italian për pajisjen me dokumentacion të përhershëm qëndrimi atje. Në këto rrethana, ka shpjeguar subjekti, *vëllai im ka pasur plotësisht të mundur të kursente shumën e mësipërme, pasi nuk ka patur shpenzime jetese për të kryer.* Gjithashtu ka deklaruar se niveli i jetesës që emigrantët kanë zgjedhur të bëjnë në shtetin italian për shkak të nevojave ekonomike, ka qenë tejet minimal.

- *Shtëpia e vëllait tim ku ne banojmë, ka një sipërfaqe të vogël dhe aktualisht me ardhjen e djalit të jetojë me ne nga viti 2019, për shkak të ndjekjes së fakultetit, kushtet e banimit nuk janë më të përshtatshme, pasi djali është 19 vjeç dhe ka nevojë për hapësirë e tij, ndërkohë që dhe vajza po bën 10 vjeç. Aktualisht jemi në kërkim të një banese më të madhe me qira, por duke dashur të mos i ikim lagjes, për shkak të fqinjësisë së mirë që kemi krijuar, komunitetit të qetë që përfshin lagja, jemi në pritje të gjetjes së një apartamenti aty afër.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

5.11 Trupi gjykues, për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në raport me dokumentacionin e administruar dhe shpjegimet e dhëna, lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie dhe burimin eligjshëm të krijimit të saj, arsyeton si vijon:

- Në ndryshim nga statusi i motrës së subjektit në marrëdhënien e huas me vëllanë e saj, për blerjen e kësaj pasurie, ky i fundit për qëllim të këtij vlerësimi, është kategorizuar si person tjetër i lidhur, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr.84/2016. Për pasojë edhe hetimi administrativ përmbledh një fushë më të gjerë arsyetimi dhe kërkimi lidhur me verifikimin apo përjashtimin e përfshirjes së subjektit në posedimin *de facto* të ndonjë të drejte reale mbi këtë pasuri të vëllait të saj, duke kaluar edhe nëpërmjet provueshmërisë së burimit të ligjshëm të krijimit të shumës 15.000 euro paguar prej tij për krijimin e pasurisë, por jo me të vetmin fokus mbi këtë pikë, pavarësisht faktit që Komisioni e ka ftuar subjektin që të japë shpjegime vetëm lidhur me provueshmërinë e shpenzimeve të kryera nga i vëllai në raport me të ardhurat e siguruara. Kjo, për shkak se të gjithë këta komponentë shihen të gërshetuar me njëri-tjetrin për t'i mundësuar Komisionit një vlerësim më të plotë dhe objektiv lidhur me marrëdhënien konkrete që subjekti ka pasur me këtë pasuri.

- Në një vështrim të përgjithshëm, teoria e faktuar, *se për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të një shume, duhet të ndalemi në kohën në të cilën ka ndodhur veprimi dhe të konkludojmë nëse në atë moment kanë rezultuar të dhëna në vlerë monetare të ligjshme aq sa të mund të justifikojnë shumën e përdorur, në këtë rast shumën 15.000 euro, pavarësisht shpenzimeve të kryera, qëndron, madje kjo bëhet më e pranueshme në vlerësimin e burimit të*

krijimit të shumës së dhënë nga motra e subjektit në favor të vëllait të saj. Por për efekt të këtij procesi, në kontekstin që vëllai i subjektit i nënshtrohet zbatimit të ligjit nr. 84/2016 edhe shpjegimet e dhëna prej tij, si edhe dokumentacioni i depozituar, duhet të analizohen dhe të krijojnë bindjen mbi përmbushjen e detyrimit ligjor të parashikuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

- Në vijim të kësaj logjike, trupi gjykues ka kërkuar shpjegime nga subjekti mbi mundësinë e krijimit të shumës së kursyer prej tij, e përdorur për blerjen e pasurisë në dhjetor të vitit 2005.

- Nga analizimi i dokumentacionit rezultoi e provuar se pasuria është blerë në dhjetor të vitit 2005 me kontratën e shitjes nr. ***, datë 27.12.2005.

- Po ashtu, rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit në kohën e blerjes së kësaj pasurie sapo kishte marrë detyrën e gjyqtarës²³, rrethanë kjo që së bashku me konstatimet e tjera e përjashton subjektin nga lidhja me këtë pasuri.

- Megjithatë, trupi gjykues për të krijuar bindjen lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, hetoi çdo të dhënë të grumbulluar dhe dokumentacion të depozituar nga subjekti, nga ku u provua se:

i) Shuma e derdhur nga shtetasi J.H. në llogari bankare (15.000euro) është transaksion i kryer përpara emërimit të subjektit në detyrë.

ii) Shuma tjetër 18.000 euro është paguar po në të njëjtën kohë për vetë faktin se me formalizimin e kontratës së shitjes së pasurisë thuhet shprehimisht se shuma është shlyer paraprakisht jashtë zyrës noteriale, dhe prej këtij momenti kjo pasuri është regjistruar në hipotekë²⁴ në emër të vëllait të subjektit.

iii) Nga analiza e dokumenteve²⁵, që subjekti depozitoi së bashku me prapsimet, për të provuar se i vëllai kishte jetuar te djali i xhaxhait të saj, shtetasi R. H. me nënshtetësi italiane, dhe se nuk kishte shpenzuar, rezultoi se punonte prej vitesh në shtetin italian dhe se në periudhën 2001 – 2004 kishte siguruar të ardhura të ligjshme deri në shumën 127.238 euro. U vërejt se dokumentacioni qartëson se kishte konsoliduar punësimin e tij nëpërmjet ushtrimit të biznesit, çka nënkuptonte qëndrueshmëri në atë vend.

iv) Shuma prej 15.000 euro është depozituar në bank pak kohë pasi z. J. H. është kthyer²⁶ në Shqipëri.

5.12 Në lidhje me kërkimin e bërë, subjektit për të dhënë shpjegime për personin tjetër të lidhur në funksion të provueshmërisë për të mundësuar kryerjen e shpenzimeve të jetesës.

- Nisur nga marrëdhëniet familjare, nga faktet dhe treguesit e lartpërmendur për shtetasin R.H., por edhe nga mosha e vëllait të subjektit, vetëm 17 vjeç, në kohën kur ka emigruar, bëhet bindës argumenti i subjektit se i vëllai ka qëndruar e jetuar në familjen e djalit të xhaxhait. Këtë fakt e ka pranuar edhe vetë shtetasi R. H. me deklaratën e tij noteriale datë 9.7.2020. Në të tilla kushte marrëdhënia familjare mes tyre dhe argumenti i bashkëjetesës së vëllait të subjektit në atë familje bëhen të besueshme. Qëndrimi në një familje të afërt farefisnore, përfshirë pagimin e shpenzimeve të jetesës sikurse edhe ka deklaruar shtetasi J. H., por edhe dhënia e mundësisë, vëllait të subjektit të rivlerësimit për t'u punësuar në aktivitetin e tij sipërmarrës të ushtruar prej vitesh në Itali, është një arsye më shumë për të besuar pagimin e shpenzimeve si dhe mundësinë

²³ Referuar vërtetimit nr. ***prot., datë 18.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës pasqyrohen pagesa përperiudhën janar-shtator 2005 dhe vërtetimit për pagën *neto* dhe *bruto* të Gjykatës së Rrethit Shkodër ku pasqyrohet pagesa për periudhën tetor 2005 - mars 2010 (Aneks 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁴ Sipas vërtetimit hipotekor administruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 9.1.2020.

²⁵ Formularë të subjektit R. H. që i përkasin periudhave tatimore ndër vite/prej vitit 2000(përfshirë edhe një formularë të vitit 1998 ku rezultoi i punësuar) në shtetin italian ku identifikohet me kod fiskal dhe me të dhëna të detajuara mbi të ardhura e shpenzime të shoqërisë, si dhe me detyrime kontributive të paguara.

²⁶ Sipas sistemit *TIMS* rezultoi se shtetasi H. ka hyrë në Shqipëri nga pika kufitare e Portit të Durrësit në datën 24.7.2005.

e kursimit të të ardhurave. Subjekti ka depozituar²⁷ nga INSP (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore) Itali, ekstraktin e llogarisë së kontributeve për pension paraprak të vëllait të saj, së bashku me shkresën përcjellëse të titullarit të INSP-së ku jepen shpjegime mbi të dhënat në ekstrakt. Të gjithë këto fakte dhe argumente mbështesin edhe veprimet bankare të kryera në vijim nga vëllai i subjektit. Më konkretisht, nga verifikimi i statementit bankar rezultoi se në shtator të vitit 2005 vëllai i subjektit ka mundur të sigurojë dhe ka depozituar shumën 15.000 euro, në “Tirana Bank” të krijuar nga kursimet e punësimit në shtetin italian. Kjo shumë e konkretizuar me gjurmë bankare rezulton e tërhequr pikërisht në dhjetor të vitit 2005 në kohën e blerjes së pasurisë. Nga një analizë logjiko-faktike e të gjithë këtyre elementeve të mësipërm, Komisioni vlerëson se shuma prej 15.000 euro, e deklaruar si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie, është disponuar edhe më herët se përdorimi i saj nga z. J. H., dhe rrjedh prej kursimeve të tij.

- Mbështetur në këto fakte dhe prova të analizuara, trupi gjykues çmon se subjekti:

- Ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe se personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. J.H. ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë në fjalë, pa cenuar përballimin e shpenzimeve jetike.

5.13 Në analizim të të ardhurave, për shtetasen B.H., sipas dokumentacionit të depozituar rezultoi, si vijon:

Tabela nr. 3

B. H.		
Data	Shuma në euro	Përshkrimi
01/09/2001-25/11/2001	3,493.31	punë vartëse
1/03/2002-30/10/2002	9,481.00	punë vartëse
01/03/2002-30/10/2002	456.34	sëmundje e paguar
01/03/2003-30/11/2003	9,260.00	punë vartëse
01/03/2003-30/11/2003	1,497.35	sëmundje e paguar
08/12/2003-31/12/2003	985.12	Papunësi
01/01/2004-06/05/2004	1,876.50	Papunësi
02/05/2004-26/06/2004	2,085.00	punë shtëpiake
27/06/2004-18/09/2004		punë shtëpiake
14/10/2004-31/12/2004	1,251.00	Papunësi
01/01/2005-16/04/2005	5,488.00	Papunësi
01/01/2004-31/12/2005	2,401.00	Papunësi
05/05/2005-14/11/2005	9,955.00	punë vartëse
TOTALI	48,229.62	

5.14 Vërehet se shuma prej 48.229,62 euro është përfituar për një periudhë prej 4 vjetësh, ku për vitet 2002, 2003 dhe 2005, pasqyrohet se ka marrë asistencë ose raport të paguar.

5.14.1 Në vijim të hetimit, subjekti është pyetur²⁸ lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 18.000 euro dhënë hua nga motra e saj – vëllait dhe ndër të tjera ajo ka cituar se ...*motra ime B. H., nuk më ka dhënë mua personalisht ndonje shumë hua apo falur, por ka huazuar vëllain tonë J. H. . Në lidhje me mundësinë e krijimit të shumës prej 18.000 euro nga motra ime B.H.,*

²⁷ Me pyetësin nr. 2, datë 9.1.2020, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Referojuni pyetësin nr. 5, datë 6.4.2020.

dhënë cash vëllait tim J.H., në raport me punësimet e motrës time për periudhën e krijimit të kësaj shume, kam paraqitur dokumentacion të detajuar, pikërisht për të qenë e plotë në sqarimin e këtij momenti (edhe pse ajo shumë huaje nuk më është dhënë mua si subjekt rivlerësimi). Sa i takon periudhën të asistencës, ky është një fakt i njëjtë për të gjithë shtetasit që kanë jetuar e punuar në të njëjtën zonë në Itali pasi, vendi është zonë turistike dhe punësimi ka qenë në hotelet e zonës (llinxha), të cilat kanë funksionuar me hapje sezonale, por që sipas ligjit punonjësit me kontratë pune të ligjshme (si dhe motra ime B.), paguheshin edhe për periudhën që nuk kishte fluks turistik dhe nuk ishin të zënë në punë, sipas detyrimeve ligjore për punëdhënësit në shtetin fqinj, ku një pjesë të pagës së punonjësve e mbulon shteti, me atë që quhet “diskubacion”. Edhe këto akte i kam paraqitur me të njëjtin qëllim, për të treguar se ajo ka patur të ardhura edhe gjatë kohës që nuk kishte punë faktike, dhe pagesa titullohej “asistencë”. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për përkrahje sociale të një personi të papunë, por për pagesë papunësie gjatë muajve të ndërprerjes së punës faktike, për shkak të vetë llojit të punës sezonale. Në një mbledhje të përfaqësuesve të të ardhurave që motra ime B. H. ka patur si individ i vetëm për periudhën 25.11.2001 deri me 14.11.2005 (pa përfshirë të ardhurat e muajit dhjetor 2005), rezulton shuma prej 48.228 euro, të ardhura të cilat duke patur parasysh edhe faktin se ajo ka qenë një person i vetëm, ka patur shpenzime minimale gjatë gjithë periudhës në shtetin fqinj, mundësojnë plotësisht dhënien e huasë vëllait në masën e 18.000 euro...

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

- Paraprakisht, në daljen në konkluzione, mbahet në vëmendje marrëdhënia e krijuar midis motrës së subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit, për llogari të këtij të fundit, në raport me provueshmërinë e ligjshmërisë që mbart subjekti i rivlerësimit për shkak të përdorimit të kësaj pasurie.

- Në këtë kontekst hetimi i të ardhurave të krijuara nga motra e subjektit të rivlerësimit, huazuar vëllait të saj për blerjen e kësaj pasurie, diktohet nga rrethanat ligjore të cilat në këtë rast nuk i japin huadhënësit/motrës së subjektit një status ligjor në raport me ligjin nr. 84/2016. Ligji i shtrinë efektet e tij deri te personi tjetër i lidhur, konkretisht deri te vëllai i subjektit të rivlerësimit. Por, pavarësisht rrethanave faktike e ligjore, Komisioni kreu hetimin e tyre nga ku u provua me dokumentacionin²⁹ e INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore) të shtetit italian, titulluar *për komunikimet certifikuese të llogarisë së sigurimeve*, se: (i) motra e subjektit të rivlerësimit kishte qenë e punësuar në shtetin italian dhe se për të ishin paguar kontribute për efekt pensioni; dhe se (ii) në katër vitet e punësimit të saj, përkatësisht 2001–2005, të ardhurat e realizuara në nivel zyrtar, rezultuan në shumën 48.230 euro.

Parë në kontekstin e llojit të punësimit (sezonal-turistik), trupi gjykues vlerëson se është mëse e kuptueshme se një marrëdhënie kontraktore punësimi e tillë mund t'i shtrijë efektet e saj edhe për periudha të cilat parashikohen si më pak produktive, sikurse është rasti i punësimit në një vend turistik ku fluksi i punës është sezonal.

- Trupi gjykues vlerëson bindës argumentin e subjektit se të ardhurat e përfituara me përshkrimin *papunësi* ose *në asistencë* nuk mund të konsiderohen si marrëdhënie punësimi e shkëputur nga punëdhënësi dhe e favorizuar nga shteti si asistencë sociale, për sa kohë ato varen nga lloji i punësimit.

- Parë nën dritën e objektivitetit, fokusi i hetimit drejtohet te fakti nëse të ardhurat e ligjshme të përfituara, duke zbritur shpenzimet e kryera, mundësojnë apo jo dhënien e shumës prej 18.000 euro. Ajo që konstatohet në këtë rast, është fakti se shuma e krijuar për një periudhë katër vjeçare, prej 48.230 euro, duke zbritur shpenzimet modeste të kryera nga motra e

²⁹ Me të cilin shtetases B. H. i është vënë në dispozicion nga drejtori përkatës në datën 18.11.2019, ekstrakti i llogarisë së sigurimeve. Dokumente të depozituara me pyetësin nr. 5, datë 6.4.2020.

subjektit, justifikon dhënien e shumës 18.000 euro vëllait të subjektit. Përtej çmuarjes me objektivitet, çdo hetim tjetër për të kryer përllogaritje të tjera duke përfshirë edhe shpenzimet e kryera nga e motra e subjektit në këtë shumë të përfutur, nën kontekstin se a do të mund të jepej shuma prej 18.000 euro, përtej vështirësisë teknike dhe mungesës së informacioneve të tjera, nuk do të ishte objektiv dhe as proporcional.

- Trupi gjykues në këtë analizë ka vlerësuar edhe faktin që motra e subjektit ka shfaqur përgjegjshmërinë/është treguar aktive për të paraqitur të dhëna e dokumente në favor të shqyrtimit të këtij procesi administrativ, megjithë ekzistencën e kushteve apo rrethanavetë cilat nuk i japin asaj një status detyrues në këtë proces. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se të ardhurat e përfutura nga punësimi i motrës së subjektit të rivlerësimit, të cilat konfirmohen në nivel ligjor janë të mjaftueshme për t'i dhënë vëllait të subjektit shumën prej 18.000 euro për blerjen e kësaj pasurie.

Për sa më sipër arsyetuar dhe në konsideratë të fakteve se:(i) marrëdhënia e krijuar mes një *personi tjetër të lidhur* me një person i cili nuk kategorizohet në rrethin e personave që mund të hetohen sipas ligjit nr. 84/2016, sikurse shtrohet rasti i trajtuar; (ii) subjekti i rivlerësimit kishte pak kohë që kishte nisur ushtrimin e detyrës në kohën e blerjes së kësaj pasurie, trupi gjykues krijon bindjen se në tërësi nuk hidhen dyshime mbi krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme financiare.

Deklarimi i bashkëshortit³⁰ të subjektit të rivlerësimit

6. Truall me sip. 72 m² nga e cila 71 m² ndërtesë me adresë: Rr.“ ****”, Hyrja ***, Vlorë, blerë sipas kontratës së shitjes nr.2832/443, datë 9.10.1999, në vlerën 1.900.000 lekë.

Burimi i krijimit: dhënë nga babai. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën disa dokumente³¹.

6.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: deklarami i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur.

6.2 Subjekti e deklaron për herë të parë këtë pasuri të bashkëshortit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 me përshkrimin: shtëpi njëkatëshe, ***, Vlorë, nr. hipoteke ***, datë 22.10.1999, pasuria me nr. ***, z. k. ***, Vlorë. Sipërfaqe ndërtimi 72 m² dhe sipërfaqe trualli 720 m². Vlera: 2.000.000 lekë. Pjesa zotëruese, bashkëshorti 100%.

6.3 Kjo pasuri konfirmohet me kontratë shitje (banese)³²nr. ***, datë 9.10.1999, me palë shitëse shtetasen D. Ç. dhe blerës shtetasin Dh.M. . Vlera e apartamentit: 1.900.000 lekë.

6.4 ZVRPP-ja Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2019, konfirmon pasurinë në emër të shtetasit Dh. I. M., në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë truall me sip. 72 m², ndërtesë me sip. 71 m².

6.5 Subjekti është pyetur³³ nga Komisioni në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave të vjehrrit të saj ku, ndër të tjera, ka deklaruar: “... *kjo pasuri është krijuar në emër të bashkëshortit tim Dh. M. disa vjet para bashkëjetesës faktike dhe lidhjes së martesës ligjore (ndërkohë që ai nuk ishte ndarë nga prindërit në këtë periudhë, por jetonte bashkë me ta) dhe, për rrjedhojë unë nuk kam asnjë të drejtë pronësore mbi të, siç dhe e kam deklaruar. Koha e krijimit të kësaj pasurie, përkon me kohën kur unë si subjekt rivlerësimi ndiqja fakultetin e Drejtësisë në Tiranë*”. Subjekti ka deklaruar se pas komunikimit me familjarët e bashkëshortit (babain I.M.),

³⁰ Zyra e Gjendjes Civile Vlorë, me shkresën nr. ***prot., datë 23.1.2019, ka vënë në dispozicion certifikatat familjare ku rezulton se shtetasi Dh. M. në rregjistrin e vitit 1950-74 rezulton Dh. M. .

³¹ Kontratë shitje nr. ***, datë 9.10.1999+ aplikim për regjistrim pasurie në ZVRPP-në Vlorë; certifikatë pronësie, nr. *** + kartelë pasurie + hart treguese(Aneksi nr. 4/8, në dosjen e ILDKPKI-së).

³² Aneks 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

³³ Pyetësori nr. 2 datë 9.1.2020.

burimi i krijimit të këtyre të ardhurave nga babai i bashkëshortit ka qenë shitja në cilësinë e pronarit të vetëm të pasurive të paluajtshme.

6.5.1 Subjekti ka depozituar sikurse edhe në ILDKPKI, praktikën e blerjes së kësaj pasurie nga bashkëshorti, aplikimin për regjistrim, certifikatën e pronësisë, disa kontrata shitje trualli nga viti 1995– 1998, si dhe deklaratën noteriale nr***, datë 17.1.2020, ku shtetasi I. M.(vjeherri i subjektit) deklaroi se sipas kontratës së shitjes në shumën 1.900.000 lekë, të gjithë shumën ia ka dhuruar nga fitimet e realizuara nga shitja e pronave të tij të paluajtshme, të trashëguara nga babai F. M. .

6.6 Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen kontratat e shitjes së pasurive të paluajtshme³⁴ me vlerat përkatëse.

Tabela nr. 4

Data	Kontratë shitblerje	Vlera e shitjes	Valuta	Blerësi
29/11/1995	nr. ***rep., nr. *** kol.	100,000	USD	M.G.
13/04/1996	nr. ***rep., nr. *** kol.	1,155,000	lekë	N.B.
14/08/1996	nr. ***rep., nr. *** kol.	450,000	lekë	O.S.
30/12/1997	nr. ***rep., nr. *** kol.	400,000	lekë	S.D.
30/12/1997	nr. *** rep., nr. ***kol.	600,000	lekë	L.D.
07/01/1998	nr. *** rep., nr. ***kol.	1,694,000	lekë	D. B.
28/06/1998	nr. ***rep., nr. *** ko.l	1,260,000	lekë	M. S.

6.7 Nisur nga të ardhurat e krijuara në favor të vjeherit të subjektit nga shitja e pasurive të kthyer nga KKKPronave në atë kohë, Komisioni ka konstatuar së ato mbulojnë investimin prej 1.900.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie në vitin 1999.

6.8 Në lidhje me sipërfaqen e truallit 720 m² (deklaruar në vitin 2004), subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar³⁵: *“...sipërfaqja ndodhet brenda pronës së trashëguar nga vjerri i saj dhe se sipërfaqja 72 m² pasqyron lidhjen me pasurinë edhe pse posedimi vijon të jetë i shtrirë në 720 m². Vjeherri dhe bashkëshorti (është shprehur ajo), me sqarojnë se kjo sipërfaqe ndodhet brenda pronës së trashëguar dhe brenda rrethimit të ndërtesës, dhe ka qenë ky shkaku i deklaramit më parë 720 m² truall, por që sipas dokumentit ligjor, në pronësi të bashkëshortit tim, trualli është vetëm në masën e 72 m².”*

6.9 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, konstatoi se kjo pasuri konfirmohet nga ZVRPP-ja në pronësi të bashkëshortit të subjektit. Nga verifikimi i dokumentit hipotekor, si dhe nga kontrata e shitjes së pasurisë në vitin 1999, pronësia legjitimohet me të dhënat e sakta të deklaruara në deklaratën *Vetting*. Trupi gjykues ka synuar të qartësojë deklaramin e truallit me sip. 720 m² dhe se nga shpjegimi i saktë i subjektit nuk konstaton ndonjë problematikë.

- ✓ Në kushte të tilla, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të arsyetuar, edhe pse pasuria është krijuar përpara se subjekti të merrte detyrën, por edhe përpara se të krijonte lidhjen martesore³⁶, çmon se subjekti ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi këtë pasuri.

³⁴ Blerësit e të cilave janë regjistruar në hipotekë me vërtetimet përkatëse të asaj kohe, pasqyruar dokumentacioni në pyetësorin nr. 2, datë 9.1.2020, nga subjekti i rivlerësimit.

³⁵ Në pyetësorin nr. 5, datë 6.4.2020.

³⁶ Në datën 31.5.2001, sipas certifikatës së martesës, lëshuar në datë 17.10.2016, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 9.1.2020, në dosjen e Komisionit.

7. Dy Toka kullotë, përkatësisht se cila me sipërfaqe 1.000 m², blerë sipaskontratës së shitblerjes nr. ***, datë 23.11.2015, në shumën totale 400.000 lekë, ndodhur në A., Himarë. Burimi i deklaruar i krijimit: me të ardhurat nga puna si avokat.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

7.1 Subjekti i deklaroi për herë të parë këto pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 me përshkrimin: me kontratën me nr. ***, datë 23.11.2015, para notere E.T., Dhoma e Noterisë Tiranë, blerë dy pasuri të paluajtshme të llojit “tokë kullote”, ndodhur në fshatin A., Himarë, me sipërfaqe respektive nga 1.000 m². Çmimi i blerjes për secilën sipërfaqe është respektivisht 200.000 lekë. Burimi i krijimit të kësaj pasurie: të ardhurat e bashkëshortit të deklaruesit nga puna si avokat. Pjesa takuese: 50% e prezumuar ligjërisht. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁷.

7.2 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: deklarimi i subjektit përputhet dhe dokumentacioni i paraqitur me konfirmimin e ZVRPP-së Vlorë.

7.3 Këto pasuri konfirmohen me Kontratë shitje (pasuri e paluajtshme)³⁸ nr.***, datë 23.11.2015, me palë shitëse shtetasit K.B., K.B., O. B., Q. B. dhe blerës shtetasi Dh.M., me të dhënat:

- Tokë kullote me sip. 1.000 m² e ndodhur në fshatin A., Himarë, regjistruar në ZVRPP-në Vlorë, në z. k. ***, nr. prone ***.
- Tokë kullote me sip. 1.000 m² e ndodhur në fshatin A., Himarë, regjistruar në ZVRPP-në Vlorë, në z. k. ***, nr. prone ***.
- Çmimi 200.000 lekë secila, pra, në total 400.000 lekë.

7.4 ZVRPP-ja Vlorë³⁹ me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2018, konfirmon se z.Dh.M. është pronar i kullotës me sip. 1.000 m² + 1.000 m², të ndodhura në Himarë në z. k. *** me vërtetimet hipotekore nr. *** dhe nr.***.

7.5 Trupit gjykues, nga analizimi i korrespondencës me “Alpha Bank”⁴⁰ i ka rezultuar se çmimi i blerjes për këto toka është paguar në këtë bankë në datën 23.11.2015, në shumën 400.000 lekë nga llogaria e Dh. M. Person Fizik për llogari të noteres E.T. Person Fizik, me përshkrimin: “*Kalim nga Dh. M. Person Fizik tek E.T. Person Fizik, Çmimi i blerjes tokë kullote për shitësin K. B.*”.

- ✓ Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, trupit gjykues nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të shpenzuara për blerjen e kësaj pasurie. Ka rezultuar se transaksionet janë kryer konform legjislacionit të kohës, ku kalimi i çmimit të blerjes është kryer nëpërmjet llogarisë së noterit.

- Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës për përfitimin e kësaj pasurie, në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi me shitësit, në raport me çmimin e shitjes së pasurisë, është pyetur⁴¹ subjekti, nëse gjatë ushtrimit të funksionit të saj ka zhvilluar procese gjyqësore me palë ndërgjyqëse shitësit. Në përgjigjen⁴² e dhënë ka deklaruar shprehimisht: “*...në përmbushje të plotë të detyrimit ligjor për të garantuar paanshmëri në gjykimet e çdo lloji, dhe detyrimit për të hequr dorë nga çdo gjykim, në të cilin do të kisha shkak ligjor papajtueshmërie, apo dhe çdo shkak tjetër që vë në dyshim paanshinë e gjyqtarit në proces,*

³⁷ Kontratë shitblerjes nr. ***, datë 23.11.2015; mandat urdhërpaguese Alpha Bank, + praktika; vërtetim hipotekor nr. *** dhe *** (Aneksi nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁸ Aneks 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁹ Aneks nr.27 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁰ Mandat urdhërpaguese në Alpha Bank, aneks 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹ Me e-mail-in, datë 4.6.2020.

⁴² Me e-mail, datë 9.6.2020.

përgjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksionit tim si gjyqtare dhe deri aktualisht, nuk kam zhvilluar asnjë proces gjyqësor civil (familjar, tregtar, administrativ, apo të çdo lloji) apo penal me shtetasit K. B., K. B., O.B., Q. B. (me cilësinë e palës ndërgjyqëse apo të kërkuesit të çdo lloji). Deklaroj marrëdhënie krejtësisht indiferente me këta shtetas dhe asnjë lloj njohje time personale me ta. Kontrata e mësipërme është lidhur dhe nënshkruar me cilësinë e blerësit personalisht vetëm nga bashkëshorti im Dh. M., pavarësisht bashkëpronësisë ligjore timen për shkak të regjimit pasuror martesor.”

- Subjekti ka depozituar edhe vërtetimet⁴³ përkatëse të dhëna nga Gjykata e Rrethit dhe Apelit Durrës ku konfirmohet se nuk ka zhvilluar procese gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasit B.. Edhe nga korrespondenca⁴⁴ e Komisionit me organet e gjyqësorit, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar dhe ushtron detyrën, nuk është konfirmuar ndonjë proces gjyqësor i zhvilluar prej saj me këto palë ndërgjyqëse.

- ✓ Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, nga analizimi i provave të administruara dhe shpjegimet e subjektit, trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi këtë pasuri, ka pasur burime financiare të mjaftueshme për blerjen e saj, si dhe nuk gjendet për shkak të funksionit të saj, në kushtet e konfliktit të interesit me palën shitëse.

8. Në lidhje me automjet tip “Audi A4”, me targa *, blerë në mars të vitit 2016. Vlera: 8.000 euro. Burimi i krijimit: me të ardhurat nga puna si avokat. Zotërimi: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁵.**

8.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: përputhet deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur, me përgjigjet e DPSHTRr-së.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

8.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2016 me përshkrimin: “*Automjet tip Audi me targa *** blerë në mars të vitit 2016, në vlerën 8.000 euro. Burimi i krijimit me të ardhurat nga puna si avokat*”. Shuma prej 6.000 euro iu mor hua shtetasit V.A. në momentin e blerjes dhe u likuidua në datën 17.11.2016 me të ardhurat nga puna si avokat.

8.3 DPSHTRr-ja me shkresën nr. ***, datë 21.12.2018, informon se: shtetasi Dh. M. aktualisht ka në pronësi mjetin me targa ***.

8.4 Nga analizimi i dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRr-ja, rezulton se ky automjet është zhdoganuar në datën 4.3.2016, sipas deklaratës doganore ***. Vlera e mjetit konfirmohet në shumën 8.000 euro dhe detyrimet doganore në shumën 229.237 lekë.

8.5 Komisioni ka administruar (i) kontratën e huas⁴⁶ nr. ***, datë 7.11.2016, me huadhënës V.A. dhe huamarrës Dh. M. . Shuma e huas pasqyrohet 6.000 euro. Kjo shumë konfirmohet se është dhënë nga shtetasi V. A. në datën 1.3.2016, nëpërmjet *MoneyGram*; (ii) deklaratën noteriale nr***, datë 17.11.2016, ku shtetasi V. A. deklaroi shlyerjen e detyrimit nga Dh.M. dhe faktin se nuk ka asnjë pretendim nga kontrata e huas; (iii) transaksionin bankar në datën 14.11.2016, ku konfirmohet transfertë nga “Alpha Bank” nga Dh. M. Person Fizik te V.A. me përshkrimin *kalim borxhi* sipas kontratës nr. ***, datë 7.11.2016.

⁴³ Nr*** prot., datë 10.6.2020 dhe nr. ***prot., datë 9.6.2020.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2020, e Komisionit dhe ***prot., datë 10.6.2020, nr. *** prot., datë 15.6.2020, nr. *** prot., datë 12.6.2020.

⁴⁵ Certifikatë pronësie për automjetin me targa ***, tip “Audi A4”, në pronësi të Dh.M. + leje qarkullimi; deklaratë doganore për vlerën e automjetit 8.000 euro dhe detyrim doganor prej 200.000 lekë (Aneksi nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁶ Aneks 4/13 në dosjen e ILDKPKI-së.

8.6 Komisioni e ka pyetur⁴⁷ subjektin mbi burimin e ligjshëm të shumës së dhënë nga huadhënësi.

8.6.1 Subjekti në përgjigjen e dhënë ka sqaruar se *në këtë vit, bashkëshorti i saj është ndodhur në Gjermani dhe ka gjetur automjetin në fjalë, të cilin ka vendosur ta blejë, por duke mos e patur me vete të gjithë shumën që përfaqësonte çmimin e blerjes, ka kontaktuar me mikun e tij V. A., dhe ky i fundit i ka nisur nga Shqipëria shumën prej 6.000 euro nëpërmjet shërbimit Money Gram (sipas mandatit përkatës). Në lidhje me këtë shumë kanë lidhur kontratën e huas me qëllim njohjen e detyrimit, duke u shlyer më pas nga bashkëshorti nëpërmjet sistemit bankar nga të ardhurat e punës si avokat. Këto fakte janë deklaruar edhe më parë nga shtetasi V.A. . Subjekti lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 6.000 euro ka depozituar dokumentacionin i cili nga verifikimi korrespondon më së shumti me kontratat e siguruar nga aktiviteti ku shtetasi V. A. është ortak.*

8.6.2 Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare të shtetasit V. A. . Nga hetimi rezultoi se ky shtetas ka qenë ortak dhe administrator në disa shoqëri tregtare. ISSh-ja⁴⁸ konfirmon se huadhënësi ka qenë i siguruar deri në dhjetor të vitit 2014. Nga analizimi i statement bankar të OTP Bank⁴⁹ rezultoi se shtetasit V. A. i është transferuar në datën 29.10.2015, shuma prej 7.000 euro si kësht për blerje apartamenti dhe po në të njëjtën datë kjo shumë është tërhequr prej tij.

8.7 Komisioni kreu analizën financiare e cila është paraqitur vjetore sepse për disa shpenzime ishte e vështirë të përcaktohej saktë koha kur janë kryer. Për këtë arsye kjo analizë është bërë e tillë, duke analizuar në të njëjtën kohë edhe kthimin e huas në shumën prej 6.000 euro.

8.8 Nga analiza financiare, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi në shumën 407.176 lekë, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, të shlyente huan, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe për pasojë iu kalua barra e provës⁵⁰ për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

8.9 Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e saj ka deklaruar se në raport me shpenzimet jetike të llogaritura për vitin 2016, ato janë llogaritur më shumë se sa duhet në realitet, pasi ka pretenduar që këto shpenzime sipas ILDKPKI-së të llogariten për tre persona dhe jo për katër. Subjekti për këtë ka argumentuar se ashtu sikurse ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorëve, mbështetur edhe në dokumentacionin e shkollës së djalit si akte provuese, K. M., i dalë lindjes 21.4.2001 që në moshë të vogël (1 vjeç) për arsye shëndetësore ka jetuar dhe është mbajtur nga prindërit e subjektit në fshatin M., Durrës. Subjekti ka kërkuar që në zërin shpenzime jetike të bëhen llogaritjet për tre persona në shumën **705.276 lekë**. Pothuajse gjithë kohën e shkollimit, ka shpenzuar në shkolla Jopublike, ku ka pasur të hequr ushqimin e gjithë ditës, uniformën e shkollës, librat, shpenzime të cilat i kanë mbuluar vetë si prindër dhe që Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare. Ka pretenduar që këto shpenzime të mos llogariten dy herë, por të zbriten.

- Subjekti ka sqaruar se prindërit e saj kanë pasur mundësi për mbajtjen dhe mbulimin e shpenzimeve të djalit të saj, pasi jo vetëm kanë qenë gjatë gjithë kohës në marrëdhënie pune të ligjshme, por ata kanë jetuar në fshat pa ndërprerje, duke punuar gjithë kohën, kanë kultivuar sera me qëllim rritjen e të ardhurave të tyre, si dhe kanë kultivuar vreshtë në sipërfaqen 10.000 m², fakte këto të njohura publikisht në zonën ku jetojnë dhe janë njerëz të nderuar në atë

⁴⁷ Pyetësor nr. 2, datë 9.1.2020

⁴⁸ Shkresë nr. ***prot., datë 15.1.2020.

⁴⁹ Shkresë nr. ***, datë 15.1.2020.

⁵⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

komunitet, pjesëmarrës aktivë në jetën e njerëzve, pasi babai i subjektit ka qenë për 45 vjet mësues (drejtor shkolle) dhe nëna për 40 vjet infermiere në shërbim të komunitetit. Subjekti ka sqaruar se nuk ka përfutur asnjë lloj pasurie të dhuruar nga prindërit e saj përgjatë gjithë periudhës së deklaramit dhe mbështetja që ata i kanë dhënë gjatë kësaj kohe ka qenë, pikërisht mbajtja e djalit, nipit të tyre K.M., për të cilin janë kujdesur gjatë gjithë kohës, megjithë të mirat që ua ka mundësuar puna e tyre e ligjshme në marrëdhënie me shtetin, si dhe puna e përditshme si familje bujqësore në fshat.

- Subjekti ka qartësuar se në “Alpha Bank” ka pasur llogarinë bankare nr. *** në lekë (llogari page) nga e cila më 10.12.2015 ka tërhequr *cash* shumë 300.000 lekë për t’i përdorur për blerjen e automjetit, që kishin kohë që e mendonin. Këtë shumë megjithëse nuk e ka përdorur për blerjen e ndonjë pasurie në fund të vitit 2015, gabimisht nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* të mbartur, duke e vlerësuar se ky transaksion është i pasqyruar në llogarinë bankare. Pikërisht, ka deklaruar subjekti: “ ... *kjo shumë ka shërbyer pjesërisht si burim për blerjen e automjetit në datën 4.3.2016 ...meqenëse deklarata periodike është plotësuar pas kësaj date dhe unë nuk e kisha më gjendje atë sasi parash në banesë, pasi u përdor për blerjen e automjetit, ka qenë një nga arsyet që më kanë çuar në pasaktësinë për mosdeklarim të kësaj shume cash në fund të vitit 2015, duke e konsideruar të deklaruar, por dhe duke kuptuar keq për shumë kohë se cash ishte gjendja në banesë në kohën e plotësimit të deklaratës. Pra, shpenzimet për blerjen e automjetit në mars të vitit 2016, janë mbuluar edhe me shumë prej 300.000 lekësh të tërhequra në ‘Alpha Bank’ (llogaria ime) në dhjetor të vitit 2015, mbajtur në banesë dhe për gabim njerëzor, kuptuar keq mënyra e deklaramit që bëhej çdo vit deri më 31 mars, nuk e kam deklaruar si gjendje cash në mbyllje të vitit 2015 këtë shumë.* ” Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk ka blerë asnjë pasuri tjetër me shumë të tërhequr në dhjetor 2015 të vitit. Subjekti ka sqaruar se këtë mënyrë të kuptuarit gabim të deklaramit të tepricave monetare të vitit paraardhës, unë e kam pasur për shumë kohë, pasi edhe në vite të tjera ku analiza financiare ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve rezultojnë me balancë pozitive, unë gabimisht nuk kam deklaruar në 31 mars tepricën, e cila pothuaj gjithmonë përdoret për shpenzimet e muajve janar, shkurt dhe mars të vitit pasardhës. Subjekti pretendon për një bilanc pozitiv prej 127.916 lekësh.

- Subjekti ka depozituar transaksionin bankar të kryer në “Alpha Bank” në datën 10.12.2015, dokumentacion të prindërve të saj B. dhe B. H. mbi të ardhurat e krijuara për periudhën që kanë mbajtur nipin e tyre, K. M., si dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.7.2020.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

- Trupi gjykues, në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e deklarameve të subjektit, referuar shpjegimeve të dhëna, përgjigjeve në pyetësor, dokumentacionit të administruar, arsyeton si vijon:

- Në analizë të dokumentacionit⁵¹ të depozituar nga shtetasi V.A., rezultojnë se në tërësi ka pasur mundësi të krijojë dhe të japë në favor të bashkëshortit të subjektit shumë prej 6.000 euro për blerjen e automjetit. Huadhënësi figuron administrator i një shoqërie ndërtimore. Për shkak të aktivitetit të tij ka hyrë në marrëdhënie kontraktore porosie apo shitblerje, me të tretë prej të cilëve janë kryer pagesa. Gjithashtu, nga aktet e depozituara rezultojnë se ka kryer edhe transaksione bankare. Njëkohësisht në deklaratën noteriale të depozituar, datë 16.1.2020, huadhënësi ka saktësuar se shumë të dhëna hua e ka siguruar nga kursimet e tij personale apo edhe nga ato të krijuara dhe ruajtura në banesë nga aktivitetet e tij tregtar.

⁵¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 9.1.2020, në dosjen e Komisionit.

- Në këto kushte, trupi gjykues krijon bindjen se huadhënësi ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për të dhënë hua bashkëshortit të subjektit.

-Në lidhje me pretendimin e subjektit se shumën 300.000 lekë të tërhequr në dhjetor të vitit 2015, në “Alpha Bank” e ka pasur gjendje në fundvit, por për shkak të moskuptueshmërisë së duhur për të deklaruar gjendjet *cash* në çdo fund vit, nuk e ka deklaruar këtë shumë, trupi gjykues nuk e konsideron për faktin se subjekti ka deklaruar një shumë prej 300.000 lekësh gjendje *cash* në fund të vitit dhe, për rrjedhojë, lehtësisht do të kishte deklaruar edhe këtë shumë të tërhequr nga banka.

- Ndërsa në lidhje me pretendimin e subjektit për të përlogaritur në analizën financiare, tri persona në familjen e saj, në zërin e shpenzimeve të jetesës, për shkaqet dhe arsyet e përmendura në parashtrime lidhur me rritjen e djalit të saj pranë prindërve të saj, trupi gjykues vlerëson deklaratimet⁵² konsistente të saj, se djali që nga moshë 1-vjeçare është rritur në fshatin M., Durrës, nga dy prindërit e saj, për shkak të gjendjes së rëndë të alergjisë astmatike që i është shfaqur në këtë moshë dhe që ka vijuar për vite me radhë. Këtë fakt e kanë deklaruar edhe prindërit e subjektit në deklaratën noteriale, madje duke qartësuar se nipin e tyre e kanë mbajtur deri në tetor të vitit 2019, kohë kur nisi studimet e larta në Tiranë. Në këtë vlerësim përfshihet edhe dokumentacioni⁵³ shkollor ku identifikohet kryerja e arsimit nga djali i subjektit në qytetin e Durrësit. Gjithashtu, trupi gjykues merr në konsideratë edhe dokumentacionin⁵⁴ i cili pasqyron të ardhurat e krijuara nga prindërit e subjektit përmes punësimeve të tyre në shtet. Në kushte të tilla, trupi gjykues, mbi arsyetimin e lartpërmendur, kreu përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor rillogaritjet financiare, nga ku subjekti rezultoi në balancë negative nga 407.176 lekë në 172.084 lekë, shumë kjo që nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit.

9. Në lidhje me kontratë sipërmarrje, datë 2.3.2006, për blerje apartament banimi, me sip totale 104.33 m², në Tiranë, në vlerën 75.000 euro. Burimi i krijimit : kredi bankare në NBG, në shumën 45.000 euro, kursimet familjare dhe ndihmë nga prindërit. Dokumentacioni i plotë bashkëlidhur deklaratës (e paregjistruar). Subjekti i ka bashkëlidhur⁵⁵deklaratës, kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 2.3.2006 + praktikën e kontratës; mandatpagesë nr. 4, për këstin e parë të apartamentit, në shumën 25.000 euro.

9.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur. Në ZVRPP nuk është kryer regjistrimi i pasurisë.

9.2 Lidhur me burimin e blerjes së apartamentit në vlerën 75.000 euro, subjekti ka sqaruar se është marrë kredi në NBG, në shumën 45.000 euro, 5.000 euro nga kursimet familjare dhe pjesa tjetër prej 25.000 euro ndihmë nga babai, si rezultat i ndarjes nga familja.

9.2.1 Lidhur me shumën prej 25.000 euro, ndihmë nga babai, subjekti ka sqaruar se si burim babai (i bashkëshortit) ka përdorur të ardhura nga:

- kontrata e shitjes nr. ***, datë 29.11.1995, në shumën 100.000 USD (*pronë e trashëguar dhe kthyer nga K.K.Pronave, sipas vendimit nr. 89, datë 16.10.1995*);

⁵² Referuar përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, datë 29.1.2020.

⁵³ I depozituar nga subjekti me pyetësorin nr.4, datë 14.2.2020, konkretisht: vërtetimi nr. *** prot., datë 15.2.2020, nga shkolla jopublike “***”,Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2020, nga Kolegji ***, dhe në prapësime deklarata noteriale nr. ***, datë 8.7.2020, si dhe përgjigja pranë KPK-së nga Kolegji, dërguar me shkresën nr. *** prot, datë 28.01.2020.

⁵⁴ Vërtetimet për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nr. 22-15,për punëmarrësin B. H. lëshuar nga punëdhënësi Zyra Vendore Arsimore dhe nr. *** prot., datë 8.7.2020, për punëmarrësen B. H., lëshuar nga Qendra Shëndetësore M. Durrës, prova të depozituara në prapsimet e subjektit të rivlerësimit.

⁵⁵ Aneksi nr. 4/ 11 në dosjen e ILDKPKI-së.

- kontrata e shitjes nr. ***, datë 22.8.2000, në shumën 4.500.000 lekë (*pronë e trashëguar dhe kthyer nga K.K.Pronave, sipas vendimit nr.80, datë 30.5.1995*) (kontrata dhe dokumente të cilat i bashkëlidhen këtij deklarami);
- babai është trashëgimtar i vetëm testamentar i babait të tij F. M., i cili ka pasur pasuri të paluajtshme të rifituara nëpërmjet vendimeve të komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Këto prona përefekt trashëgimie kanë kaluar në pronësi individuale të babit të bashkëshortit të subjektit I. M.;
- disponohen dhe shumë kontrata të tjera shitjesh pasuri të paluajtshme, të cilat i janë bashkëlidhur deklaramit;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.1.2017, nga I.M. .

Subjekti i ka bashkëlidhur⁵⁶ deklaratës disa dokumente.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

9.3 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë marrëdhënie kontraktore në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 me përshkrimin: prenotuar apartament me sip. 104.33 m², në Tiranë, sipas kontratës nr***, datë 2.3.2006, me vlerë totale 75.000 euro, ku të paguara *cash* vlera 25.000 euro ose 3.000.000 lekë, dhënë nga babai si rezultat i ndarjes familjare për blerjen e apartamentit (shtëpi më vete), nga shitja e pronave të tij të trashëguara.

Ndërsa, te detyrimet financiare subjekti deklaroi: kredi e marrë në Bankën Kombëtare të Greqisë për blerjen e apartamentit në Tiranë, në shumën 45.000 euro, sipas kontratës nr. ***, datë 14.3.2006, me interes 7.9% për një kohë prej 20 vjetësh.

9.4 Komisioni nga analizimi i kontratës së sipërmarrjes⁵⁷, datë 2.3.2006, me sipërmarrës N.B.(Z.) (investitor në pallatin që po ndërtohet nga shoqëria “****” sh.p.k.) dhe porositës Dh.M., vërtetuar me kontratën nr. ***, datë 2.3.2006, ka konstatuar se është porositur apartamenti me sip.104.33 m², nr. ***, shk. ***, k. ***, në vlerën 75.000 euro.

9.4.1 Kushtet e pagesës pasqyrohen: në datën 27.2.2006 porositësi i ka dorëzuar investitores N.B. (Z.)shumën prej 25.000 euro, ndërsa pjesa tjetër e mbetur pa paguar prej 50.000 euro do të paguhet nga porositësi me marrjen e kredisë nga NBG.

9.5 ZVRPP-ja⁵⁸ nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.

9.6 UKT-ja me shkresën nr. K-4865/1 prot., datë 16.1.2019, nuk konfirmon kontratë të lidhur në emër të subjektit apo personave të lidhur.

⁵⁶ Kontratë shitje nr. *** datë 29.11.1995; kontratë shitje nr. ***, datë 22.8.2000+ vërtetim hipotekor nr***, datë 10.4.1996, për truall në adresën “****”, Vlorë+ aplikim për regjistrim në ZVRPP nga A. G.; vendim nr. 80, datë 30.5.1995, nga Kompesimi dhe Kthimi i Pronave + procesverbal për çelje testamenti nr***, nga z. I. M.; vendim nr. 89, datë 16.10.1995, nga Kompesimi dhe Kthimi i Pronave; vërtetim nr. *** prot.,datë 27.4.2015; akt marrëveshje nr. ***, datë 24.7.2000; kontratë shitje nr. ***, datë 30.12.1997; kontratë shitje nr. ***, datë 30.12.1997; kontratë shitje nr. ***, datë 13.4.1996, shitës I. M., ka shitur truall me sip. 350 m², i ndodhur në lagjen “****”, Vlorë; kontratë shitje datë 28.6.1998, shitës I.M. i përfaqësuar nga djali Dh. M., ka shitur truall me sip. 230 m², i ndodhur në lagjen “****”, Vlorë; kontratë shitje nr***, datë 7.1.1998, shitës I.M. i përfaqësuar nga djali Dh.M., ka shitur truall me sip. 308 m², i ndodhur në lagjen “****”, Vlorë; kontratë shitje nr***, datë 14.8.1996, shitës I. M. i përfaqësuar nga djali Dh.M., ka shitur truall me sip. 150 m², i ndodhur në lagjen “****”, Vlorë; aktmarrëveshje nr. ***, datë 26.3.2005, shitës I. M. i përfaqësuar nga djali Dh.M., ka shitur truall me sip. 400 m², i ndodhur në lagjen “****”; aktmarrëveshje nr. *** datë 20.8.2002, ku vërtetohet se Dh.M. ka shitur truall me sip. 300 m², në vlerën 3000 lekë/m²; deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.1.2017; (Aneksi nr. 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵⁷ Aneks 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.1.2019. Edhe nga verifikimi i RNSH-së (përveç veprimeve noteriale të cilat janë pjesë e pasurive të hetuara në këtë çështje) nuk identifikohen veprime të tjera në emër të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa rezultojnë disa veprime noteriale që referohen në emër të bashkëshortit dhe vjehrrit të saj, të cilat datojnë në vitin 2018, jashtë periudhës së rivlerësimit.

9.7 OSHEE-ja konfirmon 10 abonentë me gjeneralitete të njëjta me ato të bashkëshortit të subjektit, përkatësisht 2 në instancën Gjirokastër, dy në instancën Sarandë dhe 6 kontrata në instancën Tiranë. Nga verifikimi i të dhënave të dërguara, vetëm dy prej kontratave përjashtohen automatikisht nga hetimi për shkak se në njërin prej tyre abonenti identifikohet nga atësia dhe në tjetrën nga numri i kartës së identitetit.

9.7.1 Subjekti në përgjigjen⁵⁹ e dhënë, ndër të tjera, ka sqaruar se... *asnjëra nga kontratat që rezultojnë me Dh. M., nuk na përket (nuk i përkasin bashkëshortit tim asnjë nga objektet për të cilat janë lidhur këto kontrata, qoftë në pronësi, qoftë në përdorim të çdo lloji), për më tepër që ne kemi deklaruar çdo librezë të pagimit të detyrimeve tona në këtë drejtim. Subjekti ka konfirmuar se i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Zyres së Gjendjes Civile, duke kërkuar të dhënat e personave që figurojnë të rregjistruar në gjendjen civile të Republikës së Shqipërisë, me emër dhe mbiemër të njëjtë me bashkëshortin e saj, të dhëna të cilat i ka kërkuar me identitet të plotë për secilin shtetas, emër, mbiemër, atësi dhe numrin e ID-së, pasi vlerëson se problematika e të dhënave të OSHEE-së (siç dhe ata vetë kanë sqaruar), qëndron pikërisht në mbajtjen e tyre me identitet të cunguar dhe pa referuar në dokumente personale të shtetasve në momentin e lidhjes së kontratave. Subjekti ka sqaruar se këto të dhëna në lidhje me emrin e personit, janë kërkuar edhe me Dh. edhe me Dh., pasi bën ndryshim shkronja e parafundit e emrit, në varësi të faktit si është shkruar me “e” apo me “ë”, duke sjelle një numër të ndryshëm shtetasish të rregjistruar respektivisht në secilin rast. Vërehet se në shkresën kthim-përgjigje për Ju, OSHEE-ja bën fjalë për Dh.M.(dhe liston kontratat), ndërkohë të gjitha kontratat e printuara nga sistemi janë me emër Dh. M.. Të dhënat e mbajtuara nga OSHEE-ja paraqesin shumë parregullsi dhe pasaktësi që çojnë në konfuzion informacioni që nuk ka asnjë lidhje me bashkëshortin e subjektit.*

9.7.2 Subjekti ka depozituar përgjigjen e dhënë nga DPGJCivile nr. ***prot., datë 28.5.2020, sipas të cilës konfirmohen 5(pesë) shtetas me emrin Dh***ër/Dh***er.

Në vijim të këtij kërkimi, subjekti është shprehur se bazuar në ato akte dokumentare që kam mundur të gjej, deklaroj se kontratat për të cilat ju bëni fjalë, nuk u përkasin familjarëve të mi. Përveç konfirmimit të faktit se ka një numër të konsiderueshëm shtetasish me të njëjtin emër dhe mbiemër si familjarët e mi dhe kontratat eventualisht iu përkasin, pikërisht këtyre shtetasve, unë në këtë moment nuk gjej mënyrë tjetër për të dokumentuar deklaratimet e mia, se kontratat nuk na përkasin neve.

9.8 Komisioni hetoi lidhur me secilin burim krijimi të kësaj pasurie:

- a) Kredi në NBG, në shumën 45.000 euro
- b) Kursime familjare, në shumën 5.000 euro
- c) Ndihmë nga babai, në shumën 25.000 euro ose 3.000.000 lekë

9.8.1 Në lidhje me kredinë në NBG

- Kjo kredi konfirmohet me kontratë kredie⁶⁰ nr. ***, datë 14.3.2006 me NBG-nënë shumën 45.000 euro me qëllim blerjen e apartamentit në Tiranë.

- Dorëzanës për këtë kontratë është J.H. (vëllai i subjektit) me apartamentin (arsyetuar më sipër) me sip. 95.12 m2, në Tiranë, Blv. “***”, pranë KESH.

- Kredia në shumën 45.000 euro është disbursuar në datën 21.3.2006 dhe po në të njëjtën datë është tërhequr *cash*.

⁵⁹ Me pyetësin nr. 6, datë 19.5.2020, përgjigjur në datën 28.5.2020.

⁶⁰ Aneks 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Nuk rezulton dokumentacion që provon kalimin e kësaj shume te shoqëria për blerjen e apartamentit, por në kontratë ka qenë e parashikuar se diferenca do të paguhet nga porositeti me marrjen e kredisë nga NBG.

- Komisioni e ka pyetur⁶¹ subjektin e cila ka sqaruar se pagesat nuk kanë kaluar as në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k dhe as në shoqërinë “***” sh.p.k. Pagesat janë kryer në llogarinë e shtetases N.B. (Z.) si investitore. Për të konfirmuar këtë fakt ka depozituar dokumentacionin e administruar nga Abi Bank. Nga verifikimi pasqyrohen transaksionet e kryera në datën 21.3.2006, tërheqja e kredisë dhe depozitimi në llogarinë e shtetases N.B. (Z.) për blerje apartamenti.

9.8.2 Në lidhje me kursimet familjare në shumën 5.000 euro

9.8.2.i Subjekti dhe bashkëshorti kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore, ku të ardhurat e tyre konfirmohen nga këto institucione. Në analizën financiare të kryer për këtë pasuri janë pasqyruar të ardhurat e përdorura për investimin e kryer.

9.8.2.ii Komisioni e ka pyetur⁶² subjektin lidhur me kursimet familjare, ndër të tjera, është shprehur se: *“Në lidhje me porositetin e apartamentit për çmimin e kontraktuar prej 75.000 euro, sqaroj se sipas përmbajtjes së kontratës së sipërmarrjes, datë 2.3.2006, me investitoren N. B., e cila kishte kontraktuar me shoqërinë e ndërtimit ‘***’ sh.p.k., nga totali i çmimit të kontraktuar, shuma prej 50.000 euro do t’i likudohej investitores N.B. me marrjen e kredisë nga NBG, por nga kjo bankë u miratua kredia në shumën 45.000 euro, duke mbetur pa u paguar shuma prej 5000 euro, shumë e cila nuk është paguar deri aktualisht, pasi me investitoren kontraktuese, kemi patur probleme në zbatimin e kontratës nga ana e saj. Sa i përket shumës prej 25.000 eurosh ose 3.000.000 (tre milion) lekë sipas kursit të kohës, e cila i ka kaluar investitores N. B. me mandatarkëtim nr. ***, datë 27.2.2006, na është dhuruar nga prindërit e bashkëshortit në formën e ndihmës pas ndarjes nga trangu familjar dhe nevojës tonë për strehim në Tiranë, ku dhe kishim nisur secili jetën profesionale. Është përmendur “kursime familjare” për shkak të ndonjë difference të vogël si rrjedhojë e konvertimit të lekëve në euro, apo shpenzimet noteriale të kryera deri në përfundimin e procedurës, por në fakt diferenca prej 5000 euro nuk i është likuaduar investitores. Kursimet familjare në këtë periudhë kanë për burim të ardhura të siguruara nga paga ime në Shkollën e Magjistraturës (student) dhe nga puna si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (stazhier viti i 3-të i Shkollës së Magjistraturës), si dhe paga e bashkëshortit.”*

9.8.2.iii Në deklaratën periodike të vitit 2006 kur subjekti ka deklaruar këtë kontratë sipërmarrjeje, nuk deklaroi detyrime të mbetura ndaj shoqërisë ashtu siç pretendon gjatë hetimit që shuma prej 5.000 euro nuk i është paguar shoqërisë.

9.8.2.iv Komisioni e ka pyetur⁶³ subjektin për këtë mospërputhje dhe, ndër të tjera, sqaron se i qëndron deklaratimit periodik të bërë në vitin 2006, ku nuk ka asnjë detyrim të mbetur për blerjen e apartamentit. *“Pagimi i kësaj shume përputhet plotësisht me deklaratimin periodik të vitit 2006 në zërin “kursime familjare”, si pjesë e të ardhurave të përdorura për pagimin e apartamentit, si dhe me faktin se në deklaratimin periodik pasardhës nënshkruar e dorëzuar në datën 26.3.2007, kemi pakësim të gjendjes cash në banesë në masën e 450.000 lekë, shumë e cila është përdorur në atë kohë për plotësimin e detyrimit prej 5.000 euro ndaj shtetases N. B. (Z.). Në këtë pikë (është shprehur subjekti) Ju kërkoj ndjesë për pasaktësinë time njerëzore dhe kërkoj mirëkuptimin Tuaj, pasi bëhet fjalë për fakte që kanë ndodhur para rreth 14 vjetësh, veprimet janë kryer të gjitha nga bashkëshorti im, i cili nuk është kujtuar saktësisht në lidhje*

⁶¹ Pyetësor nr.5, datë 6.4.2020, në dosjen e Komisionit.

⁶² Pyetësori nr.2, datë 9.1.2020.

⁶³ Pyetësor nr.5, datë 6.4.2020.

me të gjitha faktet e ndodhura herët në kohë. Periodikisht kam deklaruar duke qenë në kohë afër fakteve të ndodhura, i jam referuar gjithmonë të vërtetës dhe në asnjë rast nuk e mendoj të deklaroj ndryshe.”

9.8.2.v Subjekti ka depozituar mandatin bankar të derdhjes së shumës prej 5.000 euro në datën 21.3.2006 në llogarinë e investitores N.B. (Z.).

Nga verifikimi i dokumentit rezulton se mandati bankar i referohet kohës në të cilën ka ndodhur veprimi dhe për pasojë nuk vlerësohen problematika lidhur me shlyerjen e kësaj shume. Po ashtu edhe pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2006 në koherencë edhe me mos deklarim të ndonjë detyrimi në vitin 2006, janë fakte të ndodhura në kohë reale dhe që për pasojë bëjnë të besueshme likuidimin e mandatit në shumën 5.000 euro.

9.9 Por, nisur nga koha e gjatë që ka kaluar prej nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe mosndërmarrjes së ndonjë veprimi nga subjekti dhe bashkëshorti, ndërsa vijon të shlyhet kredia e përfituar për qëllim të kontratës, Komisioni është thelluar në hetimin e kryer për këtë çështje. Bazuar në të dhënat e ekstrakteve të shoqërive, i është kërkuar informacion dhe dokumentacion shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k. me argumentin se e porositura N. Z., në nënshkrimin e kontratës së porosisë ka përdorur vulën që identifikon këtë shoqëri dhe shoqërisë “****” sh.p.k. si ndërtuese e godinës. Nga shoqëria “****” sh.p.k. është kthyer kërkesa për shkak të mos gjetjes së adresës. Gjithashtu, është insistuar të komunikohet me numrin e telefonit të pasqyruar në ekstraktin e kësaj shoqërie por komunikimi nuk është arritur. Ndërsa shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k., në përgjigjen⁶⁴ e saj ka informuar se nuk ka dijeni lidhur me kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve, pasi nuk ka qenë pjesë e saj dhe se nuk disponon dokumentacion lidhur me z. Dh.M. .

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime bindëse lidhur me mosndërmarrjen e ndonjë veprimi prej saj me qëllim përmbushjen e kontratës së porosisë, apo kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

9.10 Subjekti në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka sqaruar se nga tërësia e dokumentacionit ligjor për blerjen e kësaj pasurie, lehtësisht konstatohet se si subjekt rivlerësimi nuk kam qenë asnjëherë pjesë e veprimeve juridike të kryera, me përjashtim të lidhjes së kontratës së kredisë me ish-NBG (sot ABI Bank), dhe kjo ka qenë e me vullnetin e saj, pasi që në fillim të veprimeve për blerjen e kësaj pasurie, ka qenë babai i bashkëshortit të subjektit, që ka dhënë këstin e parë *cash* në shumën 25.000 euro, nga shitja e pronave të tij, duke u bërë nismëtar që të hynin në rrugën e veprimeve të tjera paguese, me mbartjen e detyrimit të kredisë. Duke qenë se ishte babai i bashkëshortit investitori më i rëndësishëm nëpërmjet dhurimit të mësipërm për djalin e tij, duke qenë, po ky i fundit, mbështetës financiar i jetës në vijimësi (duke lehtësuar pagimin e kësteve të kredisë), duke mos na lënë asnjëherë në baltë me shpenzimet e jetesës, që u vështirësuan për shkak të pagimit të kredisë, moralisht kam vlerësuar të mos jem pjesë e veprimeve të kryera. Bashkëshorti im Dh. M., është lidhur me shtetasen N. B. me qëllim lidhjen e kontratës, nga një familjar shumë i afërt i tij, dhe kjo marrëdhënie, është bërë shkak më pas, që edhe pse u kuptua se ishim para një situatë në mospërmbushje të detyrimit kontraktor nga znj.N. B., të ndiqnim rrugën e zgjidhjes jashtëgjyqësore të të drejtave të humbura. Në këtë drejtim, sikurse edhe Komisionit i ka rezultuar nga kërkimet që ka bërë për shoqërinë “****” sh.p.k., megjithëse nga bashkëshorti janë bërë të gjitha përpjekjet, por nuk është gjetur dot një zgjidhje e arsyeshme, kanë qenë përpjekje pafund për t’u zgjidhur situata me marrëveshje. Situata e krijuar nga mosmarrja e apartamentit, për një periudhë kohe u bë shkak mosmarrëveshjesh ndërmjet nesh si bashkëshortë, duke cenuar marrëdhënien tonë, por edhe

⁶⁴ Hyrë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2020.

këtu ka qenë ndërhyrja e babait të tij, që ka sheshuar situatat, duke na inkurajuar drejt përballimit të kësaj gjendje, me logjikën e mosdëmtimit të marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortit tim dhe familjarit të tij që u bë ndërlidhës mes tij dhe znj. N. B. . Siç ju kam provuar, kjo e fundit u vërtetua plotësisht se na kishte mashtruar me kontratën e sipërmarrjes (dënuar penalisht me 14 vjet burgim⁶⁵ për veprën penale të “Mashtrimit” me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, sipas vendimit penal me nr. ***⁶⁶, datë 13.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është lënë në fuqi në tre shkallët e gjyqimit, vendim për të cilin kam marë dijeni nëpërmjet faqes së internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë), dhe efektivisht nuk kemi vlerësuar se do të mund të gjenim ndonjë zgjidhje nëpërmjet procesit gjyqësor, ndërsa vetë investitorja objektivisht nuk mund të kontaktohej për të zgjidhur kontratën dhe kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Për sa i takon përpjekjeve jashtëgjyqësore, këto kanë qenë të pafundme dhe pa rezultate. Deri tani është një humbje me të cilën tashmë jemi përshtatur, me shpresën se mund të vijë një moment që të gjendet një zgjidhje. Në nivelin e një marrëdhënie shumë të mirë me prindërit e bashkëshortit, në sjelljen e tyre në vijimësi vetëm në mbështetje të fëmijëve të tyre, dhe me dëshirën e shprehur në vijim se çdo gjë e kanë vetëm për tre fëmijët e tyre, unë personalisht kam gjetur vullnetin ta pranoj këtë situatë humbje dhe të vazhdoj përpara në ndërtimin e familjes nëpërmjet punës dhe frymës së mirë të të qenit bashkë. Ajo ka cituar *se nuk mund të ndëshkohet se humbëm paratë tona të ligjshme, të cilat nëse do të kisha mundësi, fare mirë mund t'i dhuroja për gjëra më madhore se muret e një apartamenti.*

Analiza e provave dhe fakteve

- Trupi gjyqësor, në analizë të shpjegimeve të subjektit në raport me dokumentacionin e administruar, arsyeton si vijon:

- Nisur nga niveli i provueshmërisë së dokumentacionit të administruar ku përfshihen: (i) deklarimi i bërë në deklaratën për vitin 2006, i marrëdhënies kontraktore të porosisë së apartamentit; (ii) ekzistenca e kontratës së kredisë: (iii) disburësimi i kredisë në shumën 45.000 euro, shumë e cila provohet se ka kaluar në favor të investitores N. B.; (iv) vënia kolateral si dhe raporti vlerësues i pasurisë së vëllait të subjektit për përfitimin e kësaj kredie; (v) konfirmimi i shlyerjeve të kësteve të kredisë dhe vijueshmëria edhe aktualisht; (vi) shlyerja e shumës 25.000 euro dhe 5.000 euro me mandatet përkatëse në kohë reale po në favor të investitores, fakti i mosposedimit/gëzimit të kësaj pasurie duket se nuk ka gjetur zgjidhje për shkak të dënimit të dhënë ndaj shtetasës B. me vendim gjyqësor të formës së prerë, arrihet në konkluzion se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi marrëdhënien kontraktore dhe pasojat e rrjedhura prej saj edhe për sa kohë përgjatë hetimit nuk u administrua ndonjë provë që kundërshton këto fakte apo që provon ushtrimin e të drejtave reale të subjektit mbi këtë pasuri të porositur dhe shlyer.

9.11 Në lidhje me ndihmën e dhënë nga babai i bashkëshortit të subjektit në vlerën 25.000 euro ose 3.000.000 lekë

- Subjekti e deklaroi këtë dhurim në deklaratën periodike të vitit 2006.

- Kjo shumë e dhuruar konfirmohet me deklaratën noteriale⁶⁷ nr. ***, datë 22.1.2017, ku shtetasi I.M. deklaroi se i ka dhuruar djalit të tij Dh.M., shumën 25.000 euro në fillim të vitit 2006 për blerjen e apartamentit në Tiranë, kohë kur është ndarë për të jetuar si familje më vete me bashkëshorten dhe fëmijën e tyre. Burimi i të ardhurave, nga shitja e pronave të trashëguara.

⁶⁵ Ka cituar shprehimisht subjekti në përgjigje të pyetjes 2.3 në pyetësorin nr.2, datë 9.1.2020, në dosjen e Komisionit.

⁶⁶ Depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 9.1.2020, në dosjen e Komisionit.

⁶⁷ Aneks 4/14 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe mandatpagesën nr. ***, datë 27.2.2006, për pagesën e shumës 25.000 euro ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “*për prenotim apartamenti*”.

- Subjekti i pyetur nga Komisioni⁶⁸ mbi burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, ndër të tjera, ka sqaruar se: “*...këto prona janë përfituar me vendimin nr. 80, datë 30. 5. 1995 dhe vendimin nr.89, datë 16.10.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Vlorë dhe me testament i kanë kaluar babait të bashkëshortit shtetasit I. M. . Testamenti është çelur para noterit me nr. ***, datë 7.11.1994.*” Ndërsa në lidhje me pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara në përgjigjen e dhënë, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: “*...nga komunikimi në vijim me vjehrrin I.M., të gjithë familjarët janë vënë në kërkim të ndonjë dokumenti të kësaj natyre, por përveç atyre që do të dërgoj në këtë e-mail, deri në këtë fazë nuk kemi mundur të gjejmë të tjera. Vjehri deklaroi para noterit një fakt të tillë, si dhe faktin se ai ka qenë korrekt në zbatimin e ligjit në drejtim të pagimit të detyrimeve ndaj shtetit gjatë veprimeve për kalimin e pronësisë mbi pronat e veta...pagesat e taksave dhe tatimeve për kohën kur datojnë kontratat e shitblerjes, përkatësisht vitet 1995 dhe 2000, bëheshin pranë Zyra të Hipotekës, si kusht i domosdoshëm për regjistrimin e pronës të blerës, dhe vjehri im e ka respektuar një detyrim të tillë, pasi siç tregojnë aktet që paraqes, blerësit kanë regjistruar secili pronën në emër të vet.*”

- Subjekti ka depozituar dokumentat e mëposhtme:

- kopje të vendimeve nr. 80, datë 30.5.1995 dhe nr.89, datë 16.10.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Vlorë;
- kopje të procesverbalit të çeljes së testamentit nr. ***, datë 7.11.1994;
- kopje të vërtetimit të pronësisë, lëshuar nga Zyra Hipotekës Vlorë në emër të I. M., e cila i përket regjistrimit hipotekor nr. ***, datë 10. 4. 1996;
- kopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 29.5.1995, së bashku me kopjen e vërtetimit të pronësisë, si dhe prokurën përkatëse;
- kopje të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 22.8.2000, së bashku me kopje të vërtetimit të pronësisë, prokurën përkatëse, si dhe aplikim në ZVRPP për regjistrim të pronës nga blerësi A.G.;
- aplikimin nr. ***, datë 6.3.2020, në ASHK-në Vlorë së bashku me përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë dhe dokumentacionin shoqërues;
- prokurë nr. ***, datë 24.11.1995, e shtetasit I. M.;
- Deklaratë noteriale, datë 7.3.2020, e shtetasit I.M. mbi pagimin e taksave dhe tatimeve.

- Nga dokumentacioni i depozituar konstatohet se vjehri i subjektit shtetasi I.M. ka përfituar pasuri nga procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave si trashëgimtar testamentar i babait të tij, si dhe ka hyrë prej vitit 1995 e në vijim në disa marrëdhënie shitblerje duke u përfaqësuar nga bashkëshorti i subjektit me prokurën e cituar më sipër, shitje të cilat i ka finalizuar për disa pasuri, më konkretisht:

- me vërtetimin e pronësisë, datë 10.4.1996, shtetasi I. M. (përfaqësuar me prokurë nga bashkëshorti i subjektit, z. Dh.M.) rezultoi pronar i dy trojeve, përkatësisht me sipërfaqe 3500 m² dhe 3286 m².
- me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.5.1995, shtetasi I.M. i ka shitur shtetasit M.G. sipërfaqen e truallit 1870 m² në vlerën 100.000 USD, pasuri e cila është regjistruar në hipotekë, provuar me vërtetimin e pronësisë në thembër të të cilit pasuria rezultoi e regjistruar me nr. ***, datë 29.11.1995;

⁶⁸ Pyetësor nr.2, datë 9.1.2020 dhe në vijim të pyetësorit nr. 4 (pyetje shtesë) ,me e-mail, datë 4.3.2020.

- me vërtetimin hipotekortë ZVRPP-së Vlorë, lëshuar në datën 7.08.2000, shtetasi I. M. figuron i regjistruar (prej prill 1996) mbi një sipërfaqe trualli 3500 m²;
- me kontratën e shitjes nr. ***, datë 22.8.2000, i është shitur shtetasit A.G. sipërfaqja e trullit prej 900 m², në shumën 4.500.000 lekë;
- në datën 29.8.2000, shtetasi A.G. ka aplikuar pranë ZVRPP-së Vlorë për kalim pronësie;
- sipas ditarit të bankës (pjesë e praktikës së lëshuar nga ZVRPP-ja Vlorë) rezulton të jetë kryer pagesë tatimi⁶⁹ nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shumën 90.000 lekë dhe 9.500 lekë. Paguesa e tatimit figuron në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, kjo për faktin se babai i bashkëshortit të subjektit i ka dhënë prokurë bashkëshortit të subjektit për të administruar dhe tjetërsuar pasuritë (cituar prokura më sipër në dokumentacionin e depozituar nga subjekti);
- me deklaratën noteriale, datë 7.3.2020, shtetasi I. M. qartëson se ka kaluar relativisht një kohë e gjatë prej shitjes së pasurive por se në çdo rast ka qenë korrekt duke paguar taksën apo tatimin që kërkohej sipas ligjit.

9.12 Komisioni në vijim të hetimit mbi pasurinë e porositur, kreu analizën financiare mbi mundësitë e investimit në këtë pasuri. Analiza është kryer vjetore dhe jo në momentin e investimit (21.3.2006) sepse subjekti ka pasur një vit më parë gjendje *cash* në shumën 950.000 lekë (këtë gjendje *cash* Komisioni e ka trajtuar në zërin “Gjetjet e tjera”).

9.13 Nga analiza financiare, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 116.198 lekë për të investuar në këtë pasuri, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe për pasojë subjektit iu kalua barra e provës për të provuar⁷⁰ të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

9.14 Subjekti ka parashtruar se nuk ka vërejtje mbi zërin shpenzime jetike, pasi në këtë vit kalendarik ato janë përlllogaritur sikurse ka deklaruar në deklaratën për vitin 2006 dhe jo sikurse përlllogariten nga ILDKPKI-ja. Por subjekti ka pretenduar se pavarësisht se në këtë vit vjehri i saj ka dhënë shumën 3.000.000 lekë, përsëri duhet të përlllogaritet edhe ndihma financiare e dhënë prej tij në mënyrë të vazhdueshme në shumën 300.000 lekë, pasi, sipas subjektit kjo ndihmë edhe në këtë vit nuk ka munguar. Subjekti nga përlllogaritjet e saj pretendon se rezulton në bilanc pozitiv në shumën 183.802 lekë.

- Trupi gjykues, në këtë rast ashtu sikurse rikonfirmon edhe subjekti lidhur me shpenzimet e deklaruara, i qëndron përlllogaritjes financiare në raport me deklarinin e bërë nga subjekti në deklaratën e vitit 2006, pasi ka pasqyruar ekzaktësisht shpenzimet jetike. Deklarimi në kohë reale është mjet jo më pak i vlefshëm për të konfirmuar saktësinë dhe vërtetësinë e veprimit të ndodhur. Gjithashtu, fakti që subjekti ka deklaruar në kohë reale shumën 3.000.000 lekë dhënë nga vjehri i saj, trupi gjykues ka konsideruar se në këtë shumë është e përfshirë edhe ndihma e pretenduar në mënyrë konsistente po nga vjehri, në shumën 300.000 lekë. Gjithsesi, në këtë rast balanca negative e rezultuar në shumën 116.198 lekë nuk impakton në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

- Po ashtu trupi gjykues, pavarësisht se i ka kaluar subjektit barrën e provës vetëm lidhur me balancën negative të rezultuar për këtë vit kalendarik, arsyeton lidhur edhe me ligjshmërinë e shumës 3.000.000 lekë e cila sipas dokumentacionit të administruar nga subjekti rezulton e provuar. Kjo për faktin se babai i bashkëshortit të subjektit, sikurse është cituar më sipër, ka

⁶⁹ Referuar legjisllacionit të kohës, ligjit nr. 8189, datë 30.1.1997, i ndryshuar, tatimi për të ardhura të përfituara për shumën mbi 4 – 6.000.000 lekë tatohej në masën 2%.

⁷⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

rezultuar trashëgimtar testamentar i pasurive të të ndjerit bababit të tij F. M. dhe si i tillë edhe përfitues i çdo pasurie të kthyer apo kompensuar nga institucioni përkatës i kohës. Nëpërmjet të gjithë kontratave të shitjes, por në rastin konkret kryesisht nëpërmjet kontratës së shitjes nr. ***, datë 22.8.2000, që ndikonte më së shumti në kohën e dhënies së shumës në formë dhurimi, u provua burimi i të ardhurave të përfituara, si dhe tatimi i paguar mbi to. Megjithëse forma e dhënies nuk është kryer si një dhurim i mirëfilltë por gjithsesi marrëdhënia e posaçme familjare babë e bir, në këtë rast nuk mund të kompromentohet përse kohë provohet burimi i ligjshëm i krijimit të shumës së dhënë. Subjekti pas dëgjësës në seancë dëgjimore ka depozituar⁷¹ pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara në shumën 3.000.000 lekë, megjithëse është pasqyruar edhe më sipër në faktet e paraqitura për këtë çështje, se tatimi mbi të ardhurat e përfituara është paguar që me aplikimin në ZVRPP për regjistrimin e pasurisë/ve së shitur.

- Pas riçeljes së hetimit, mbi kërkesën e Komisionit lidhur me pagesën e tatimit mbi këto të ardhura, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁷² ka informuar se: *“Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sipas rastit të paraqitur, trashëgimtari në momentin e kalimit të pasurisë së paluajtshme (shitje), ka paguar edhe tatimin mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara. Më pas, kur ky individ ka dhënë ndihmë në cash në vlerën 3.000.000 lekë, përfituesi i kësaj shume nuk është subjekt i dispozitave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar. Për sa më sipër, përfituesi i ndihmës nuk ka detyrim të paguajë tatim mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara, pasi parimi i tatimeve është që e njëjta shumë nuk mund të tatóhet dy herë.”*

Në lidhje me këtë çështje subjekti ka sqaruar⁷³ se...*pavarësisht faktit se gjatë hetimit administrativ (komunikime nëpërmjet pyetësorëve) dhe as në raportin përfundimtar, nuk më është vënë asnjëherë në dukje një fakt i tillë dhe nuk më është lënë asnjë barrë prove (pasi janë gjetur të ardhura të ligjshme nga ana Juaj në analizën financiare për blerjen e apartamentit), duke marrë shkas nga pyetja e drejtuar nga një anëtar i Komisionit në séancë dëgjimore, datë 16.7.2020, mbi pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale, në lidhje me shumën prej 3.000.000 lekësh dhuruar bashkëshortit tim nga babai i tij I. M. me qëllim prenotimin e apartamentit, ne brenda mundësive tona të ligjshme, pas konsultimit edhe me ligjin, kemi marrë masa për pagimin e këtij detyrimi të prapambetur në buxhetin e shtetit, me të vetmin qëllim, të mos jemi debitor në asnjë mënyrë me shtetin. Duke qenë se nga kjo shumë e dhuruar brenda familjes (megjithëse provohet të jetë paguariatimi në burim nga ana e vjerrit, si person tjetër i lidhur), personi i lidhur me mua si subjekt rivlerësimi, bashkëshorti, ka përfituar të ardhura, që më pas janë përdorur për prenotimin e një pasurie të përbashkët me mua si subjekt (për shkak të bashkëpronësisë martesore), megjithëse aktualisht ligji ka përjashtuar tatimin e dhurimeve në këto lloj marrëdhëniesh të posaçme, vlerësuam që për këto të ardhura të paguajmë tatimin mbi të ardhurat personale, siç parashikohet në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për të qenë deri në fund korrekt me detyrimet ndaj buxhetit të shtetit. Në këto rrethana jemi në veprim e sipër për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale ditën e sotme, veprime të cilat po kryhen nga bashkëshorti im Dh.M., në cilësinë e individit, që ka pasur detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat personale në kuptim të gërmasë “dh” të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

⁷¹ Pagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale, datë 24.7.2020.

⁷² Me shkresën nr. *** datë 29.7.2020.

⁷³ Me e-mail-in, datë 24.7.2020.

- Trupi gjykues mbi faktet dhe rrethanat e sipërcituara, vlerëson se kjo e ardhur nuk mund të kualifikohet as edhe sipas germës “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), si dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), për sa kohë këto të ardhura nuk janë nga aktivitetet përmes së cilat mund të siguroheshin të ardhura tatimore shtesë. Trupi gjykues çmon se në bazë të dispozitave ligjore të lartpërmendura, përderisa për këtë të ardhur është paguar tatimi, vlerësimi ndryshe do kishte kualifikimin e pagesës së një tatimi të dyfishtë, veprim i cili del përtej parashikimit ligjor. Në rastin objekt hetimi, tjetërsimi i pasurisë ka ndodhur nga vjehri i subjektit dhe për pasojë edhe tatimi është paguar prej tij, ndërsa është dhuruar një vlerë monetare, si e ardhur neto, që buron nga ky tjetërsim.

Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për faktin se të paguarit e tatimit në mënyrë permanente, pra, nga një dhurues tek tjetri, nëse kjo do të ndodhte do të shterohej vlera përbërëse e vet objektit të dhurimit, atëherë dhurimi do humbiste qëllimin që ky veprim nënkupton në vetvete. Nga ana tjetër, interpretimi ndryshe i këtij kualifikimi ligjor në asnjë rast nuk është hasur as në praktikën zbatuese të institucioneve tatimore. Trupi gjykues, me kompetencat që i jep Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016, pa u kushtëzuar nga informacioni i përcjellë nga organi tatimor, por as edhe nga veprimet e ndërmarra nga subjekti, por duke u bazuar ekzaktësisht në legjislacionin e fushës, konkludon se kjo e ardhur nuk mund të nënshtrohet tatimit. Lidhur me këtë çështje objekt vlerësimi, për çdo interpretim ndryshe, apo boshllëk ligjor, nëse kjo e ardhur do të nënshtrohej tatimit, Komisioni ka konstatuar se legjislacioni tatimor me zhvillimet e tij ka synuar të qartësojë përjashtimin nga ky tatim për çështje të cilat burojnë kryesisht nga marrëdhëniet familjare.

10. Llogari në BKT me gjendje në datën 23.1.2017, në shumën 4.700 lekë dhe 47.5 euro. Zotërimi: 100%.

10.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur. Subjekti ka pasqyruar gjendjen e datës 23.1.2017. BKT-ja konfirmon datën 25.1.2017.

10.2 BKT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2020, konfirmon se gjendja e llogarive të biznesit, Dh.M. Person Fizik në datën 31.12.2016 është në shumën 4.700 lekë dhe 47.5 euro.

- ✓ Trupi gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e marrë nga BKT-ja dhe për pasojë subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi gjendjen në këtë llogari.

11. Llogari në “Alpha Bank” në shumën 865 euro dhe 2.066.947 lekë (llogari Dh. M., Person Fizik). Person Fizik me objekt “Aktivitete Juridike” me NIPT ***, hapur në vitin 2014.

11.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë llogaritë e aktivitetit të bashkëshortit dhe nga statement i depozituar në pyetësin nr.4, datë 18.2.2020, konfirmohet gjendja e llogarive të biznesit në “Alpha Bank” në vlerat 865.11 euro dhe 2.066.947 lekë.

12. Në lidhje me aplikimet për legalizim të dy objekteve me sipërfaqe 35m² dhe 50 m²

- Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka aplikuar për legalizim të ndërtimit informal me kërkesën nr. ***prot., datë 16.7.2013, për një godinë banimi me sipërfaqe të bazës së ndërtimit 35 m² dhe për legalizim të ndërtimit informal me kërkesën nr. ***prot., datë 18.7.2013, për një godinë banimi me sipërfaqe të bazës së ndërtimit 50 m².

- Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.1.2017, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar nën përgjegjësinë e tij ligjore, në lidhje me një aplikim për legalizim pranë ALUIZNI-t Vlorë,

formulari nr. ***, datë 18.7.2013, se nuk ka asnjë pretendim për legalizimin e objektit të deklaruar, pasi ky objekt nuk ekziston. Ky objekt, ka deklaruar ai, nuk është ndërtuar nga ana e tij dhe prej këtij fakti nuk ka asnjë pretendim mbi këtë objekt.

- Nga dokumentacioni i administruar në ILDKPKI-ja ka rezultuar se Drejtoria e ALUIZNI-t, me shkresën nr. ***prot., datë 28.8.2017 dhe ALUIZNI Vlorë, me shkresën nr. ***prot., dt. 7.9.2017, ka konfirmuar se shtetasi Dh. M., rezulton të jetë aplikues për proces legalizimi me formularët nr. ***, datë 18.7.2013, bashkëlidhur përgjigjes gjenden disa dokumente⁷⁴.

- ILDKPKI në raportin e saj është shprehur: për sa më sipër konfirmohet se shtetasi Dh.M. sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 22.1.2017, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së dhe ALUIZNI-t Vlorë, ka hequr dorë dhe nuk ka asnjë pretendim për legalizimin objekti.

- Për sa i përket aplikimit të datës 16.7.2013, Komisioni ka konstatuar se është nënshkruar për llogari të bashkëshortit të subjektit në cilësinë e vetëdeklaruesit, ndërsa në aplikimin e datës 18.7.2013 është nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

- Komisioni e ka pyetur⁷⁵ subjektin në lidhje me:(i) vitin e ndërtimit të objekteve;(ii) burimin e krijimit të ndërtimit të tyre;(iii) pronësinë e truallit; si dhe (iv) i ka kërkuar të depozitojë dokumentacionin justifikues lidhur me krijimin e të ardhurave për ndërtimin e tyre.

- Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: ... *këto vetëdeklarime nuk janë bërë nga bashkëshorti im dhe as që ka pasur dijeni për to, dhe për më tepër unë si subjekt rivlerësimi. Bashkëshorti im është vënë në dijeni të njërit prej tyre në kohën e deklarimit Vetting që do të bëja unë si subjekt, nga motra e tij V. D. (M.), kur kjo e fundit e ka kuptuar gabimin dhe e ka ndjerë si shqetësim këtë fakt, lidhur me pasojat eventuale në procesin Vetting, si dhe kur ka kuptuar rëndësinë se vëllai i saj ishte subjekt i lidhur me Vettingun për shkakun tim. Për deklarimin tjetër motra e bashkëshortit na vuri në dijeni në kohë pas dorëzimit të deklarimit Vetting, pasi ajo kishte bërë disa vetëdeklarime në emër të familjarëve të saj dhe nuk është kujtuar në kohë se kishte bërë dy vetedeklarime në emër të vëllait të madh Dh.M.(bashkëshorti im). Pra, nga njëra anë, ne jemi vënë në dijeni se këto deklarime janë bërë nga shtetasja V. D. (M.) që është motra e bashkëshortit tim, edhe plotësimi i formulareve dhe firma e hedhur në këto vetedeklarime, nuk rezulton të jenë të bashkëshortit tim, por janë plotësuar nga persona të tjerë, pa asnjë akt përfaqësimi prej tij, duke u nënshkruar me P/përpara, dhe nga ana tjetër, bashkëshorti im nuk e ka autorizuar asnjëherë këtë shtetase apo ndonjë person tjetër për bërjen e një deklarimi të tillë.*

Pasi kemi ardhur në dijeni të këtyre dy vetedeklarimeve, bashkëshorti im më ka sqaruar se ai i është drejtuar me dy shkresa ALUIZNI-t Vlorë në datën 23.1.2019, ku ka kërkuar përjashtimin nga vetëdeklarimi apo skualifikimin e këtyre vetëdeklarimeve pasi, ai nuk ka bërë asnjë ndërtim dhe se aplikimet, jo vetëm nuk janë bërë nga ana e tij, por rezultojnë të jenë fiktive, pa asnjë lloj ndërtimi. Nga ana jonë është pyetur kunata V. D. për arsyen e kryerjes së këtyre dy vetëdeklarimeve, e cila na ka shpjeguar se i kishte bërë këto vetëdeklarime pa dijeninë tonë, me qëllim mbrojtjen formale të pronave të vjetra nga zaptuesit e kundërligjshëm sipas saj (në kushtet kur ndër vite kanë qenë në procese gjyqësore me ndërtues të paligjshëm brenda pronës së tyre të fituar me vendimet e Komisionit si më sipër). Rezulton se në të njëjtën kohë, duke ndjekur të njëjtin qëllim atë të mbrojtjes së pronës, kunata ka bërë vetëdeklarime fiktive pa objekt faktik mbi tokë, në emër edhe të familjarëve të tjerë, siç është edhe rasti i vjerrës Xh. M.

⁷⁴ Kërkesë nga Dh.M. nr. ***, datë 18.7.2013, pranë Drejtorisë Vlora 1, për ndërtim pa leje 50 m² dhe sip. 1000 m²;urdhër i brendshëm, nr. ***, datë 11.9.2013 Drejtoria Vlorë 1;fotografi objekti;certifikatë familjare; akt marrje toke në pronësi për z. I. M.; kërkesë për depozitim të dokumenteve shtesë për legalizim; si dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.1.2017 (Aneksi nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁷⁵ Referojuni pyetësorit nr. 2, datë 9.1.2020.

me kasollen prej llamarine të mushkës, ku edhe kjo u skualifikua nga ALUIZNI Vlorë. Në këto kushte i kemi kërkuar asaj që shkonte para një noteri e të bëjë një deklaratë noteriale ku të pasqyroste këtë fakt të vërtet, me pas deklaratave në fjalë ajo i ka bashkëlidhur edhe kërkesat e bashkëshortit e të vjerrës për skualifikim dhe mospërfshirje në legalizim nga ALUIZNI Vlorë. Duke qenë njohëse e ligjit, që në fillim të marrjes së këtij informacioni, kam pasur bindjen se jemi para veprës penale të “falsifikimit të vulave, stampave ose formularëve”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, por për shkak të marrëdhënies së posaçme motër - vëlla nuk kemi bërë as kallëzim penal ndaj shtetases V.D. (M.). Këto kanë qenë fakte që në kohën e ardhjes në dijeni, tek unë kanë shkaktuar një tronditje të thellë të marrëdhënieve me familjarët e bashkëshortit, por në kushtet që në mënyrë të arsyeshme duhet të mos cenoheshin bazat e familjes sime, për shkak se personi që ka kryer veprimin është njëkohësisht dhe motra e bashkëshortit, kam konkluduar me vullnet të mos ndjek rrugën penale, për të mos thelluar përkëqesimin e çdo lloj marrëdhënie.

Subjekti ka depozituar:

- kopje të dy shkresave, datë 23.1.2019, dërguar nga bashkëshorti Dh. M. tek ALUIZNI-Vlorë për përjashtim apo skualifikim të aplikimeve nga procesi i legalizimit;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2019, lëshuar nga shtetase V. D. (M.);
- vendimet përkatëse me nr. ***, datë 21.2.2019 dhe nr. ***, datë 21.2.2019, “Për mospërfshirje në procesin e legalizimit të subjektit aplikues me nr. *** prot., viti 2013 dhe nr. *** prot., viti 2013”;

Në lidhje me dhënien e deklaratës nr. ***, datë 22.1.2017, depozituar pranë ALUIZNI-t në datën 23.1.2017, subjekti ka sqaruar se: “...unë dhe bashkëshorti im, kemi ardhur në dijeni në kohë të ndryshme për secilin vetëdeklarim, dhe në momentin që erdhëm në dijeni për njërin prej tyre, që në kohë ishte para përfundimit të afatit tëdeklarimit Vetting, na u desh të marrim masa ashtu siç e vlerësuam, për t’u distancuar nga ajo gjendje, pasi nuk kishim asnjë lidhje me përmbajtjen e vetëdeklarimit, kurrë nuk kishim ndërtuar objekt as në Vlorë dhe në asnjë vend tjetër. Më pas kur rezultoi se ishin dy vetëdeklarimet e konstatuara me të drejtë nga ana Juaj, morëm masa definitive për të sqaruar situatën nëpërmjet institucionit të ALUIZNI-t Vlorë, duke iu drejtuar me dy kërkesa respektive për verifikimin në vend të fiktivitetit të përmbajtjes së tyre, dhe të shpreheshin me vendim për skualifikim, pikërisht për shkakun se në secilin rast mungon objekti i vetëdeklaruar. Siç ju shpjegova këto vetedeklarime kanë pasur përmbajtje tërësisht fiktive dhe në këtë rast përgjegjës për lejimin e kësaj shtate kanë qenë edhe punonjësit e institucionit të ALUIZNI-t Vlorë, por në pamundësi identifikimi të tyre, nuk kam paraqitur kallëzim penal.

- Nga dokumentacioni i administruar rezulton se bashkëshorti i subjektit ka kërkuar pranë ALUIZNI-t përjashtimin apo skualifikimin nga vetëdeklarimi i dy aplikimeve, për të cilët ka deklaruar se ato nuk janë plotësuar prej tij dhe se nuk përputhen me gjendjen faktike, pasi në terren nuk ka ndërtuar dhe nuk ekziston asnjëri nga objektet e deklaruara. Mbi këto kërkesa ZVRPP-ja Vlorë ka urdhëruar⁷⁶ mospërfshirjen në procesin e legalizimit të objektit informal të aplikuar për legalizim nga subjekti.

- Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, në raport me dokumentacionin e depozituar, më konkretisht me vendimet përkatëse të ish/ZVRPP-së Vlorë, me nr. ***, datë 21.2.2019 dhe nr. ***, datë 21.2.2019, “Për mospërfshirje në procesin e legalizimit të subjektit aplikues me nr. *** prot., viti 2013 dhe nr. *** prot., viti 2013”, por edhe nga verifikimi i praktikave nuk konstatoi asnjë provë që tregonte ndërtime apo investime të kryera, pagesa në

⁷⁶ Me urdhërin nr. ***prot.,dhe ***prot., datë 21.2.2019, me të cilët ka arsytuar.

përputhje me legjislacionin e legalizimit të ndërtimeve informale, mbajtje korrespondencash institucionale, etj, dhe për pasojë nuk krijoi dyshime lidhur me këtë çështje.

GJETJE TË TJERA

13. Në lidhje me gjendjen *cash* të vitit 2005

13.1 Komisionit i rezultoi se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 shumën 950.000 lekë si likuiditet në banesë. Komisioni e ka pyetur⁷⁷ subjektin në lidhje me deklaratimet e gjendjes *cash* dhe, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Në këtë deklaram të parë, për shkak të mungesës së përvojës, nuk kam deklaruar gjendjen cash të akumuluar për periudhën para deklaramit si më sipër dhe, për rrjedhojë, në deklaramin e datës 4.3.2006 deklaram i plotë për gjithë periudhën, kam deklaruar gjendjen cash në masën 950.000 lekë, përfshirë kursimet e mëparshme dhe ato nga puna ime si gjyqtare (stazhiere) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për periudhën 17.9.2004 - 31.12.2005. Këto kursime kanë qenë tërësisht nga të ardhurat e mia personale të akumuluar si më sipër. Gjatë kësaj periudhe bashkëshorti im Dh.M. ka pasur të ardhura page nga puna pranë KSHKK Pronave Tiranë, gjithsej në masën e 86.533 lekë, pasi për periudhën 2001-2005 bashkëshorti im ka frekuentuar Fakultetin e Drejtësisë Tiranë në sistemin me shkëputje nga puna, dhe shpenzimet e tij janë mbuluar në mënyrë periodike nga babai i tij I. M. . Në lidhje me këtë moment sqaroj se, babai i bashkëshortit tim, ka pasur të krijuara, ndër vite, të ardhura të konsiderueshme me burim shitjen e pasurisë së tij të paluajtshme, për të cilat kam paraqitur më parë dokumentacion ligjor tregues....prindërit e bashkëshortit tim kanë qenë në vijimësi mbështetës të djalit të tyre Dh.M. dhe dy fëmijëve të tjerë për të mundësuar lehtësimin e nevojave për jetesë për secilin, sa herë ka qenë e nevojshme”*.

Nisur nga deklaratimet e subjektit se prindërit e bashkëshortit kanë qenë në vijimësi mbështetës të djalit të tyre, ligji i vendos ato në cilësinë e personave të tjerë të lidhur dhe, për pasojë, subjekti është pyetur⁷⁸ lidhur me kontributin e dhënë dhe burimin e ligjshëm të tij.

- Në përgjigjen e dhënë subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“... përgjatë periudhës deklaruese, prindërit e bashkëshortit kanë dhënë ndihmë financiare në cash, që në asnjë vit nuk kanë kaluar në total shumën e 300.000 lekëve të reja, dhe në varësi të situatës, janë përdorur nga ana jonë, për pagim të kësteve të kredisë, kësteve të shkollimit të djalit në shkollë jopublike (në vitet që ka frekuentuar shkollë jopublike. ...për sa i takon mundësisë së të ardhurave të ligjshme të vjehrrit tim për të dhënë ndihmën e përshkruar më lart, përveç kontratave të shitjes së pjesshme të pasurisë së tij të paluajtshme të trashëguar (të cilat kanë qenë të shumta), dua t’ju paraqes edhe fakte të qarta dokumentare, që tregojnë fitimet e mundshme dhe reale që ai ka pasur nga kultivimi i ullirit. Përfundimisht sqaroj se përgjatë gjithë periudhës deklaruese, jemi ndihmuar rregullisht nga prindërit e bashkëshortit me të ardhura të dhëna cash, që për çdo vit deklarues nuk kanë kaluar shumën e 300.000 lekëve të reja, por kanë qenë afër kësaj shume çdo vit.”*

Subjekti për të provuar burimin e të ardhurave ka depozituar certifikata pasurie të ullahteve në emër të babait të bashkëshortit, kontrata shitje të pasurive të paluajtshme prej vitit 1996, si dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.6.2020.

13.2 Në lidhje me këtë ndihmë të pretenduar si e dhënë në mënyrë konsistente nga vjehrrit, trupi gjykues e ka pyetur subjektin edhe në seancë dëgjimore:(i) nëse shuma e dhënë është në nivelin e detyrimit për t’u deklaruar si një dhurim i mundshëm, apo ka qenë e padetyrueshme nga këndvështrimi i parashikimeve ligjore për deklaratimet vjetore ku ka pikërisht edhe një parashikim; (ii) ku subjekti duhet të deklarojë mbi të ardhurat ose dhurimet, pavarësisht se në

⁷⁷ Pyetësori nr.3, datë 29.1.2020.

⁷⁸ Pyetësori nr. 6, datë 28.5.2020.

këtë rast nuk është një dhurim klasik, por gjithësesi është një kontribut financiar që ka shkuar në interes të familjes së saj dhe si rrjedhojë; (iii) ka çliruar mundësi dhe hapësira të një kursimi më të madh. Subjekti ka qartësuar se ligjërisht nuk është i parashikuar detyrimi për deklarimin e kësaj lloj forme të marrjes së këtij përfitimi.

13.2.i Trupit gjykues nisur nga hetimi i kryer për të ardhurat e krijuara nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, përveçse i ka rezultuar se ky i fundit ka realizuar të ardhura të konsiderueshme nga shitja e pasurive⁷⁹ të paluajtshme, nga ana tjetër nuk i ka rezultuar sipas korrespondencave institucionale të administruara në dosjen e hetimit administrativ që të ketë kryer investime në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme. Në këtë këndvështrim, trupit gjykues i krijohet bindja se vjehri i subjektit ka qenë në kushte të tilla financiare për të mundësuar dhënien e kësaj shume vit pas viti subjektit.

13.3 Në vijim, për provueshmërinë e gjendjes *cash*, Komisioni kreu analizën financiare⁸⁰ për të vlerësuar mundësinë e kursimit të shumës 950.000 lekë sipas deklarimit periodik të bërë nga subjekti, nga ku ky i fundit ka rezultuar në balancë negative në shumën 223.298 lekë. Nisur nga fakti se subjekti ka rezultuar në balancë negative të shpërndarë në disa vite, ku përfshihet edhe ky vit kalendarik, sikurse pasqyrohet në tabelën nr.5, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës⁸¹ për të provuar të kundërtën. Në këto kushte dhe qartësimi edhe konkluzioni për këtë pikë arsyetohet në vijim në pikën nr.15.

14. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit

- Në deklaratat periodike subjekti ka deklaruar në total 14.055.323 lekë të ardhura nga punësimi për bashkëshortin e saj.

- Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vlerën 11.193.073 lekë të ardhura nga punësimi.

- Gjatë hetimit administrativ, Komisionit nga përllogaritjet i kanë rezultuar të ardhura nga punësimi në emër të bashkëshortit të subjektit në shumën 10.215.510 lekë.

- Diferenca mes deklarimit *Vetting* dhe hetimit të Komisionit vjen kryesisht nga të ardhurat e aktivitetit privat të bashkëshortit si avokat për periudhën 2013 – 2016, ku në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si të ardhur, qarkullimin dhe jo fitimin.

14.1 Subjekti është pyetur⁸² në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga punësimi i bashkëshortit si avokat për vitet 2006, 2007 dhe 2009 dhe njëkohësisht i është kërkuar të dokumentojë burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

14.1.a Në përgjigjen e dhënë subjekti ka sqaruar se: “...në deklaratën *Vetting* unë nuk kam deklaruar të ardhura të ligjshme nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit tim Dh.M. si avokat për vitet 2006, 2007 dhe 2009, pasi i jam referuar ligjit që kërkon deklarimin e të ardhurave të tatuara dhe në këto periudha bashkëshorti im nuk ka ushtruar këtë aktivitet në bazë të një nipti tatimor, por mbi bazën e porosive nëpërmjet prokurave të posaçme, duke dhënë ndihmë juridike dhe përfaqësim në gjykim si përfaqësues me prokurë. Për të ardhurat e përfituara në mënyrë sporadike nëpërmjet përfaqësimeve me prokurë, nuk ka paguar tatime dhe është ky shkak që nuk i kam deklaruar në deklaratën *Vetting* si të ardhura të ligjshme. Këto të ardhura që eventualisht mund të jenë deklaruar në deklaratat periodike, kanë ndihmuar ekonominë tonë familjare, por nuk kanë shërbyer për krijimin e asnjë lloj pasurie dhe janë të parëndësishme për ne, sa i takon balancës të ardhura-shpenzime.

⁷⁹ Realizuar kryesisht përpara martesës dhe emërimit në detyrë, të subjektit të rivlerësimit.

⁸⁰ Referojuni tabelës nr. 5. Shuma 950.000 lekë është përllogaritur si e krijuar brenda vitit 2005, sipas deklarimit të bërë në deklaratën përkatëse të këtij viti kalendarik.

⁸¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

⁸² Me pyetësin nr. 5, datë 6.4.2020.

Subjekti ka depozituar disa prokura që tregojnë këtë mënyrë veprimi të bashkëshortit, ndër vite, para hapjes së niptit tatimor si avokat, ndërsa ka konfirmuar se është në përpjekje për gjetjen e akteve të tjera të përfaqësimit nëpërmjet të cilave bashkëshorti i saj ka kryer veprime proceduriale dhe gjyqësore për të tretët, nëpërmjet ekzekutimit të porosive për periudhën referuese.

14.2 Po ashtu, subjekti është pyetur lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit në Universitetin e Vlorës, të deklaruara vetëm në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, dhe jo në deklaratën *Vetting*.

14.2.a Në përgjigjen e dhënë subjekti ka deklaruar: “...në deklaratën *Vetting* unë nuk kam deklaruar të ardhura të ligjshme nga punësimi i bashkëshortit tim, z.Dh. M., në Universitetin e Vlorës pasi, i jam referuar ligjit që kërkon deklarimin e të ardhurave të tatuara dhe nga kërkimet në atë moment për dokumentacion ligjor që vërteton marrjen e shpërblimit, nuk kam arritur të gjej dokumentacion. Bashkëshorti im ka ushtruar mësimdhënien në këtë universitet si pedagog dhe nuk kam dijeni se përse nuk gjen pasqyrim honorari i përfituar. Më gjithatë sqaroj se, këto të ardhura që janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007, nuk kanë ndihmuar ekonominë tonë familjare, apo për më tepër nuk kanë shërbyer për krijimin e asnjë lloj pasurie, pasi më shumë kanë qenë të ardhura minimale për të përballuar shpenzimet e tij personale. Në vitin 2007 i kam deklaruar tërësisht në kushte sinqeriteti, pasi bashkëshorti jepte realisht mësim në universitet dhe më deklaroi një shumë honorarësh siç unë e kam deklaruar. Në atë kohë nuk kam referuar në ndonjë dokument ligjor, por në deklarimin e bashkëshortit. Në lidhje me sa kam sqaruar më lart, deri më tani kemi arritur të gjejmë akte të universitetit që tregojnë faktin e emërimit dhe ushtrimit të mësimdhënies së bashkëshortit atje, që vërtetojnë se ai realisht ka qenë pedagog i jashtëm në universitet. Për të mos fshehur asgjë, në deklarimin periodik kam pasqyruar shumën e përfituar, bazuar në deklarimet verbale të bashkëshortit, ndërsa në deklarimin *Vetting* nuk i kam deklaruar, pasi më mungonte dokumentacioni i ligjërimit të tyre. Subjekti ka deklaruar se është në kërkim të këtij dokumentacioni nga Univeriteti i Vlores, të cilin akoma nuk e ka administruar, për shkak të pengesave të krijuara nga *Pandemia*, por dhe mosadministrimit të rregullt të këtyre akteve nga Universiteti i Vlorës.

- Subjekti ka depozituar dokumentacionin që pasqyron emërimin e bashkëshortit, z. Dh. M., si pedagog i jashtëm.

- Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në raport edhe me shpjegimet e subjektit, u konstatuan: (i) mospërputhje mbi të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit, deklaruar në deklaratat periodike, me të ardhurat e deklaruara në deklaratën për *Vetting*, në raport me të ardhurat e dokumentuara; (ii) deri në dërgimin e rezultateve të hetimit nuk u provuan me dokumentacion të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat për vitet 2006, 2007 dhe 2009 dhe të ardhurat nga punësimi në Universitetin e Vlorës; si dhe (iii) nuk ishin deklaruar nga subjekti, në deklaratën për *Vetting*, të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit të saj në Universitetin e Vlorës dhe, për pasojë, subjektit iu kërkuan shpjegime⁸³ lidhur me këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

14.3 Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se i qëndron shpjegimeve të dhëna në pyetësonin nr.5, pasi gjithë sa është konstatuar nga Komisioni, qëndron ashtu siç është konstatuar. Subjekti ka ripërsëritur se: “Në deklaratën *Vetting* unë nuk kam deklaruar të ardhura të ligjshme nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit tim Dh. M. si avokat për vitet 2006, 2007 dhe 2009 dhe as nga punësimi në Universitetin e Vlorës, pasi, duke iu referuar përmbajtjes së ligjit për rivlerësimin kalimtar, kam vlerësuar se në respektim të ligjit, duhet të deklaroja vetëm ato të

⁸³ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

ardhura, për të cilat konfirmohet ligjshmëria nëpërmjet pagimit të tatimit mbi të ardhurat, dhe në këto periudha që Ju citoni, bashkëshorti im nuk ka ushtruar aktivitetin e avokatit në bazë të një nipti tatimor, por mbi bazën e porosive nëpërmjet prokurave të posaçme, duke dhënë ndihmë juridike dhe përfaqësim në gjykim si përfaqësues me prokurë. Për të ardhurat e përfituara në mënyrë sporadike nëpërmjet përfaqësimeve me prokurë, nuk ka paguar tatime, dhe siç kam shpjeguar, është ky shkaku që nuk i kam deklaruar në deklaratën Vetting si të ardhura të ligjshme, duke krijuar mospërputhjen e konstatuar nga ana Juaj. Këto të ardhura që janë deklaruar në deklaratat periodike, kanë ndihmuar ekonominë tonë familjare, por nuk kanë shërbyer për krijimin e asnjë lloj pasurie. Në deklaratimet periodike, nuk jemi orientuar në deklarimin e çdo lloj të ardhure, duke u bazuar te pagimi i tatimeve, por e kam deklaruar ashtu siç kishte ndodhur në fakt.

E njëjta gjë vlen edhe për të ardhurat në formë honorari nga punësimi në Universitetin e Vlorës, nuk i kam deklaruar në deklaratën Vetting në zbatim të ligjit, pasi nga kërkimet në atë moment për dokumentacion ligjor që vërteton marrjen e shpërblimit, nuk kam arritur të gjej. Bashkëshorti im ka ushtruar mësimdhënien në këtë universitet si pedagog i jashtëm, fakt për të cilin unë ju kam paraqitur aktet e emërimit, por as aktualisht nuk kam dijeni se përse nuk gjen pasqyrim honorari i përfutur, që megjithë kërkimet tona deri në këtë fazë, nuk kemi arritur të gjejmë dokumentacion ligjor që vërteton marrjen e shpërblimit. Megjithatë, siç ju kam shpjeguar edhe më parë, sqaroj se, këto të ardhura që janë deklaruar në deklaratat periodike, si ato që lidhen me përfaqësimet me prokurë dhe ato në Universitetin e Vlorës, nuk ndikojnë në balancën tonë financiare, e për më tepër nuk kam patur asnjë pretendim apo deklarim se kanë shërbyer si burim i ligjshëm për krijimin e ndonjë pasurie përgjatë viteve të deklaratimit. Në deklaratimet periodike i kam deklaruar tërësisht në kushte singëriteti, pasi bashkëshorti im kryente përfaqësime me prokurë dhe kishte një shpërblim në çdo rast, sikurse dhe jepte mësim në universitet dhe me deklaroi një shumë honorarësh sic unë e kam deklaruar. Në atë kohë nuk kam referuar në ndonjë dokument ligjor. Dokument ligjor nuk kam arritur të gjej as tani, nga kërkimi nëpër arkivën e tij, nuk ka gjetur prokura të tjera, ka kaluar kohë dhe eventualisht mund t'i ketë asgjësuar, duke mos i vlerësuar të rëndësishme (siç më referon). Pra, e gjithë mospërputhja që ju konstatojnë, është pikërisht ashtu, dhe unë vetë nuk i kam deklaruar, në rrethanat që nuk i vërtetoj dot me dokument ligjor. Këto shuma të deklaruara më parë periodikisht, nese ju do të vlerësoni të mos njihen si pjesë e të ardhurave tona të ligjshme, unë nuk kam asnjë pretendim të kundërt, sepse nuk i vërtetoj dot më tepër se kaq dhe nuk i kam referuar si burim për krijim pasurie, as në deklaratat periodike dhe as në atë Vetting. Unë kam arritur t'ju sjell gjurmë (prokura përfaqësimi dhe akte emërimi) se, nuk kam gënjyer në deklarimet periodike, por nuk gjej dot dokumentacion të mëtejshëm që justifikon ligjërisht këto të ardhura.”

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

- Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, në raport edhe me dokumentacionin e administruar, arsyeton si vijon:

- Konstatimet për mospërputhjet e të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i subjektit për vitet 2006, 2007 dhe 2009 nga ushtrimi i aktivitetit të tij privat si avokat por edhe si pedagog në mësimdhënie në universitet, janë pranuar nga subjekti dhe njëkohësisht edhe janë sqaruar se përse janë deklaruar në këto vite dhe përse nuk janë deklaruar në deklaratën Vetting. Në një përshkrim të përgjithshëm vetë subjekti me shpjegimet e saj të detajuara pranon bërjen transparente të shumave të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të saj, por deklaroi se të ardhurat e krijuara nuk ligjëroheshin sipas parashikimit të ligjit nr.84/2016 dhe në këtë kontekst dakordësohet me mospërllogaritjen e shumave, që në një logjikë të drejtë pasqyrojnë vetëdijen e saj në raport me deklarimet periodike, si dhe kuptueshmërinë e drejtë të ligjit nr.84/2016, mbi

parashikimin se cilat quhen të ardhura të ligjshme. Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, vëren që prokurat e dhëna në adresë të bashkëshortit të subjektit për përfaqësime në procese gjyqësore, vërtet mund të kenë provë ligjore për shkaqet dhe arsyet për të cilat janë lëshuar, pra, për mbrojtje të palëve ndërgjyqëse, por se ato janë thjesht dhe vetëm prova indirekte që tregojnë marrëdhënie punësimi por nuk provojnë ligjshmërinë e të ardhurave.

- Trupi gjykues nga njëra anë ka konstatuar se subjekti nuk ka investuar në pasuri në këto vite, por nga ana tjetër për sa kohë të ardhurat ato kanë mbetur në nivel deklarativ as edhe nuk i ka përlloritur në bilancin financiar tërësor të subjektit për vitet 2004 – 2016.

- Në kushte të tilla, subjekti vijon të mbetet në balancë negative për vitin 2006, por në nivel të papërfillshëm sikurse citohet më sipër, balancë e cila nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit.

- Nga ana tjetër, megjithëse subjekti në vitet 2007 dhe 2009 nuk rezulton në balancë negative dhe faktet e konstatuara mbetën të pakontestuara prej saj, mospërputhjet e të ardhurave të deklaruara për këto dy vite por edhe për vitin 2006, trupi gjykues nuk i sheh si rrethana penalizuese për këtë çështje objekt hetimi dhe vlerësimi.

15. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ishte në balancë negative edhe për vitet 2005, 2010 dhe 2012 – 2014 në shumën 921.345 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 5

	Përshkrimi	2005	2010	2012	2013	2014
1	TË ARDHURA	1.149,04	1.521,39	1.888,14	1.916,08	1.827,87
		2	1	9	7	9
	Të ardhura nga paga subjekti	762,489	823,378	960,537	1,015,827	1,266,693
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	86,553	398,013	627,612	600,260	261,186
	Ndihmë financiare nga vjehtëri	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000
2	SHPENZIME	412,671	1,515,79	1,786,49	2,133,04	2,143,78
			0	4	6	8
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	328,671	546,480	564,096	564,096	879,992
	Shpenzime qiraje	84,000				
	Shpenzime shkollimi djalit në kolegjin ***	-	315,099	391,216	392,588	406,319
	Shpenzime TIMS	-	-	230,340	395,392	80,563
	Kredi në NBG, më 14.3.2006 (principal+interes) 45.000 euro	-	629,087	575,134	755,311	750,994
	Shpenzime sigurimi për kredinë	-	25,125	25,708	25,658	25,920
3	PASURI	959,669	257,691	247,559	(26,020)	(206,796)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme					
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	959,669	257,691	247,559	(26,020)	(206,796)
	DIFERENCA(1-2-3)	-223,298	-252,090	-145,904	-190,939	-109,114

15.1 Gjatë hetimit u vërejt se subjekti nuk kishte kryer investime në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme gjatë këtyre viteve, por u konstatua se kishte shpenzime më të larta se sa të ardhurat vjetore.

15.2 Nga analiza financiare e Komisionit për vitet 2005, 2010 dhe 2012 – 2014, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën totale prej 921.345lekësh, për të

përballuar të gjitha shpenzimet familjare dhe për pasojë iu kalua barra e provës⁸⁴ për të provuar të kundërtën mbi këto konstatime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

15.3 Subjekti në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “ *Në përgjigje të pyetësorit nr.7 dhe më parë kam deklaruar se, për blerjen e automjetit Fiat në vitin 2003, janë paguar me të ardhurat e mia vetëm shuma 100.000 lekë, ndërsa diferenca për zhdoganimin e tij me është dhënë nga vjehri I. M. në shumën 151.250 lekë, prandaj kjo shumë vlerësoj se nuk duhet të llogaritet si shpenzim nga të ardhurat e mia për periudhën përkatëse 2001-2003.*

Gjithashtu, kam shpjeguar më parë se shpenzimet për qiranë e apartamentit për periudhën e sipërcituar (para fillimit të deklarimit) janë paguar nga babai i bashkëshortit dhe vlerësoj se shuma 154,000 lekë nuk duhet të llogaritet si shpenzim nga të ardhurat e mia.

Siç rezulton në tabelën e sipërcituar në fund të vitit 2003 kam pasur mundësi për të kursyer shumën rreth 500.000 lekë me burim të ardhura e mia nga puna si OPGJ dhe magistratura. Këtë shumë siç ju kam shpjeguar në përgjigje të pyetësorëve, për shkak të mos dijenisë për të deklaruar gjendjen cash nga kursimet në deklarimin e parë periodik, kam pasaktësi në deklarim, prandaj i kam deklaruar të gjitha në total në fund të vitit 2005 në shumën 950.000 lekë. Siç shihet dhe nga analiza financiare e Komisioni edhe në vitin 2004 me të ardhura të ligjshme kam pasur mundësi të kursej. Vërej se nga ana juaj për krijimin e gjendjes cash prej 950.000 lekësh në fund të vitit 2005 (te Gjetje të Tjera), nuk janë marrë në konsideratë kursimet nga të ardhurat e mia para vitit 2005, duke nxjerrë për pasojë me balancë negative të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2005. Në analizën financiare të paraqitur me prapësimet kam marrë në konsideratë:(i) mundësinë për të kursyer cash në vitin 2003 dhe 2004 gjithsejt 500,000 lekë; (ii) llogaritjen e shpenzimeve jetike sipas ILDKPKI-së sipas numrit të pjesëtarëve të familjes, duke pasur parasysh se vajza ka lindur me 28 korrik 2010 (vetëm për 5 muaj shpenzime), ndërsa;(iii) për djalin e kam shpjeguar dhe më lart që ka jetuar me prindërit e mi dhe nuk duhet të përfshihet në masën e shpenzimeve jetike.”

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

- Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit, deklarimeve periodike, përgjigjeve në pyetësor, si dhe dokumenteve të administruar, arsyeton si vijon:

- Në tërësi duke iu referuar edhe viteve përkatëse ku rezultojnë balancat negative, përgjatë arsytimit më sipër të kësaj vendimmarrje janë qartësuar arsyet e mosmarrjes në konsideratë të *cash-it* të pretenduar, pavarësisht shpjegimit të subjektit lidhur me konceptimin e deklarimit të gjendjes *cash*, ku pretendon se shuma 950.000 lekë e deklaruar si gjendje *cash* në vitin 2005 nuk i përkiste vetëm këtij viti por të gjithë të ardhurave të grumbulluara më parë e deri në këtë vit. Tashmë është konsoliduar nga Komisioni por edhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit gjykimi i deklarimit të gjendjes *cash* dhe, për për këtë shkak, pretendimi i shtruar në këtë nivel nuk qëndron dhe, për pasojë, nuk merret në konsideratë.

- Po ashtu edhe pretendimin tjetër për të përfshirë në zhdoganimin e mjetit të deklaruar si pasuria nr. 1, më sipër, një pjesë të të ardhurave të dhëna nga vjehri i subjektit, trupi gjykues vlerëson të mos e marrë në konsideratë për sa kohë është një pretendim i sjellë së fundmi.

⁸⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

- Ndërsa në lidhje me reduktimin në përllogaritje të shpenzimeve të djalit të subjektit, trupi gjykues është shprehur më sipër duke ezauruar arsyetimin e bërë dhe, për pasojë, thjesht dhe vetëm rikonfirmon marrjen në konsideratë të këtij lloji shpenzimi.

- Në të njëjtën mënyrë, sipas përllogaritjeve të ILDKPKI-së, lidhur me shpenzimet jetike sipas numrit të anëtarëve të familjes, në përllogaritje deri në datën 28.7.2010 (kohë kur ka lindur vajza e subjektit), nuk përfshihet vajza e subjektit.

- Në të tilla kushte, trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor kreu rilllogaritjet financiare dhe balanca negative prej 921.345 lekësh e pasqyruar në tabelën nr.5, tashmë arrin në vlerën 204.312 lekë.

- Në përfundim, për kriterin e pasurisë, për të gjithë periudhën e deklaramit të subjektit, nëse më parë rezultoi se subjekti për vitet 2004 – 2016, gjendej në balancë negative në shumën 1.444.720 lekë, pas rilllogaritjeve me pretendimet e dokumentuara e të marra në konsideratë dhe të arsyetuara në këtë vendimmarrje, balanca negative është në shumën 492.594 lekë, balancë e shpërndarë në vite, e cila në raport me një vlerësim të përgjithshëm të kriterit të pasurisë dhe duke mbajtur në vëmendje parimin e proporcionalitetit, trupi gjykues çmon se nuk përbën shkak për aplikimin e ndonjë mase penalizuese ndaj subjektit të rivlerësimit. Të dhënat dhe treguesit financiarë për vlerësimin e këtij kriteri pasqyrohen në tabelën më poshtë.

Tabela nr.6

	Përshkrimi	2005	2006	2010	2012	2013	2016
1	TË ARDHURA	1,149,042	4,076,275	1,521,391	1,888,149	1,916,087	4,766,488
2	SHPENZIME	303,114	(4,536,128)	1,299,475	1,645,470	1,992,022	2,230,630
3	PASURI	959,669	8,728,601	257,691	247,559	(26,020)	2,707,942
	DIFERENCA(1-2-3)	-113,741	-116,198	-35,775	-4,880	-49,915	-172,084

II. KONTROLI I FIGURËS

Rezultatet në lidhje me kontrollin e figurës

1. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar(DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve (të mundshme) të papërshtatshme, me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

1.1 Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar në Komision raportin nr. ***, datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. *** datë 29.4.2020,të KDZh-së me konstatimin *për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.*

1.2 Më tej, Komisioni ka kërkuar përditësimin e këtij raporti.

1.3 Ky institucion pas kërkesës së Komisionit për përditësimin e raportit, me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2018, ka dërguar raportin e rishikuar me nr. *** prot., datë 7.12.2018, me konstatimin *për papërshtatshmëri* në vijimin e ushtrimit të detyrës. Ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 18.12.2018,të KDZh-së,në përputhje me pikën 2, tënenit 39, të ligjit nr. 84/2016.

1.3 Mbi informacionin e disponuar në raportin e deklasifikuar të DSIK-së, anëtarët e trupit gjykues së bashku me Vëzhguesin Ndërkombëtar lexuan informacionin e klasifikuar, në bazë të të cilave janë përpiluar raportet e DSIK-së.

1.3.1 Në raport citohet se nga informacioni i ardhur prej institucionit të verifikimit rezulton se:

i. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita B. Mici (H.), nga autoritetet verifikuese disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit në disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vitet kur ky subjekt rivlerësimi ka qenë pjesë e trupit gjykues në këtë gjykatë.

ii. Mbi bazën e të dhënave që disponohen për këtë subjekt rivlerësimi ngrihen dyshime se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, vendimin⁸⁵ e dhënë për gjykimin e çështjes penale⁸⁶ nr. ***e ka dhënë në kundërshtim me ligjin.

iii. Gjithashtu, për subjektine rivlerësimit, znj. Anita Mici, mbi bazën e të dhënave që disponohen hidhen dyshime që lidhjet e saj familjare si shtetasit F.N. H. e H. (R.) N. H. që janë djemtë e tezez së subjektit kundrejt përfitimit monetar (ryshfetit) në procese gjyqësore ku znj. Anita Mici ka qenë pjesë e trupit gjykues.

iv. Mbi bazën e të dhënave që disponohen, ngrihen dyshime që shtetasi H.(R.) N.H., mund të jetë proceduar penalisht për trafik të lëndëve narkotike⁸⁷ dhe është favorizuar në masën e dënimit nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, si pjesë e trupit gjykues.

v. Për shtetasin H. (R.) N. H., disponohen të dhëna në periudha të ndryshme kohore për përshirjen e tij në veprimtarinë e kundërligjshme të trafikut të drogës në bashkëpunim me lidhjet e saj, si...

vi. Për sa më sipër nga DSIK-janë mënyrë të përmbledhur është konkluduar se bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016:(i) të dhënat që disponohen për subjektin e rivlerësimit vlerësohen në papajtueshmëri të plotë me detyrën e saj; (ii) të afërmit e subjektit të vetëdeklaruar prej saj, njihen si persona të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar;(iii) të dhënat që disponohen nga autoritetet verifikuese hedhin dyshime mbi ekzistencën e një marrëdhënie korruptive, që i tejkalon marrëdhëniet familjare ndërmjet tyre;(iv) ngrihen dyshime se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, ka favorizuar për ulje dënimi, një prej kushërinjtëve saj dhe se kjo veprimtari e paligjshme e evidentuar nga autoriteti verifikues, i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

vii. DSIK-ja sipas kërkesave të nenit 39 të ligjit nr.84/2016, ka konstatuar se deklarata për kontrollin e figurës, nga subjekti i rivlerësimit nuk është plotësuar me saktësi dhe vërtetësi, *...subjekti i rivlerësimit, ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht në trafikun e lëndëve narkotike*. Në përfundim ky institucion ka konkluduar se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht kriterin e përcaktuar në germen “c”, të nenit 37, të ligjit nr.84/2016, duke u ndryshuar nga Grupi i Punës konstatimi fillestar.

a. Mbi konkludimin e DSIK-së, se mbi bazën e të dhënave që disponohen për këtë subjekt rivlerësimi ngrihen dyshime se:(i) subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, vendimin⁸⁸ për

⁸⁵ Vendimi nr. ***, datë 16.1.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁸⁶ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim çështjen penale nr. ***, në ngarkim të të pandehurve G.B. dhe E.B. për veprën penale: “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259 e 25 të Kodit Penal, të pandehurës D.N. për veprën penale: “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm të persoanve që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga nenet 245/1 të Kodit Penal dhe të pandehurës X. W. për veprën penale: “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 244/1 i Kodit penal.

⁸⁷ Vendimi nr. ***, datë 26.03.2010 i Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë e ka dënuar me 9 vjet e 4 muaj burgim për veprat penale “Trafikimi i lëndëve narkotike”, “Mbajtjes pa leje të armëve Luftarake” dhe “Mbajtjes pa leje të municionit luftarak”, parashikuar nga nenet 283/a/2, 278/2 e 278/3 dhe ka marrë formë të prerë me vendimin nr. ***, datë 15.6.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Tiranë.

⁸⁸ Vendimi nr. *** datë 16.1.2015, i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

gjykimin e çështjes penale⁸⁹ nr. ***, që i përket të pandehurit G.B., etj., e ka dhënë në kundërshtim me ligjin; dhe se (ii) ky vendim i dhënë është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës në Gjykatën e Apelit Durrës⁹⁰.

Komisioni ka administruar nga Gjykata e Lartë:

Dosjen që i përket vendimin nr. ***, datë 16.1.2015 (ku subjekti i rivlerësimit ka cilësinë e relatorit të çështjes), ku, ndër të tjera, është vendosur, *deklarimi i pafajshëm i të pandehurit G.B.* .

a.i Trupi gjykues këtë çështje penale e ka analizuar në detaje në kriterin e kontrollit profesional (referuar në vijim në pikën III/4) dhe në përfundim nuk i kanë rezultuar problematika apo shkelje me pasojë dhënien e vendimit në kundërshtim me ligjin.

b. Mbi konkludimin tjetër të DSIK-së, ku thuhet se, gjithashtu, për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Mici, mbi bazën e të dhënave që disponohen hidhen dyshime që: **(i)** lidhjet e saj familjare me shtetasit F. N. H. e H. (R.) N. H. që janë djemtë e tezez së subjektit kundrejt përfitimit monetar (ryshfetit) në procese gjyqësore ku znj. Anita Mici ka qenë pjesë e trupit gjykues; **(ii)** mbi bazën e të dhënave që disponohen, ngrihen dyshime që shtetasi H.(R.) N. H., mund të jetë proceduar penalisht për trafik të lëndëve narkotike⁹¹ dhe është favorizuar në masën e dënimit nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, si pjesë e trupit gjykues; dhe se **(iii)** për shtetasin H.(R.) N. H., disponohen të dhëna në periudha të ndryshme kohore për përhshirjen e tij në veprimtarinë e kundërligjshme të trafikut të drogës në bashkëpunim me lidhjet e saj, *si...*,

b/i Komisioni ka hetuar dhe analizuar veçmas secilin prej konkludimeve në këtë shkronjë. Më konkretisht, Komisioni duke konstatuar se DSIK-ja nuk ka dhënë *indicie* apo çështje konkrete për t'u administruar dhe hetuar mbi konkludimin e saj, *për lidhjet familjare të subjektit, të shtetasve F.N. H. e H. (R.) N.H. që janë djemtë e tezez së subjektit kundrejt përfitimit monetar (ryshfetit) në procese gjyqësore ku Anita Mici ka qenë pjesë e trupit gjykues*, nisur nga një denoncim⁹² i adresuar sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar dosjet penale si vijon, si edhe të dhënat e tjera të paraqitura nga denoncuesi.

i) Dosja gjyqësore⁹³ që i përket vendimit nr. ***, datë 21. 3.2014, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, mbi kërkesën e shtetasit E. K., për “ulje dënimi”. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se kërkuuesi me kërkesën e tij në seancën e datës 21.3.2014 ka hequr dorë nga gjykimi i kërkesës dhe, për pasojë, gjykata ka vendosur “pushimin e gjykimit”, vendim i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

ii) Dosja gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 10.4.2014, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, mbi kërkesën e të dënuarit A.K., për “ulje dënimi”.

⁸⁹ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim çështjen penale nr. 1273/2014 në ngarkim të të pandehurve G. B. dhe E. B. për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 259 e 25 të Kodit Penal, të pandehurës D.N. për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm të persoanve që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga nenet 245/1 të Kodit Penal dhe të pandehurin X. W. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 244/1 i Kodit penal.

⁹⁰ Vendimi nr. ***, datë 11.4.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës.

⁹¹ Vendimi nr. ***, datë 26.3.2010, i Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë e ka dënuar me 9 vjet e 4 muaj burgim për veprat penale “trafikimi i lëndëve narkotike”, “Mbajtjes pa leje të armëve Luftarake” dhe “mbajtjes pa leje të municionit luftarak”, parashikuar nga nenet 283/a/2, 278/2 e 278/3 dhe ka marrë formë të prerë me vendimin nr. 31, datë 15.6.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

⁹² Nr. *** prot., datë 22.2.2019, i shtetasit N. B. (denoncim i sjellë në mënyrë elektronike), nr. *** prot., datë 6.5.2019. Denoncuesi në ankimin e tij ka synuar të informojë gjërësisht mbi problematika të shumta, të identifikuara sipas tij, në adresë të subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi ka informuar edhe për procese favorizuese gjyqësore të zhvilluara prej subjektit. Ai shpjegimet e tij i ka ilustruar edhe me foto, formularë të procesve gjyqësore të printuar nga sistemi gjyqësor tek të cilët subjekti pasqyrohet si gjyqtare e çështjeve, etj. Denoncuesi ka depozituar një numër të konsiderueshëm fotosh, formularë të QKR-së ku identifikohet biznesi i ushtruar nga djali i tezez së subjektit (sipas pretendimeve të denoncuesit).

⁹³ Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2020.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës, uljen e dënimit nga dënimi i mbetur pa vuajtur, i dhënë me nr. ***, datë 6.11.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në masën 90 ditë.

iii) Dosja gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 19.5.2014, të dhënë nga subjekti, mbi kërkesën “për lirim para kohe me kusht”, nga i dënuari A.K. . Gjykata pas konkluzioneve të prokurorit i cili ka shprehur dakortësinë lidhur me kërkesën e të dënuarit, *ka vendosur pranimin e kërkesës*, vendim i cili nuk është ankimuar.

iv) Dosja gjyqësore që i përket vendimin nr. ***, datë 20.9.2013, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ndaj të pandehurit E. K., nën akuzën e vleftësimit të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal. Subjekti i rivlerësimit mbi kërkesën e organit të prokurorisë, për vlerësimin si të ligjshëm të “arrestit në flagrancë” të shtetasit E.K., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ka vendosur njëjtë sipas kërkesës së prokurorit, vendim i cili nuk është ankimuar.

v) Dosja gjyqësore që i përket vendimit nr*** datë 18.4.2016, dhënë nga subjekti, ndaj të pandehurit P. D., akuzuar për veprën penale “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal.

Subjekti i rivlerësimit në këtë proces gjyqësor, mbi kërkesën e organit të prokurorisë i cili ka kërkuar deklarin fajtor të pandehurit dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim duke aplikuar edhe nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 40 ditë burgim dhe po ashtu në zbatim të nenit 63/1 të Kodit Penal, ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim duke u urdhëruar i pandehuri të punojë në funksion të publikut pa shpërblim për një periudhë prej 120 orë, brenda 6 muajve nga marrja formë e prerë e vendimit, duke mbajtur gjithashtu kontakte me shërbimin e provës.

b/1.a Në vështrim të verifikimit dhe hetimit të lartpërmendur, Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime shpjegime, duke mbajtur në vëmendje dhe duke iu referuar të gjithë dokumenteve të depozituara në mbështetje të denoncimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në parashtrimet e sa,j ndër të tjera, ka parashtruar: *“Në kuadër të një hetimi administrativ të thellë, verej se ju keni hetuar edhe çdo pretendim të denoncuesit N. B., duke marrë të gjitha dosjet gjyqësore penale që ai citon në denoncimin e tij, për të cilat unë më poshtë do të jap vlerësimet e mia, edhe pse nuk arsyen përse.”*

Subjekti ka sqaruar se pretendimet e denoncuesit janë të pabaza dhe se nga verifikimi për ekzistencën e shtetasit N. B., nga të dhënat e marra zyrtarisht nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Durrës, nuk rezulton se ekziston një shtetas i tillë. Subjekti ka kërkuar që denoncimi i këtij personi të fshehur nën emrin N. B., të vlerësohet nga Komisioni si denoncim anonim dhe të mos merret fare në konsideratë (sipas ligjit), ndërsa është shprehur se në respektim të konkludimit për të dhënë shpjegime ka detajuar lidhur me vendimmarrjet për të cilat denoncuesi ka cituar se i konsideron favorizuese, si vijon:

“... në lidhje me vendimmarrjet që citon ky person anonim, duke mos pasur asgjë për t’u shqetësuar në punën time, po Jua jap shpjegimet, si vijon:

- Datë 21.3.2014, kërkues E.K., objekt: “ulje denimi”, përfunduar me pushim gjykimi. Pushim gjykimi do të thotë zero rezultat përfundimtar në vendimmarrje. Kjo do të thotë se asgjë nuk shkon në favor të aludimeve denoncuese.

- Datë 20.9.2013 E. K., objekt: “vlerësim arresti në flagrancë e caktim mase sigurimi”, përfunduar me pranim të kërkesave të prokurorit të çështjes. Caktuar masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, sipas kërkesës së akuzës. Në bazë të nenit 244, pika 3) të Kodit të Procedurës Penale: “gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndësishme ajo e kërkuar nga prokurori”, vendimi im nuk mund kurrsesi të paraqiste një masë më të rëndësishme, do të ishte shkelje flagrante e ligjit. Nga ana tjetër, edhe prokurori i çështjes në thelb ka paraqitur një kërkesë të drejtë në drejtim të caktimit të masës së sigurimit pasi, ky shtetas ishte arrestuar për një sasi prej 2.05 gram *cannabis sativa*, në kushtet e të qenit përdorues i kësaj lënde. Në këto raste për shkak të sasisë së vogël dhe faktit të qenit subjektit përdorues, fakti penal është në kufijtë e përjashtimit nga vepra penale, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal që bën fjalë për dozën e vogël për përdorim vetjak, *elaboruar* edhe nga Gjykata e Lartë me vendim të Kolegjeve të Bashkuara. Edhe në këtë rast vendimi i është në përputhje të plotë me ligjin, e kundërta do të më penalizonte për shkelje të ligjit. Pra, jemi në zero rezultat në favor të shpifjeve të tij.
- Datë 10.4.2014, kërkesues A.K., objekt “ulje dënimi”, përfunduar me pranimin e kërkesës. Vendimi është bazuar plotësisht në aktet provuese të sjella nga institucioni ndihmës IEVP Durrës dhe nga aktet kam vlerësuar se kanë qenë të gjitha kushtet ligjore që ky i dënuar të përfitojë nga ligji. Siç edhe keni konstatuar, i dënuari nuk ka pasur asnjë të dhënë që të cenonte pranimin e kërkesës. Në kushtet e një kërkesë të bazuar në ligj dhe në prova, vlerësoj se gjyqtari duhet të penalizohet nëse konkludon në rrëzimin e pabazuar të kërkesës. Atë që çdo qytetari ia jep ligji dhe faktet që provohen para gjykatës, vlerësoj se nuk mund dhe nuk duhet të ketë gjyqtar që të mos ia japi, se drejtësinë askush nuk e ka prone private, do e jep dhe do nuk e jep. Qëndrimi im në të gjitha këto lloj gjykimesh (nuk kam gjykuar vetëm A.K.), ka qenë koherent, duke vlerësuar provat për të gjithë njëlloj. Vetëm nëse Ju do ju vërtetohej se kam mbajtur qëndrime të ndryshme për fakte të njëjta, në lidhje me persona të ndryshëm, do të ishit në të drejtë të kërkitimit llogari se përse për njërin po dhe jo për tjetrin. Jeni të hapur të verifikoni në IEVP-të përkatëse dhe të intervistoni çdo të dënuar që ka aplikuar këto lloj kërkesash, se Ju thonë vetë se cila është vija ime vendimmarrëse, ***e njëjtë për të gjithë***. Në rast masash disiplinore të të dënuarve në institucion, apo sjellje që vijnë në kundërshtim me qëllimin e vuajtjes së dënimit, në kundërshtim me rehabilitimin e tyre, unë gjithmonë kam aplikuar rrëzimin e kërkesës, sepse ulja e dënimit në kuptim të ligjit, është shpërblim që ligji iu njeht të dënuarve, pikërisht për sjelljen e tyre të mirë në institucion, është një motivim në drejtim të rehabilitimit të tyre. Kur një i dënuar, për një vit me radhë (koha ligjore për përfitimin e uljes), ka mbajtur sjellje e qëndrim të tillë që çojnë në plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjit, kush jam unë si gjyqtar, që të rrezoj kërkitimin? A nuk duhet të më ndëshkojë mua një vendim që rrëzon në mënyrë të pabazuar një kërkesë ligjore, duke cenuar të drejtën e të dënuarit për liri? Unë mendoj se po, gjyqtarin duhet ta penalizojë rrëzimi i pabazuar i kërkesave dhe jo gjetja në përputhje me kriteret e ligjit të këtij kërkitimi.
- Datë 19.5.2014, kërkesues A.K., objekt “lirim me kusht”, përfunduar me pranimin e kërkesës, duke u dhënë liria me kusht. Kjo çështje, si dhe gjithë të tjerat është hetuar në mënyrë të plotë (ju keni aktet e dosjes gjyqësore), me praninë e institucioneve ndihmëse, Zyrën e Shërbimit të Provës, përfaqësuesin e akuzës. Në përfundim të marrjes së provave dhe gjithë shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesi i akuzës ka konkluduar në plotësimin e kërkesave ligjore për rastin dhe ka kërkuar nga gjykata të lirohet ky i dënuar, i cili plotëson tërësisht kërkesat e ligjit. Pasi u njoha me aktet e marra pranë Jush (pasi nga vendimi ka kaluar mjaft kohe), konstatoj se ky i dënuar ka pasur të gjitha

rrethanat ligjore për t'u liruar me kusht, sjellje permanente në IEVP në përputhje me ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, familje me 4 fëmijë të mitur në atë kohe, me nevoja të theksuara ekonomike, të gjithë fëmijët në shkollë, bashkëshortja e papunë. Në kushtet që ky i dënuar kishte një kohë të gjatë që vuante dënimin, familja e tij ishte në gjendje tejet të vështirë ekonomike, për shkak të mungesës së kryefamiljarit, babait të fëmijëve. Atij i ofrohej një punësim për të ndihmuar në familje. Tregonte nivel të lartë rehabilitimi, asnjë lloj shkelje apo veprimi tjetër në kundërshtim me ligjin. Kjo është në mënyrë të përmbledhur situata e këtij të dënuari, për të cilin edhe prokurori pati vlerësimin se ishin të gjitha kushtet e liritimit me kusht. Gjykoj se do të kisha shkelur ligjin nëse do kisha vendosur ndryshe.

- Datë 18.4.2016, i pandehur P. D., akuza 278/2 i Kodit Penal, deklaruar fajtor, dënuar me burgim dhe alternativën e neni 63 të Kodit Penal. Në zbatim të kritereve të nenit 47 të Kodit Penal, vlerësoj se kam caktuar një dënim të drejtë, proporcional dhe në funksion të arritjes së qëllimit të posaçëm në drejtim të të pandehurit dhe riintegritimit të tij në shoqëri pasi, fakti penal ka qenë mbajtja e municionit luftarak, në masën e 16 fishekë gjithësej, duke mos paraqitur rrezikshmëri të lartë shoqërore, pra, fakti penal nuk ka qenë posedim arme, por 16 fishekë municion. Nga ana tjetër, puna në interes publik pa kundërshtim (zakonisht punë në shërbimet komunale të institucioneve publike), është një lloj dënimi që sipas ligjit detyrimisht duhet pranuar nga i pandehuri, pasi ekzekutimi i saj, rast pas rasti mund të jetë e papranueshme nga subjekti, për shkak të vetë llojit të punës që ai detyrohet të kryejë. Në këtë kuadër, ky dënim është vlerësuar më shumë edukues për këtë të pandehur, në kushtet që të gjitha kërkesat e tjera të ligjit ishin të pranishme. Ligji penal, neni 278/2 i Kodit Penal kishte parashikuar edhe dënimin me gjobë, por kam vlerësuar se gjoba nuk do t'i jepte efektet e pritshme të dënimit, nuk do të cenonte aspak situatën e të pandehurit. Ndërsa puna në interes publik, do ta vinte atë në gjendje të përulur para ligjit dhe pritshmëritë për arritjen e qëllimit të dënimit ishin më të mëdha.

- Subjekti ka pretenduar se në asnjë prej rasteve të lartëpërmendura nuk gjenden të dhëna favorizuese dhe aq me keq korruptive, për të cilën bën fjalë ky person që nuk ekziston si i tillë. *Deklaroj (është shprehur ajo) se nuk kam asnjë lloj njohje, lidhje apo kontakti me të dënuarët që iu përmendet emri më sipër. Vendimet e dhëna janë rutinë e ushtrimit të detyrës dhe nuk kanë asgjë ndryshe nga të gjitha rastet e gjykimet e tjera me objekte të njëjta. Kam gjykuar me dhjetra e ndoshta qindra të dënuar me kërkime të tilla, në çdo rast vendimi im është bazuar vetëm në ligj dhe në fakte. Kur janë plotësuar kushtet ligjore, gjithkush ka përfituar atë që i njeh ligji. Në të kundërt, nuk është pranuar asnjë kërkesë në mungesë të kushteve të ligjit.*

- Po ashtu ka deklaruar se *DSIK-ja nuk ka identifikuar në asnjë rast se cili është kontakti i papërshtatshëm, me të cilin unë si subjekt rivlerësimi ose një person i lidhur me mua ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri, për të mbështetur konstatimin përfundimtar të saj, duke konkluduar në mënyrë të pabazuar mbi papërshtatshmërinë.*

Në analizë të situatës faktike, si më sipër, në raport me nenet 34 dhe 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoj (është shprehur subjekti) se informacioni i përcjellë nga DSIK-ja në raportin e dytë nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr.84/2016, pasi nuk referon në asnjë moment se cilët janë personat e përfshirë në krimin e organizuar, me të cilët subjekti ka pasur kontakte të tilla që të ketë shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri. Në përputhje me parimin e objektivitetit, raporti i DSIK-së për mua si subjekt rivlerësimi duhet të ishte konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij. Kjo pjesë i mbetet për të vlerësuar

Komisionit, se cilët kanë qenë personat e përfshirë në krimin e organizuar me të cilët kam kryer kontaktet e papërshtatshme, si dhe mbi cilat prova ka vërtetuar dyshimet DSIK-ja se kam pasur kontakte të papërshtatshme, me të cilët kam shkëmbyer para, dhurata, favore apo pasuri, rrethana këto të cilat nuk rezultojnë në asnjë fakt dhe prove, ndaj Raporti DSIK-së duhet vlerësuar i paplotë dhe i pabesueshëm.

- Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se në kuadër të verifikimit të pretendimeve në drejtim të figurës sime, në lidhje me çështje penale me objekt "lirim me kusht" apo të çdo lloji, për shtetasit P. B., K. V., E. P., A. P. (P.) dhe A. H. (per ekstradimin e tij), nga të gjitha përgjigjet zyrtare të administruara nga Komisioni, provohet qartësisht fakti se, unë si subjekt rivlerësimi me cilësinë e gjyqtarit, nuk kam kryer asnjë gjykim me këta shtetas sipas objektit të pretenduar, madje nuk kam kryer fare gjykime me këta shtetas. Rezulton qartësisht se, P. B., K. V. dhe E. P., nuk kanë pasur kurrë gjykime penale. Shtetasi A.P. është gjykuar në vitin 2001, kohë kur unë nuk kam qenë fare në ushtrim të detyrës, madje akoma nuk kisha nisur Shkollën e Magjistraturës, dhe vete aktet, tregojnë qartë se ky shtetas është gjykuar, pikërisht në vitin 2001 dhe nga një tjetër trup gjykues. Nuk kam arritur të kuptoj se, cili ka qenë shkaku që më lidh mua me këta persona, megjithatë hetimi ka treguar qartë se këta emra nuk kanë asnjë lloj lidhje me punën time, nuk kanë pasur kurrë gjykime, jo vetëm me mua si subjekt rivlerësimi.

Mbi procesin gjyqësor për shtetasin A. H. në lidhje me kërkesën e autoriteteve italiane për ekstradimin e tij, qartësisht rezulton se kam mbajtur qëndrim ligjor, duke u dorëhequr nga gjykimi me shkakun e parashtruar në kërkesën time, pranuar nga kryetari i gjykatës. Unë si subjekt në këtë rast kam marrë të gjitha masat ligjore për të mos lejuar asnjë aludim për njëanshmëri në gjykim, apo favorizim të këtij subjekti në gjykim. Këto fakte, në lartësinë e detyrës, ju i keni verifikuar më së miri me aktet e marra si prova.

Analiza e fakteve dhe provave në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, pas analizimit të fakteve dhe rrethanave për secilën dosje gjyqësore, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe akteve të administruara, nuk konstaton asnjë rrethanë faktike që të pasqyrojë/evidentojë ndonjë favorizim nga subjekti në zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe as në masën e dënimit të dhënë (kur ishte rasti) për secilin prej shtetasve të lartpërmendur. Trupi gjykues, sikurse ka analizuar dhe është shprehur më sipër për secilën prej çështjeve të verifikuara, konstaton se në tërësi vendimmarrjet e subjektit kanë qenë në një linjë me kërkesat e organit të akuzës dhe se ato kanë mbetur në fuqi pa u ankimuar. Gjithashtu, edhe subjekti ka synuar të sqarojë dhe argumentojë ligjërisht vlerësimin për secilën çështje gjyqësore. Trupi gjykues çmon se për sa kohë ligjërisht nuk është në tagrin e trupit gjykues të analizojë themelin e çështjes gjyqësore, atëherë parimisht, verifikimi i një çështjeje lidhet kryesisht me zvarritjet e saj në gjykim, qëndrimin e gjykatës në raport me atë të organit të akuzës, si dhe me ushtrimin e së drejtës ankimore nga pala, përmbyllur me vendimmarrjen e një gjykate më të lartë. Duke qenë se nuk rezultuan problematika në çështjet gjyqësore të verifikuara, arrihet në konkluzion se nuk u provua konkludimi i DSIK-së për implikim të subjektit në proceset gjyqësore, nga të afërmit e saj, djemt e tezes.

b/ii) Në vijim, në lidhje me konkludimin tjetër të DSIK-së se mbi bazën e të dhënave që disponohen, ngrihen dyshime që shtetasi H. (R.) N. H., mund të jetë proceduar penalisht për trafik të lëndëve narkotike⁹⁴ dhe është favorizuar në masën e dënimit nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, si pjesë e trupës gjykuese, Komisioni ka administruar dosjen penale në ngarkim të të pandehurve A. H., H.H. dhe F. H. etj., akuzuar për veprën penale "trafikim i narkotikëve",

⁹⁴ Vendimi nr. ***, datë 26.3.2010, i Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë e ka dënuar me 9 vjet e 4 muaj burgim për veprat penale "trafikim i lëndëve narkotike", "mbajtje pa leje e armëve luftarake" dhe "mbajtje pa leje të municionit luftarak", parashikuar nga nenet 283/a/2, 278/2 e 278/3 dhe ka marrë formë të prerë me vendimin nr. ***, datë 15.6.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

“organizim dhe drejtim i organizatave kriminale” “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake të municionit”, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, bazuar në nenet 283/a -2, 284/a, 278/2/3 të Kodit Penal, që i përket vendimit nr. ***, datë 26.3.2010⁹⁵, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me vendimin, e cila i ka deklaruar fajtorë të pandehurit duke i dënuar përkatësisht me 9 vjet e 4 muaj shtetasin H. H. dhe 8 vjet shtetasin F.H., vendim i cili ka mbetur në fuqi në të tria shkallët e gjyqimit.

b/ii.a Nga verifikimi i dosjeve gjyqësore penale rezultoi se vendimmarrjet janë gjykuar nga trupa gjyqësore ku në asnjërën prej tyre nuk identifikohet prezenca e subjektit të rivlerësimit. Trupi gjyqësor konstatoi se asokohe subjekti i rivlerësimit ka ushtruar dhe vijon të ushtrojë funksionin e saj në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe atë të apelit civil, pra, nuk ka ushtruar asnjëherë detyrën në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

b/ii.b Lidhur me këtë konkludim të DSIK-së, subjekti ka dhënë shpjegimet e saj, si vijon:

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti është shprehur se: “... nga hetimi është provuar qartësisht se nuk kam pjesëmarrje në asnjë lloj gjykimi si pjesë e trupës gjyqësore dhe kam qartësuar se edhe në kushtet e një njohësi të keq të ligjit, që të gjykonte si pjesë e trupit gjyqësor, kushëririn e tij, siç pretendohet në rastin konkret për mua si subjekt rivlerësimi, një gjë të tillë ligji e ndalon shprehimisht, duke vënë gjyqtarin para përgjegjësisë disiplinore. Gjatë gjithë ushtrimit të detyrës nga ana ime, në çdo ditë timen, jam përkujdesur maksimalisht për të shmangur konfliktin e interesit dhe papajtueshmërinë në çdo lloj gjykimi. Nuk kam lejuar asnjë rast papajtueshmërie dhe konflikti me ligjin. Djali i tezes është gjykuar dhe dënuar nga drejtësia shqiptare, pa asnjë lloj ndikimi nga ana ime, pasi ndryshe nga sa pretendohet në këtë raport, ai për krimin e kryer është deklaruar fajtor dhe dënuar me 14 vjet burgim, në nivelin e çdo qytetari tjetër të këtij vendi që ka kryer krim të njëjtë me të”.

b/ii.c Lidhur me sa më lart trupi gjyqësor çmon se nuk u provua pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në këtë proces gjyqësor dhe as nuk u arrit të provohej ndikimi i saj në vendimmarrjet e dënimit të të afërmeve të saj, për sa kohë gjykata në fjalë, në pavarësinë e saj ka dhënë dënimet përkatëse, me pjesëmarrjen dhe përfaqësinë e organit të akuzës, administrimit dhe provave dhe fakteve në dosjen gjyqësore.

b/iii) Po ashtu edhe lidhur me konkludimin tjetër të DSIK-së se për shtetasin H. (R.) N. H., disponohen të dhëna në periudha të ndryshme kohore për përshirjen e tij në veprimtarinë e kundërligjshme të trafikut të drogës në bashkëpunim me lidhjet e saj si...,

b/iii.a Subjekti në lidhje me këtë konkludim ka parashtruar se ky i fundit referohet në fjalë të papabazë, joligjore, absurde dhe në kundërshtim me çdo të vërtetë të mundshme. Ajo ka cituar se nëse djali i tezes ka vullnetin të kryejë në vijim veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve, kjo është një çështje që iu përket organeve të ndjekjes penale, të cilët janë tërësisht të lirë të hetojnë dhe gjykojnë këtë njeri, por pretendimi se kryen këtë veprimtari me lidhje me të, kalon çdo kufi ligjor të ushtrimit të detyrës nga institucioni konkludues.

b/iii.b Subjekti ka deklaruar se marrëdhënia familjare e saj me djemtë e tezes është e largët, ata nuk janë familja e saj, por fisni e saj biologjike dhe ka deklaruar gjithashtu se kontaktet me ta kanë qenë tejet të rralla ose krejtësisht rastësore, ose në raste fatkeqësish ndër të afërm (rast vdekje), ku qenia në të njëjtin ambient ka qenë e pashmangshme. Subjekti është shprehur se: “Unë si subjekt rivlerësimi kam arritur të realizoj distancim të plotë pikërisht për këtë shkak. Kontaktet e mia janë të shkuara në kohë dhe deri aktualisht ato janë shmangur tërësisht edhe pse kjo gjë nuk është e lehtë, për shkak të vetë faktit se kemi të afërm të përbashkët, me ngjarje

⁹⁵ Lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 15.6.2010, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

që na prekin në mënyrë të përbashkët. Në kushtet që këta persona (djemtë e tezes) janë lidhje gjaku imja, kontaktet me ta kanë qenë të përshtatshme, pikërisht për shkak të ekzistencës së kësaj lidhjeje dhe nuk mund të përbëjnë shkak për masë disiplinore.

Deklaroj se me shtetasit H. H. dhe F. H. nuk kam pasur kontakte të paktën në tre vitet e fundit dhe më parë kanë qenë tejet të rralla. Nuk kam pasur marrëdhënie afrimiteti me kushërinjtë, për shkak të angazhimit tim familjar, si dhe për shkak të përballjes me ngarkesë të madhe në punë. Unë nuk kam udhëtuar asnjëherë më ta jashtë vendit apo me automjet të përbashkët me ta dhe ky fakt ju ka rezultuar qartë nga hetimi që keni kryer...Kundërshtoj shprehjen e përdorur dashazi në raportin e DSIK-së: ‘anëtarë të familjes së saj janë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar’, pasi familja ime nuk janë djemtë e tezes, por prindërit e mi shembullorë, motrat dhe vëllai im që mbartin edukimin e punës, ndershmerisë dhe njerëzores, bashkëshorti im me të cilin bashkë nuk jemi dorëzuar para asnjë vështirësie e sakrifice, fëmijët e mi të rritur me shumë dashuri për t’u bërë njerëz të mirë dhe virtuoze dhe jo djemtë e tezes. Djemtë e tezes janë lidhje gjaku, fakt që nuk mohohet nga ana ime, unë i kam deklaruar se nuk kam pasur asgjë për të fshehur. Por ata, nuk janë pjesë e jetës sime, nuk kam marrë e dhënë kurrë asgjë me ta, nuk e kam ndërtuar jetën time me asnjë lloj lidhje me zgjedhjen që ata kanë bërë, kam ndërtuar një jetë të ndershme, me lodhje e sakrifica, me dashuri për njerëzit dhe punën dhe kjo gjë duhet vlerësuar fort nga ana juaj. Ju jap të drejtën (është shprehur subjekti) të verifikoni pemën familjare në të dy krahët e prindërve të mi, ku do të gjeni se bashkë me mua, bëhen plot 81 kushërinj të parë, të llojit fëmijë tezes, dajash, xhaxhallarësh dhe hallash (pa kaluar në një shkallë më larg), të cilët janë të shpërndarë në të gjithë botën (Itali, Gjermani dhe SHBA), ku kanë ndërtuar secili jetën e tyre, pa asnjë lloj ndikimi në jetën e secilit nga ne. Mos ngatërroni lidhjet e pashmangshme fisnore me ato familjare. Jua përshkruajta familjen time dhe ka qenë e do të jetë vetëm brenda atyre personave si më lart“.

Trupi gjykues, nga hetimi i thelluar dhe gjithëpërfshirës për çdo dyshim të ngritur, konstaton se nuk u gjenden fakte apo rrethana favorizimi që t’i atribuohen subjektit, të cilat do të mund ta penalizonin atë në vlerësimin e kontrollit të kriterit të figurës. Ky konstatim bazohet mbi mosgjetjen e shkeljeve apo veprimeve të paligjshme të subjektit dhe rrjedh gjithashtu nga disa fakte të provuara: (i) të afërmit në gjini të subjektit janë akuzuar dhe dënuar për veprimtaritë e kundërligjshme të tyre sipas legjislacionit në fuqi; (ii) për veprat e tyre janë shprehur organet e akuzës dhe gjyqësorit; (iii) subjekti e ka deklaruar rregullisht këtë fakt në shtojcën përkatëse të deklaratës për pastërtinë e figurës, në funksion të raportit të DSIK-së (për të cilën arsyetohen në vijim) dhe se nuk u administrua asnjë provë që lidh marrëdhënien e subjektit me veprimtaritë e kundërligjshme të tyre.

Trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia e afërt e gjakut që subjekti ka me personat e përfshirë në krimin e organizuar, është një rrethanë që nuk varet prej saj apo zgjedhjeve të saj. Nga hetimi administrativ nuk u konstatua ndonjë e dhënë që pasqyron komunikime të shpeshta apo të afërta mes subjektit dhe djemtë e tezes së saj, si dhe për më tepër kur nuk u provua ndikimi apo roli i tyre në ushtrimin e detyrës së subjektit.

Trupi gjykues, gjithashtu, mban në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit ka qenë i saktë, i vërtetë dhe i besueshëm në lidhje me deklarimin e të afërmit të saj gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës.

Po ashtu, gjatë procesit të rivlerësimit nuk u administruan prova nga të cilat të rezultojë se ajo mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale.

Trupi gjykues çmon se kur ekzistojnë dy nga kushtet e parashikuara nga germet “b” dhe “c”, të pikës 5, tënenit 38, të ligjit nr. 84/2016, të cilat konsiderohen si rrethana lehtësuese në standardet e përdorura për të vlerësuar kriterin e figurës në procesin e rivlerësimit, subjekti i

rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme në kuptimin e zbatimit të kritereve të përcaktuara prej ligjit në vlerësimin e figurës.

c. Në lidhje me konkludimin e DSIK-së për marrëdhënien e subjektit me gjininë e afërt të saj me shtetasit H. dhe F.H.dhe mosdeklarimin e saktë të tyre në deklaratën në funksion të raportit të DSIK-së lidhur me veprat penale në ngarkim të tyre, trupi gjykues nga verifikimi i deklaratës ka konstatuar se:

- i. subjekti, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016, ka plotësuar sipas shtojcës nr. 3 (pjesë integrale e këtij ligji) deklaratën për kontrollin e figurës;
- ii. në pjesën 5 “të dhëna për sigurinë”, në përgjigje të informacionit të kërkuar në germën “b”, subjekti i ka deklaruar këta shtetas në rubrikën përkatëse, duke përshkruar se ka dijeni që anëtarë të familjes së saj janë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar. Subjekti ka cituar shprehimisht: *“H.N.H., F.N.H., djemtë e tezes së subjektit, në dijeni neni 284/a i Kodit Penal”*.

c/1. Subjekti gjithashtu ka deklaruar me deklaratë të nënshkruar datë 26.1.2017, bashkëngjitur deklaratës së figurës, se të dhënat e paraqitura në të janë të sakta dhe të vërteta dhe se është e vetëdijshme se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

c/2. Në lidhje me konkludimin e DSIK-së, kjo e fundit në raportin e saj është shprehur se sipas kërkesave të nenit 39 të ligjit nr.84/2016, deklarata për kontrollin e figurës nga subjekti i rivlerësimit nuk është plotësuar me saktësi dhe vërtetësi dhe se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht në trafikun e lëndëve narkotike.

c/3 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime në raport me të dhënat e plotësuara në deklaratën përkatëse dhe raportin e DSIK-së, në tërësi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

c/4 Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera ka shpjeguar se ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës sipas gjithë përcaktimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, duke shprehur në deklarim çdo të vërtetë që ka qenë në dijeninë e saj. Ajo është shprehur se mban përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore.

Subjekti ka parashtruar ekzaktësisht se: *“... shtetasit H.N.H. dhe F. N.H.janë djemtë e tezes biologjike dhe ashtu siç unë kam deklaruar pa asnjë lloj indicie për fshehje, ata janë dënuar me vendimin penal nr. ***, datë 26.3.2010, të Gjykatës për Krime të Rënda, siç rezulton nga vetë vendimi për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a-2, 284/a, 278/2/3 të Kodit Penal. Këtë fakt unë e kam deklaruar pranë DSIK-së në formularin përkatës, duke u shprehur konkretisht: ‘H.N.H., F.N.H., djemtë e tezes së subjektit, në dijeni neni 284/a i Kodit Penal’”*.

Në lidhje me konstatimin: “Duket se subjekti nuk ka deklaruar me saktësi veprat penale për të cilat janë dënuar të afërmit e saj (djemtë e tezes)”, ka sqaruar se kjo mospërputhje fare e parëndësishme ndërmjet deklarimit të saj dhe të dhënave të vendimit të dënimit, nuk vjen si rezultat i vullnetit për të deklaruar në mënyrë të pasaktë apo për të fshehur të vërtetën në këtë drejtim, por për faktin se kurrë nuk ka qenë njohur me atë vendim dhe të lexonte të zezën në të bardhë.

Subjekti ka theksuar se deklarimin e ka bërë duke u bazuar në faktin e njohur prej saj për shkak të lidhjeve fisnore se dy kushërinjtë kishin organizuar trafik të lëndëve narkotike bashkë me persona të tjerë në kushtet që të arrestuar në atë kohë ishin disa persona.

Po ashtu subjekti ka deklaruar se vepra penale që ka deklaruar është më e rëndë se dy veprat e tjera të renditura, sipas dispozitës konkrete të Kodit Penal dhe vetëm ky fakt (është shprehur ajo) mjafton për të besuar se nuk ka pasur asnjë qëllim për të fshehur të vërtetën, që nuk ka qenë saktësisht e njohur me vendimin, del qartë edhe nga mënyra e të shprehurit që ka bërë: “në dijeni”, duke mos qenë plotësisht e sigurtë se cilat ishin veprat penale konkrete. Në lidhje me këtë moment ka pasur bindjen se duke deklaruar identitetin e plotë (emër, atësi, mbiemër) të personave të dënuar dhe lidhjen e saj me ta, kishte përmbushur detyrimin e saj për të deklaruar këtë lloj kontakti. Në fakt ajo mendon se ka deklaruar të dhëna të mjaftueshme dhe të plota për ta identifikuar organi ndihmës (DSIK) plotësisht situatën për të cilën bëhej fjalë, siç dhe ka ndodhur. Subjekti ka pretenduar se ka qenë lehtësisht e mundur që të identifikohet rasti i dy kushërinjve të saj në çdo detaj të veprave penale, pozitës, llojit dhe masës së dënimit të tyre.

Subjekti ka argumentuar nenin 38 të ligjit nr.84/2016, titulluar “Standardet e kontrollit të figurës”, pikën 6 të dispozitës, ku janë përcaktuar rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është i plotë dhe i besueshëm, se në asnjë germë të kësaj dispozite, nuk përmendet si rrethanë e tillë mosdeklarimi i të gjitha veprave penale për të cilat është dënuar një rast kontakti i deklaruar, madje askund në dispozitat e kreut V “kontrolli i figurës”, nuk përcaktohet detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar me detaje dispozitat e Kodit Penal. I plotë dhe i mjaftueshëm është fakti që subjekti i rivlerësimit të listojë kontaktin, duke dhënë detaje të plota për identifikimin e tij, siç dhe ka bërë në këtë rast. Po ashtu ka sqaruar se e njëjta deklaratë e plotësuar prej saj ka qenë pjesë e raportit të mëparshëm, ku është konkluduar e përshtatshme për vijimin e detyrës.

Subjekti ka deklaruar⁹⁶ se në momentin e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës edhe pse vendimi i dënimit është i vitit 2010 dhe periudha e deklaramit për efekt të kontrollit të figurës fillon më 1.1.2012, i ka deklaruar dy kushërinjtë e dënuar pa asnjë hezitim, me qëllimin e vetëm për të qenë transparente me organet e rivlerësimit dhe në kushtet që nuk ka pasur asnjë kontakt të papërshtatshëm me këta persona apo lidhje që shkojnë përtej marrëdhënies si kushërinj.

Subjekti parashtron se DSIK-ja në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk rendit dhe nuk arsyeton mbi asnjë nga parashikimet e pikës 6 të nenit 38, megjithëse ka arritur më pas në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr.84/2016. Rrethanat e analizuara nga DSIK-ja nuk plotësojnë standardet e rrethanave që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaramit nuk është plotësuar nga subjekti në mënyrë të plotë dhe të besueshme, të parashikuara nga pikat 6 dhe 7, të nenit 38, të ligjit nr.84/2016.

Nën këto parashtrime dhe argumente subjekti ka kërkuar të vlerësohet “e përshtatshme” për vijimin e detyrës, bazuar në raportin e parë nr. ***, datë 2.11.2017, të DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 29.4.2020, të KDZh-së me konstatimin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

c/5. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar për të cilin është arsyetuar gjerësisht më sipër, bazuar në:

- nenin 34 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se *kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës;*

⁹⁶ Në shpjegimet shtesë për kriterin e figurës dërguar me e-mail datë 14.7.2020.

- pikat 4 dhe 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në kryerjen e verifikimeve të nevojshme në dy drejtime: (a) në konstatimin e ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm; dhe (b) në konstatimin e plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit, në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës për çdo subjekt rivlerësimi;
- konkludimet e raportit të DSIK-së, se subjekti (i) ka dhënë vendime në kundërshtim me ligjin;(ii) ka përfituar në procese gjyqësore nëpërmjet të afërmeve të saj në lidhje gjaku, (iii) ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në gjykimin e të afërmeve të saj apo ka ndikuar në masën e dënimit dhënë ndaj tyre; si dhe (iv) për kontaktet e saj me të afërmit të cilët janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, në tërësi nga arsyetimi i mësipërm i pasqyruar në mënyrë të detajuar, rezultuan të paprovuara;
- faktin se subjekti në lidhje me plotësimin e deklaratës –shtojca 3, në funksion të raportit të DSIK-së, ka deklaruar marrëdhënien me të afërmit e saj, ka identifikuar të dhënat e tyre personale, lidhjen e gjakut, por edhe veprën penale për të cilën në dijeninë e saj janë akuzuar e dënuar, çmuar kjo si rrethanë lehtësuese në zbatim të nenit 39 të ligjit nr.84/2016;
- faktin se në zbatim të pikës 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”*, i cili nuk rezultoi i provuar;
- në përputhje me parimin e objektivitetit çmon se raporti i DSIK-së, për subjektin e rivlerësimit, nuk është mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit për ndikueshmëri në veprime korruptive, lidhje këto që të mund të provonin çdo dyshim të arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës që mund të passillnin cenimin e pastërtisë së figurës apo mund ta bënin subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm në detyrën e saj funksionale.

Trupi gjykues, në analizën ligjore të fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër, çmon se dyshimet e ngritura për veprime korruptive kundrejt subjektit nuk janë të mbështetura në prova dhe, për rrjedhojë, nuk gjen vend zbatimi i dispozitave ligjore për masë penalizuese lidhur me këtë kriter.

Trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi të dhënat e të afërmeve të saj/djemtë e tezes, duke vlerësuar se moscilësimi konkret i veprës penale për të cilën ata janë akuzuar dhe dënuar nuk nënkupton as shmangie nga dispozita konkrete, as fshehje të të dhënës, përse kohë ka deklaruar se ka dijeni që anëtarë të familjes së saj janë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

Trupi gjykues në tërësi arrin në këto përfundime pasi, dyshimet e DSIK-së nuk u mbështetën në prova, madje nga hetimi u provua e kundërta e këtyre dyshimeve, sikurse rezultoi se: (i) subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar të afërmit e saj, djemtë e tezes; (ii) në asnjë rast ajo nuk kishte qenë pjesë e proceseve gjyqësore mbi dyshimet e ngritura; (iii) shpjegimet e subjektit janë ngritur në nivel ligjor; (iv) vendimet penale të dhëna prej saj ndaj disa shtetasve kishin mbetur në fuqi; (v) nuk u evidentua ndonjë *indicie* apo fakt tjetër që mund të mbështeste dyshimet apo të kundërshtonte shpjegimet e subjektit. Në këto kushte, trupi gjykues nuk mund të zëvendësojë logjikën e vendimmarrjeve, sikurse nuk mund t'i hyjë vlerësimit të çështjeve në themel, veprime të cilat janë ndaluar nga neni 72/4 i ligjit nr. 96/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të arrijë në konkluzion për aplikimin e ndonjë mase penalizuese brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr.84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pesëdosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Raportit prezanton gjetjet bazuar në:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- d) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

Në raport janë përshkruar gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit të subjektit, si dhe dokumentet e depozituara prej tij. Po ashtu janë përshkruar detyrat e kryera nga subjekti i rivlerësimit, trajnimet e përfituara, etj. (për më shumë referojuni raportit përkatës). Raporti, ndër të tjera, në analizën e gjetjeve ka konstatuar, si vijon:

➤ Në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit:

Dokumenti nr. 1 –vendimi nr. ***, datë 7.12.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që i përket të pandehurit: (1) R.F., akuzuar për kryerjen e veprës penale “mastrim” në bashkëpunim dhe “pastrimi produkteve të veprës penale” të parashikuar nga nenet 143/2 e 25 dhe 287/1/b/d/2 të Kodit Penal; (2) R.F., akuzuar për kryerjen e veprës penale “mastrim” në bashkëpunim dhe “pastrimi produkteve të veprës penale” të parashikuar nga neni 143/2 e 25 dhe 287/1/b/d/2 të Kodit Penal.

Në këtë çështje gjyqtarja Anita Mici ka qenë gjyqtare kryesuese.

Çështja është regjistruar për gjykim në datën 5.6.2013 dhe vendimi është dhënë në datën 7.12.2015. Gjykimi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm dhe ka zgjatur 2 vjet e 6 muaj e 2 ditë, jashtë afatit standard 9-mujor⁹⁷, të përcaktuar nga germa “a”, e nenit 5, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit⁹⁸. Rrjedhimisht, gjykimi nuk është përfunduar brenda një afati të arsyeshëm duke cenuar parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor sipas nenit 42/2 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës EDNJ (shihni edhe vendimin nr. 12/2012 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 5/2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurve. Vendimi është ankimuar nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 6.7.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

Për dokumentin nr. 2⁹⁹, në raport, ndër të tjera pasqyrohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve duke dhënë edhe dënimet përkatëse, vendim i

⁹⁷ Për të cilin Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasqyruar terivlerësimi profesional.

⁹⁸ Për qëllime të këtij raporti, Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së, “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

⁹⁹ Vendimi nr. ***, datë 4.3.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që i përket të pandehurit I. Sh., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje me pasojë vdekjen” në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 141 e 25 të Kodit Penal, etj. Në këtë çështje gjyqtarja Anita Mici ka qenë gjyqtare kryesuese.

cili është ankimuar nga të pandehurit dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 13.10.2016 ka vendosur lënien në fuqi të tij.

Po ashtu, për dokumentin nr. 3¹⁰⁰, në raport, ndër të tjera pasqyrohet se Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 28.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjetjet nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv

Dosja nr. 1 – çështja penale nr. *** regj.them., datë 26.5.2014 regjistrimi, kundër të pandehurit B.M. të akuzuar për veprën penale “vjedhje në bashkëpunim e mbetur në tentativë”, të parashikuar nga nenet 134/2 e 22 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2014.

Çështja është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës më 26.5.2014, nga prokurori përveftësim të arrestit në flagrancë dhe gjykim të drejtpërdrejtë.

Kundër vendimit është ushtruar ankim nga i pandehuri dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 15.1.2015 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

✓ Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit nuk është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Dosja nr. 2 – çështja penale nr. ***regj.them., datë 26.5.2014 regjistrimi, kundër të pandehurit D. M. të akuzuar për veprën penale “vjedhje në bashkëpunim e mbetur në tentativë”, të parashikuar nga nenet 134/2 e 22 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2014.

Çështja është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës më 26.5.2014 nga prokurori përveftësim të arrestit në flagrancë dhe gjykim të drejtpërdrejtë.Me shortin manual të datës 26.5.2014, çështja i është caktuar gjyqtarës Anita Mici, e cilame vendimin e datës 26.5.2014 ka caktuar seancën gjyqësore për vleftësim arresti në flagrancë dhe gjykim të drejtpërdrejtë në datën 26.5.2014, ora 10:45(brenda ditës duke urdhëruar njoftimin e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit).Palët në këtë rast i njofton prokurori.

Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë më 5.6.2014.

Dosja nr 3 – çështja penale nr. ***regj.them., datë 5.9.2014 regjistrimi, kundër të pandehurës Z.K., të akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga nenet 130/a/4 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr***, datë 22.10.2014.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 5.9.2014. Me shortin manual të datës 5.9.2014, çështja i është caktuar gjyqtarës kryesuese Anita Mici. Me vendimin e datës 8.9.2014 (pas 4 diteve) gjyqtarja ka caktuar seancën gjyqësore në datën 23.9.2014, ora 11:00, duke urdhëruar njoftimin e prokurorit, të pandehurës dhe mbrojtësit të saj. Nxjerrja e vendimit nga gjyqtarja Anita Mici, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10-ditore të përcaktuara në nenin 333 të Kodit tëProcedurës Penale.

Gjykata, për këtë çështje, ka vendosur deklarinimin fajtores të tëpandehurës Z.K. të akuzuar për veprën penale “dhunë në familje”,të parashikuar nga nenet 130/a/4 të Kodit Penal dhe bazuar

¹⁰⁰ Që i përketvendimit nr. ***, datë 15.11.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, që i përket të pandehurit E.H., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje me dashje” në tentativë të parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. 2- A.N. akuzuar për kryerjen e veprës penale “deklarimi rremë para oficerit të policisë gjyqësore” në bashkëpunim të parashikuar nga neni305/b i Kodit Penal. Në këtë çështje gjyqtarja Anita Mici ka qenë gjyqtare relatores e çështjes. Çështja është regjistruar për gjykim në datën 6.7.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 15.11.2016. Gjykimi i çështjes ka zgjatuar 4 muaj e 9 ditë,brenda afatit standard 9-mujor, të përcaktuar nga germa “g”, e nenit 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit¹⁰⁰.

në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe në nenin 59 të Kodit Penal dënimin me 8 muaj burgim me kusht pezullues për 18 muaj në shërbim prove.

✓ Kundër vendimit palët nuk kanë ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë më 3.11.2014.

Dosja nr. 4 – çështja penale nr*** regj.them., datë 25.11.2014 regjistrimi, kundër të pandehurit E.Sh., të akuzuar për veprën penale “ndërtim të paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal dhe “vjedhje energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal(2 herë), e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.3.2015.

Çështja është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrësnë datën 25.11.2014. Me shortin manual të datës 25.11.2014, çështja i është caktuar gjyqtarës Anita Mici, e cila me vendimin e datës 1.12.2014(pas 5 diteve) ka caktuar seancën gjyqësore në datën 15.12.2014, ora 11:30, duke urdhëruar njoftimin e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit. Nxjerrja e vendimit nga gjyqtarja Anita Mici dhe data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10-ditor të përcaktuar nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, për këtë çështje, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit E. Sh., për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm” të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal dhedënimin me burgim 1 vit e 6 muaj. Deklarimin fajtor të të pandehurit E.Sh. për veprën penale “vjedhje energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe dënimin me burgim nga 1 muaj(2 herë) dhe bazuar në nenin 55 të Kodit Penal dënimin me burgim 1 muaj. Bazuar në nenin 55/3 të Kodit Penal, në bashkim të dënimit për të dyja veprat penale, dënimin me 1 vit e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimtar me 1 vit burgim.

✓ Kundër vendimit është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendim nr. *** datë 19.5.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

i. Në këtë çështje, raporti, ndër të tjera, në arsyetim ka sjellë në vëmendje se masa e dënimit e caktuar nga gjykata me 1 vit burgim për të tria veprat penale me anë të procedurës së gjykimit të shkurtuar dhe bashkimit të dënimeve është në kufijtë minimalë që parashikon vetëm dispozita e njëres vepër penale dhe për sa më sipër është shprehur se në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit, ky vendim të merret në konsideratë në vlerësimin e subjektit.

Dosja nr. 5 – çështja penale nr. ***regj.them., datë 22.10.2015 regjistrimi, kundër të pandehurit Sh.M., të akuzuar për veprën penale “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë”, të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.11.2015.

Çështja është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës më 21.10.2015. Me shortin elektronik të datës 22.10.2015, çështja i është caktuar gjyqtarës Anita Mici, e cilame vendimin e datës 26.10.2015 (pas 4 diteve) ka caktuar seancën gjyqësore në datën 9.11.2015, ora 10:30, duke urdhëruar njoftimin e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit. Nxjerrja e vendimit nga gjyqtarja Anita Mici, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10-ditor, të përcaktuar nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale.

Për këtë çështje gjykata ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit Sh.M., të akuzuar për veprën penale “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë”, të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal dhe dënimin me burgim 6 muaj. Bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar me 4 muaj burgim. Bazuar në nenin 63/1 të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i vendimit të dënimit dhe zëvendësohet me 40 orë punë në interes publik brenda 6 muajve.

✓ Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim.

i. Edhe në këtë çështje gjyqësore, raporti, ndër të tjera sjell në vëmendje se masa e dënimit e caktuar nga gjykata me 4 muaj burgim sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar është në kufijtë minimalë që parashikon dispozita për nenin 172 të Kodit Penal ose rreth 5 % e masës së dënimit maksimal. Kjo masë dënimi nuk është në proporcionmesdëmit të shkaktuar të drejtave të palës së dëmtuar dhe synimit që kërkon të arrijë dënimi penal. Gjithashtu, gjykata ka keqinterpretuar nenin 63/1 të Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit dhe zëvendësuar atë me punë në interes publik pasi dispozita kërkon rrezikshmëri të pakët të personit dhe rrethana në favor të tij dhe për sa më sipër është shprehur se në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit, ky vendim të merret në konsideratë për vlerësimin e subjektit.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Gjyqtarja Anita Mici ka njohuri në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Gjyqtarja, në funksion të zgjidhjes së çështjes, zbaton kërkesat e përgjithëshme procedurale penale dhe kur është rasti zbaton procedurën e posaçme penale të gjykimit të drejtpërdrejtë të gjykimit të posaçëm të shkurtuar, identifikon rastet kur për zgjidhjen e drejtë të çështjes kërkohen njohuri të posaçme me ekspertë kompetentë nga fusha të ndryshme të shkencës dhe teknikës, identifikon fushën e zbatimit të normës ligjore përkatëse kur dispozita është e bardhë duke e referuar zgjidhjen e çështjes të ligjet e veçanta apo aktet nënligjore, etj.

Gjyqtarja, në vendimet e hartuara prej saj, ka përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës penale.

b) Arsyetimi ligjor

Gjyqtarja Anita Mici në tri dokumentet ligjore të prezantuara prej saj dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short tregon se ka aftësi në arsyetimin ligjor të vendimeve penale. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara janë të kuptueshme, përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe të ligjit për të treguar lidhjen midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Ajo ka aftësi në interpretimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, si dhe të provave që e shoqërojnë atë, duke identifikuar provat pro dhe kundër faktit penal dhe analizon me detaje elementët e figurës së veprës penale. Gjithashtu, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit analizon me detaje rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe autorit të saj, rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Konstatohet se subjekti ka gjykuar 181 çështje në vit sipas standardit, duke pasur një ngarkesë sasiore mbi standardin minimal.

Sipas pikës 4, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit numri i vendimeve të cenuara nuk duhet të kalojë masën 30 % të vendimeve të ankimuara. Në total, nga 4 vendime të ankimuara janë cenuar 0 vendime ose 0 % e tyre, ose brenda standardit prej 30 % të përcaktuar nga pika 4 e vendimit të KLD-së.

Ndërsa referuar ankesave në këtë aspekt rezulton se nuk ka ankesa për mosrespektim formal të ligjit. Referuar ankesave për periudhën e rivlerësimit në këtë aspekt rezultojnë gjithsej dy

ankesa në Inspektoratin e KLD-së, por 1 prej tyre është evidentuar e dorëzuar jashtë afatit ligjor dhe shënuar gjyqtare për efekte vlerësimit etik profesional.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Anita Mici, referuar kohëzgjatjes mesatare të gjykimeve dhe arsytimit të vendimeve, ngarkesës sasiore dhe cilësisë së vendimmarrjes, rezulton efiçente dhe e aftë për të përballuar ngarkesën në punë në kryerjen e veprimtarisë gjyqsore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqsore

Si konkluzion evidentohet se ndër tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, në asnjë rast çështja e gjykuar prej saj nuk është kthyer për rigjykim për shkelje të procedurave gjyqsore.

C/1. RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisioni, nga verifikimi i dokumenteve mbi të cilët është përgatitur raporti i vlerësimit, ashtu sikurse ka konkluduar edhe KLD-ja (aktualisht KLGJ), ka konstatuar se në tërësi në tri dokumentet ligjore të llojitvendime, 2 prej tyre janë ankimuar dhe janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit (shihni dokumentet nr. 1 dhe 2).

i. Në këto dokumente, Komisioni konstatoi se çështja penale që i përket dokumentit nr.1, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me të pandehur shtetasit R. F. dhe R.F., akuzuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim në bashkëpunim” dhe “pastrimi produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga nenet 143/2 e 25 dhe 287/1/b/d/2 të Kodit Penal, kishte zgjatur përtej afatit 9-mujor të përcaktuar nga germa “a”, e nenit 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit¹⁰¹, si dhe nuk kishte të dhëna nëse ndaj vendimit ishte ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

ii. Në lidhje me këto konstatime subjekti ka parashtruar mbi shkaqet që kanë çuar në shtyrjen e seancave gjyqsore dhe, rrjedhimisht, në zgjatjen e afatit të gjykimit dhe, më tej, ka provuar edhe mbi ushtrimin e rekursit dhe mospranmin e tij. Ndër të tjera, subjekti ka saktësuar se fillimisht çështja pasi është shortuar i ka rënë për gjykim një tjetër gjyqtari, i cili pas kryerjes së dy seancave, ku në një prej tyre ka pasur mungesë të anëtarit të trupës, është larguar për shkak të emërimit të tij në një gjykatë më të lartë. Kjo situatë ka vijuar për rreth tri muaj dhe më pas çështja është rishortuar dhe ka kaluar për shqyrtim te subjekti i rivlerësimit. Subjekti ka sqaruar se ka pasur shtyrje të seancave edhe për shkak të mungesës së mbrojtjes apo prokurorit, për shkak të kohës së nevojshme për përkthim dokumentesh, pasi nga prokurori ishin paraqitur të papërkthyer, etj. Gjithashtu ka qartësuar se është treguar e kujdesshme në afatin e lënë nga njëra seancë gjyqsore në tjetrën. Në vijim, subjekti ka sqaruar përsëri se ka pasur një tjetër emërim të një anëtari të trupës gjyqsore në një gjykatë më të lartë, por edhe i është lënë kohë palëve për t'u njohur me materialet e një padie civile të depozituar në çështjen penale, e cila është konstatuar me të meta dhe që duhej plotësuar. Ka pasur gjithashtu edhe një kërkesë për përjashtim të kryesuesit të trupit gjyqësor, procedurë që merr kohën e nevojshme për shqyrtim. Në tërësi, subjekti ka qartësuar se çështja jo vetëm ka qenë voluminoze, por edhe komplekse. Ajo ka theksuar se vendimi i mësipërm është përzgjedhur nga ana e saj në raport me procesin e rivlerësimit, gjykuar si një nga çështjet gjyqsore penale më komplekse në çdo aspekt të menaxhimit, gjykimit dhe vendimmarrjes së një gjyqtari.

iii. Subjekti ka referuar edhe qëndrimin e GJEDNJ-së, duke theksuar se në morinë e çështjeve të saj, dalin në pah disa faktorë përcaktues të afatit të arsyeshëm kohor të një procesi, ku më thelbësorët janë: (a) kompleksiteti dhe natyra e çështjes (numri i palëve pjesëmarrëse, numri i

¹⁰¹ Për qëllime të këtij raporti, Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***datë 14.4.2010, të KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqsore”.

dëshmitarëve, lidhja e çështjes me çështje të tjera, etj.); (b)numri i palëve pjesëmarrëse; (c)numri i dëshmitarëve; (d)lidhja e çështjes me çështje të tjera; (e)sjellja e ankimuesve dhe e autoriteteve gjyqësore e administrative.

Ndonëse GJEDNJ-ja nuk përcakton limite kohore specifike dhe merr në konsideratë rrethanat e çdo çështjeje për të vlerësuar vonesat, një studim i vitit 2006 i kryer nga KKGJE-ja (Këshilli Konsultativ i Gjykatës Evropiane), ka treguar se një kohëzgjatje deri në 2 vjet e një çështjeje jo komplekse, zakonisht konsiderohet nga gjykata si e arsyeshme. Përsa i përket çështjeve komplekse, studimi i përmendur më sipër vuri në dukje se për çështjet që kishin zgjatur më shumë se 8 vjet kishte shkelje, ndërkohë që çështjet që kanë zgjatur më shumë se 5 vjet rrallë kanë marrë miratimin e gjykatës.

iv. Në lidhje me ecurinë e çështjes ka informuar se vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, duke mos u konstatuar asnjë shkelje procedurale me gjithë komplekstetit e gjerë si çështje.

v. Subjekti ka sqaruar se çështja ka përfunduar së shqyrtuari edhe në Gjykatën e Lartë dhe me vendimin nr. ***, datë 16.3.2017 është vendosur mospranimi i ankimit.

vi. Ajo ka depozituar procesverbale të seancave gjyqësore, si dhe vendimin gjyqësor datë 7.12.2015 bashkë me shënimet e lënies në fuqi të tij në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

vii. Trupi gjykues, nga verifikimi i procesverbaleve, ka konstatuar se të gjitha të dhënat e prezantuara nga subjekti, lidhur me shkaqet e shtyrjes së seancave, janë pasqyruar në seancat gjyqësore të njëpasnjëshme dhe se nuk rezultoi që në ndonjë rast, shtyrja të ketë pasur si shkak zvarritjen në kundërshtim me ligjin. Analiza e bërë nga subjekti është bindëse për trupin gjykues dhe njëkohësisht në përputhje me të gjitha veprimet e ndërmarra ligjërisht prej saj në çdo seancë gjyqësore, reflektuar në procesverbalet përkatëse. Gjithashtu, nga vendimi gjyqësor nr. ***, datë 16.3.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë konfirmohet edhe lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke mos u pranuar rekursi i ushtruar nga organi i Prokurorisë së Apelit Durrës.

Ndërsa në pesë dosjet gjyqësore është vërejtur se janë ankimuar brenda afatit 2 prej tyre, vendimi është lënë në fuqi nga gjykata e apelit dhe se nuk është ushtruar rekurs në gjykatën e lartë (shihni dosjet nr. 1 dhe 4).

- Lidhur me çështjet gjyqësore 4 dhe 5, pjesë e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, sikurse KLGJ-ja ka sjellë në vëmendje në raportin e saj se:

a) Në rastin që i përket çështjes gjyqësore nr. 4 dukej se i pandehuri kishte vepruar me dashje direkte për të dyja veprat penale, megjithëse ka qenë i ndëshkuar më parë me masë administrative ...; Masa e dënimit e caktuar nga gjykata me 1 vit burgim për të tria veprat penale me anë të procedurës së gjykimit të shkurtuar dhe bashkimit të dënimeve është në kufijtë minimalë që parashikon vetëm dispozita e njërës vepër penale.

b) Në rastin që i përket çështjes gjyqësore nr.5, dukej se gjykata kishte keqinterpretuar nenin 63/1 të Kodit Penal duke pezulluar ekzekutimin e vendimit dhe zëvendësuar atë me punë në interes publik, pasi dispozita kërkon rrezikshmëri të pakët të personit dhe rrethana në favor të tij, përkundrazi vepra penale, si dhe autori i saj duket se ka paraqitur rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

i. Nën këto vlerësime paraprahe, dukej se në çështjen që i përket dosjes nr.4, masa e dënimit të caktuar ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i Kodit Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës;

ii. Ndërsa, në çështjen që i përket dosjes nr.5 dukej se subjekti nuk kishte analizuar përmbushjen e kriterit të nenit 63/1 të Kodit Penal për të vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit dhe zëvendësimin me punë në interes publik.

- Komisioni pa dashur të zëvendësojë logjikën e arsytimit, por për të qartësuar këto momente, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në referencë të dispozitave të Kodit Penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në shpjegimet e saj, ndër të tjera, në lidhje me vlerësimin e dosjes nr. 4, që i takon vendimit penal datë 30.3.2015 me të dënuarin E.Sh., ka shpjeguar se me cilësinë e gjyqtarit të çështjes ka caktuar një dënim proporcional dhe në respektim të përcaktimeve të nenit 55/3 të Kodit Penal, duke caktuar për të pandehurin dënimin më të rëndë të shtuar. Ajo ka sqaruar se dënimi penal nuk mund të jetë mbledhje matematike e dënimeve të caktuara veç e veç për çdo vepër penale, pasi kjo vjen ndesh me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konsideruar në shkelje të parimeve kushtetuese caktimin e dënimit bazuar në mbledhje matematike të dënimeve të veçanta.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, është shprehur subjekti, daton në kohë pas vendimmarrjes së saj si më sipër, duke konfirmuar qëndrimin dhe bindjen juridike se mbledhja matematike e dënimeve nuk ishte një mënyrë e përshtatshme e zbatimit të ligjit në caktimin e dënimit, pasi vjen ndesh me parimet e përgjithshme të Kodit Penal, me vetë përmbajtjen logjike të nenit 1/c të këtij Kodi. Përveç kësaj, në rastin konkret, ndryshe nga sa pretendohet, veprat penale dhe autori nuk paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Ky i pandehur do të mund të konsiderohej përsëritës në kryerjen e veprës penale (fakt që rrit rrezikshmërinë shoqërore të tij), vetëm në rast se më parë kishte kryer një tjetër vepër penale për të cilën të ishte deklaruar fajtor dhe dënuar dhe jo kur ai më parë ka konsumuar një shkelje me natyrë administrative. Përsëritës në kuptim të ligjit penal, subjektin e bën vetëm dënimi penal i mëparshëm dhe jo dënimi administrativ.

Nga ana tjetër, të dyja veprat penale në këtë rast janë kryer nga një i pandehur në një moshë të madhe dhe këtu në zbatim të nenit 49 të Kodit Penal është vlerësuar mosha e tij, sikurse edhe gjendja shëndetësore që ka paraqitur që në fazën e hetimit, që kanë qenë shkak që i pandehuri të hetohet e gjykohet me masë sigurimi “arrest në shtëpi”. Pra, kanë qenë këta faktorë të lidhur individualisht me këtë të pandehur, që sikurse më parë kanë çuar në përzgjedhjen e një mase sigurimi me të butë (nga tjetër trup gjykues), janë vlerësuar dhe prej saj në drejtim të një dënimi me burgim jo shumë të lartë, duke iu afruar minimumit të parashikuar nga ligji. Njëra nga veprat penale në këtë rast, ajo e parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, parashikon si lloj dënimi edhe atë me gjobë, e cila nuk është përzgjedhur prej saj në këtë rast, pikërisht duke vlerësuar se dënimi duhet të ishte më i ashpër, në ruajtje të proporcionalitetit të tij, në raport me kriteret e nenit 47 të Kodit Penal dhe rrethanave faktike të rastit objekt gjykimi.

I pandehuri E.Sh. gjatë hetimit dhe gjykimit ka qenë me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale për shkak të gjendjes shëndetësore të tij, sipas vendimit nr. ***Akti, datë 27.6.2014, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin datë 31.7.2014. Të dyja gjykatat që kanë shqyrtuar kërkesën me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit për këtë të pandehur, kanë konkluduar në një masë më të butë, mbështetur në provat e shqyrtuara dhe konkretisht: (1) epikrizë mjekësore të datës 21.6.2014, lëshuar nga mjeku i Spitalit Rajonal Durrës (klinika e kardiologjisë) S. Xh., mjek kurues dhe E.Z.; (2) epikrizë e mjekut neurolog E.Sh. i datës 23.6.2014, pranë Spitalit Rajonal Durrës.

Të dyja gjykatat kanë konkluduar se për shkak të gjendjes shëndetësore të këtij të pandehuri të hospitalizuar, në vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, i shkaktohen probleme të rënda me shëndetin. Subjekti ka cituar se ky fakt është marrë në konsideratë dhe vlerësuar nga ana e

saj në gjykimin e akuzës në themel, në drejtim të caktimit të një mase dënimi afër minimumit të parashikuar nga ligji, pa cenuar asnjë dispozitë ligjore të aplikueshme.

Ndërsa në lidhje me konstatimet e bëra për dosjen nr.5 që i takon vendimit penal datë 26.11.2015 me të dënuar shtetasin Sh.M., subjekti ka shpjeguar se pasi ka marrë një kopje të njësuar të vendimit, të cilin edhe e ka depozituar si provë në raport me sa kërkohet, ndër të tjera ka sqaruar se: *“... nga vetë përmbajtja e këtij vendimi, rezulton se unë si subjekt rivlerësimi me cilësinë e gjyqtarit të çështjes, në rastin konkret kam caktuar të njëjtin lloj mase dhe alternative të vuajtjes së dënimit të kërkuar nga përfaqësuesi i akuzës”*.

Subjekti ka shprehur bindjen se ka zbatuar drejt kërkesat e nenit 63 të Kodit Penal, pasi nga tërësia e rrethanave objektive të çështjes dhe dënimit të caktuar për subjektin të pandehur, plotësohen të gjitha kërkesat e ligjit në nenin 63 të Kodit Penal, arsyetuar edhe në vendimin gjyqësor. Subjekti ka qartësuar se në këtë rast i pandehuri ka paraqitur rrezikshmëri mjaft të ulët shoqërore dhe ka qenë i padënuar më parë dhe masa e kontrabandës me mallra akcize, siç rezulton dhe nga pjesa e vendimit që shprehet në lidhje me provën materiale ka qenë tejet e ulët. Bëhet fjalë vetëm për 20 steka cigare, të cilat gjykata i ka konfiskuar dhe kaluar në favor të shtetit, ku kjo vlerë, jo vetëm tejkalon disa herë masën e detyrimit doganor të shmangur, por është vlerësuar nga ana e saj dhe si një ndëshkim me karakter financiar për të pandehurin, që i bashkohet dhe dënimit penal të dhënë. Pra, dënimi penal i caktuar në këtë rast është shoqëruar edhe me dënim plotësues, apo masë ndëshkuese financiare, që bashkëçojnë në një përcaktim mjaft të drejtë të dënimit në përputhje me kriteret e nenit 47 të Kodit Penal dhe që arrin plotësisht qëllimin e posaçëm të dënimit penal në drejtim të autorit të veprës penale.

Subjekti parashtron se qëllimi i dënimit kryesisht duhet të jetë rehabilitues e riintegruar në drejtim të autorit të veprës penale, parandalues për pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, që është dhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit penal dhe jo ndëshkues, hakmarrës.

Neni 1/c i Kodit Penal përcakton detyrimin e gjykatës për të dhënë drejtësi në caktimin e dënimit, duke e dhënë atë mbi baza humanizmi.

Subjekti është shprehur se gjyqtari në ushtrimin e detyrës, dhënien e vendimeve dhe në rastin e drejtësisë penale përfshi dhe caktimin e dënimit, duhet të jetë profesionist, kurajoz dhe njerëzor, kërkesa për të cilat citon se gjatë gjithë kohës së saj në detyrë është përpjekur t'i përmbushë me nivel të lartë përgjegjësie. Subjekti ka depozituar: vendimin datë 26.11.2015 dhe procesverbale të seancave gjyqësore; vendimin nr. ***Akti, datë 27.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendimin datë 31.7.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin me të pandehur K. R. etj.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të konstatimeve paraprake, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti në prapësimet e saj, për të dyja dokumentet, vlerëson faktin se subjekti ka parashtruar një analizë ligjore të rasteve duke u përqendruar në rrethana konkrete objektive ligjore që ka pasur çdo rast si pjesë e zgjidhjes së çështjes në themel, ku caktimi i dënimit për çdo të pandehur nga ana e saj kishte qenë rrjedhojë çmuarjes së fakteve të rezultuara në gjykim nëpërmjet provave dhe bindjes së brendshme të gjyqtarit. Pra, në tërësi, trupi gjykues vlerëson se bazuar në parimet e përgjithshme të procesit penal dhe gjykimin, caktimi i llojit dhe masës së dënimit si pjesë integrale e një vendimi fajësie bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e dispozitave ligjore të aplikueshme të përgjithshme, por edhe brenda kufijve të dispozitës së posaçme penale, duke qenë njëkohësisht edhe pjesë e zgjidhjes së çështjes në themel të saj.

Trupi gjykues, në analizë edhe të procedurës gjyqësore të ndjekur, çmuarjes së provave dhe fakteve gjatë gjykimit të çështjes, vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit se krahas këtyre faktorëve të cilët është bazuar, në shërbim të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm¹⁰² merr vlerë edhe bindja e brendshme e gjyqtarit, e krijuar mbi prova të vlerësuara dhe sigurisht brenda kufijvetë lejueshëm nga ligji.

Po ashtu, duke iu referuar dispozitave penale mbi të cilat janë kërkuar dënimet përkatëse, ka rezultuar se në asnjërën prej çështjeve nuk janë dhënë dënime nën minimumin e parashikuar nga ligji dhe njëkohësisht vendimmarrjet kanë qenë në një linjë me kërkimin e organit të akuzës.

Trupi gjykues, nisur edhe nga fakti se vendimet e dhëna kanë mbetur në fuqi dhe se për to nuk janë konkluduar zvarritje të qëllimshme të procesit, çka do të pasqyronin anën procedurale të procesit gjyqësor apo probleme të tjera të natyrës procedurale, në tërësi nën argumentet e lartpërmendur, krijon bindjen se pretendimet e subjektit faktohen dhe në këtë këndvështrim nuk konstatohen problematika që tëndikojnë në vlerësimin profesional të saj.

Në vijim të rivlerësimit profesional të subjektit

Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të administruara si pjesë e raportit, ka konstatuar se vendimet e arsyetura prej subjektit, ruajnë të njëjën strukturë dhe tregojnë një nivel të mirë arësytimi duke plotësuar kriteret e një procesi të rregullt ligjor. Vendimet janë të një formati standard sipas një metodologjie të caktuar. Në vendimet përfundimtare, gjyqtarja pasqyron dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës lidhur me kërkimet e palëve për gjykimin e drejtpërdrejtë dhe të shkurtuar. Në tërësi vendimet e subjektit kanë mbetur në fuqi.

Në lidhje me etikën në punë, integritetin dhe paanësinë, trupi gjykues ka vërejtur se në përgjithësi për subjektin e rivlerësimit nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, nuk është evidentuar asnjë rast i konfliktit të interesit të gjyqtarës, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarës që lidhen me respektimin e rregullave procedurale dhe me standardin e gjykatës së paanshme.

Po ashtu, në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimin profesional është konstatuar se subjekti komunikon me etikë me pjesëmarrësit në proces dhe jashtë tij dhe se gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore.

Gjithashtu është konstatuar se sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarën Anita Mici, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

III/2. Komisioni, verifikoi edhe çështjen e diskutuar dhe bërë publike që i përket vendimit, për lirim para kohe me kusht, të dënuarit L. B., me 25 vjet burgim, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtarës. Komisioni ka kërkuar dosjen¹⁰³ përkatëse me qëllim vlerësimin e subjektit në kontrollin e këtij kriteri edhe për sa i takon veprimtarisë së saj të zhvilluar përgjatë trajtimit të kësaj çështjeje. Pas kërkesës së Komisionit, Gjykata e Lartë¹⁰⁴ ka vënë në dispozicion dosjen përkatëse.

¹⁰² Shihni rekomandimin e Komitetit të Ministrave të KE-së (2010)12, ku theksohet se në marrjen e vendimit gjyqtari duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe i aftë për të marrë vendime pa asnjë ndikim, presion, kërcënim apo ndërhyrje, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga çdo autoritet, duke përfshirë edhe autoritetet e brendshme të gjyqësorit.

¹⁰³ Me shkresën nr. ***prot., datë 20.1.2020.

¹⁰⁴ Me shkresën nr. ***, datë 31.1.2020.

i. Nga aktet e dosjes rezultoi se i pandehuri është dënuar nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 16.7.2014, me 25 vjet burgim, për kryerje të veprave penale 78/1 -25, 76-22 dhe 278/2 të Kodit Penal.

ii. Në shkresën nr. ***prot., datë 4.2.2015, percjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, citohet shprehimisht se i gjykuari është arrestuar në datën 6.4.2006 dhe se pas datës së dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë i mbetën për të vuajtur edhe 4.969 ditë burgim.

iii. Me vendimin nr. ***, datë 19.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të dënuarit i janë ulur 90 ditë.

iv. Me vendimin nr. ***, datë 11.9.2015, po të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të dënuarit i është ulur dënimi me 675 ditë, nga data 6.4.2006 deri në datën 7.4.2015.

v. Pas disa kërkesave për ulje dënimi dhe pas kërkesës së të dënuarit për lirim para kohe me kusht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. ***, datë 28.7.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së të dënuarit L. B., nën arsyetimin se i dënuari nuk ka plotësuar kushtin e parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, pasi nuk kishte vuajtur $\frac{3}{4}$ e dënimit të dhënë.

Prokurori, në diskutimet e tij përfundimtare në shkallë të parë, sipas arsyetimittë vendimit, ka kërkuar që kërkesa të mos pranohet pasi i dënuari nuk ka plotësuar kushtin e kërkuar nga neni 64 i Kodit Penal, nuk ka vuajtur $\frac{3}{4}$ e dënimit të dhënë me vendim të Gjykatës së Lartë.

vi. Arsyetimi i të dënuarit nëpërmjet përfaqësuesit të tij për të kundërshtuar vendimin e shkallës së parë, fokusohet në faktin se kërkuesi vijon të quhet i pandehur deri në momentin që Gjykata e Lartë ka prishur dy vendimet e mëparshme dhe, për pasojë, ka rënë forma e prerë e vendimit të dënimit penal të themelit të çështjes në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

vii. Mbi ankimin e të dënuarit, Gjykata e Apelit (ku subjekti i rivlerësimit ka cilësinë e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues) me vendimin e saj nr. ***, datë 5.12.2016, ka vendosur lirimim para kohe me kusht me arsyetimin se i dënuari ka vuajtur $\frac{3}{4}$ e dënimit duke iu referuar dinamikës së vuajtjes së dënimit datë 2.12.2016, ku pasqyrohet se i dënuari ka vuajtur 18 vjet e 9 muaj e 22 ditë dhe, gjithashtu, ka arsyetuar edhe mbi raportet e sjelljes së të dënuarit në institucionin e vuajtjes së dënimit të depozituara nga ky i fundit.

viii. Prokurori ka ushtruar rekurs duke parashtruar disa shkaqe ligjore për të prishur vendimin e Gjykatës së Apelit, ku ndër të tjera ka cituar se kjo e fundit: (a) ka përllogaritur dhe pranuar $\frac{3}{4}$ e vuajtjes së dënimit ditën e gjykimit në Apel; (b) nuk ka marrë në konsideratë rrezikshmërinë e lartë të të dënuarit, për shkak të veprave për të cilat është dënuar; (c) ka përfshirë në cilësinë e rrethanave dhe provave të reja edhe uljen e dënimit të dhënë me 45 ditë, në datën 1.12.2016, ndërsa vendimi i apelit daton 5.12.2016; (d) në datën 31.10.2016 ka shtyrë seancën për administrim të tri vendimeve të themelit, për më shumë se 10 ditë sipas parashikimit të bërë në nenin 427/5 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht seanca është zhvilluar në datën 5.12.2016, veprim i cili ka mundësuar edhe depozitimim e vendimit të lartpërmendur të uljes së dënimit me 45 ditë.

ix. Ka administruar dinamikën e vuajtjes së dënimit, e cila është përdorur për uljen e dënimit me 45 ditë, si dhe ka administruar vendimin e kësaj ulje dënimi, kur këto dy akte nuk mund të konsiderohen sipas pikës 2, të nenit 427, të Kodit të Procedurës Penale, prova të zbuluara pas daljes së vendimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty. Në këtë logjikë (është shprehur organi i akuzës), në këtë moment i lindte e drejta të dënuarit për të kërkuar lirimim para kohe me kusht, ndërsa kjo gjykatë po shqyrtonte një vendim të shkallës së parë.

x. Mbi informacionin e dhënë nga Gjykata e Lartë konfirmohet se dosja aktualisht ndodhet për gjykim në këtë gjykatë.

xi. Mbi këto fakte, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në shpjegimet e saj, ka cituar shprehimisht: "... në respekt të ligjit dhe kontrollit vertikal të zbatimit të tij, në gjykimin e çështjeve gjyqësore, vlerësoj se dhënia përgjigje e pretendimeve rekursuese të mësipërme është atribut ligjor vetëm i Gjykatës së Lartë, në të cilën kjo çështje ndodhet në pritje të gjykimin, siç dhe keni verifikuar.

Nga ana tjetër, me vullnetin e qartë për të qenë bashkëpunuese në dhënien e çdo shpjegimi të kërkuar sqarohet se:

Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit ka përllogaritur dhe pranuar $\frac{3}{4}$ e vuajtjes së dënimit ditën e gjykimin në Apel, vlerësoj se kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin pasi, në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, i dënuari duhet të ketë plotësuar $\frac{3}{4}$ e vuajtjes së dënimit për t'u liruar me kusht, në kohën kur atij i jepet kjo liri nga gjykata. Në kushtet që edhe Gjykata e Apelit është një gjykatë fakti dhe jo vetëm ligji, vlerësoj se nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që të gjendej i plotësuar kushti i vuajtjes së $\frac{3}{4}$ të dënimit në kohën e gjykimin në apel.

Në lidhje me pretendimin se nuk është marrë në konsideratë rrezikshmëria e lartë e të dënuarit, për shkak të veprave për të cilat është dënuar, vlerësoj se një element i tillë nuk është pjesë e kritereve ligjore kumulative parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, pasi për çdo rast, rrezikshmëria e lartë e veprave penale që ka kryer një i dënuar është reflektuar në caktimin e dënimit ndaj tij, nëpërmjet vendimit të dënimit, ku në zbatim të kërkesave të nenit 47 të Kodit Penal, gjykata që ka shqyrtuar çështjen e fajësisë dhe caktimit të dënimit në themel, ka reflektuar rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale në masën e dënimit të dhënë. Në këtë rast, sipas vendimit të dënimit të dhënë nga Gjykata e Lartë në zbatim të ligjit material penal të kohës kur kanë ndodhur veprat penale, ky i dënuar ka marrë maksimumin e dënimit me burgim që kanë parashikuar dispozitat e përgjithshme dhe ato të posaçme të Kodit Penal. Në këtë rast ka qenë Gjykata e Lartë që ka përjashtuar mundësinë e dhënies së dënimit me burgim të përjetshëm, si një dënim që sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk parashikohej nga ligji penal i kohës së kryerjes së veprave penale (shihni vendimin e Gjykatës së Lartë). Vlerësoj se nëse lirimi me kusht për një të dënuar do të mohohej për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprave penale të kryera, do të kishim penalizim të dyfishtë të tij për të njëjtin shkak, pasi po për shkak të rrezikshmërisë së veprave penale, i dënuari do të merrte një dënim të ashpër dhe po për këtë shkak, do të humbiste mundësinë e lirimin me kusht, institut që lidhet me rehabilitimin e një të dënuari, riintegrimin e tij në shoqëri dhe jo me përcaktimin e dënimit, si rrjedhojë e rrezikshmërisë shoqërore të krimin të kryer. Vlerësoj se Instituti i lirimin me kusht klasifikohet në Kodin Penal si një nga alternativat e dënimit me burgim (kreu VII i Kodit Penal), i cili është një institut me karakter riedukues, human, dhe social. Karakteri 'human' i lirimin me kusht lidhet me shmangien e ndëshkimit të panevojshëm apo dhe të dyfishtë në këtë rast dhe është pasqyrim i drejtëpërdrejtë i një prej parimeve të Kodit Penal, parashikuar shprehimisht në nenin 1/c të tij. Vetë elementi ndëshkues në teorinë e së drejtës penale (siç kam theksuar dhe më sipër) nuk duhet të konsiderohet si një 'hakmarrje' e shoqërisë kundrejt autorit të veprës penale, por më tepër si një shprehje e shpagimit të kësaj të fundit në lidhje me sjellje të patolerueshme për një shoqëri civile dhe demokratike. Për më tepër, edhe vetë masa e dënimit penal është në vetvete një 'parashikim' nga ana e gjykatës e kohës që konsiderohet e mjaftueshme për të arritur në riedukimin e të dënuarit, në raport kjo me rrezikshmërinë e veprës së kryer dhe të autorit të saj. Trupi gjyqësor në të cilin kam qenë anëtare në këtë rast, ka mbajtur në konsideratë natyrën e veprës penale të kryer nga i dënuari L. B., duke e vlerësuar si një nga elementët më të rëndësishëm që duhet të merrret parasysh nga ana e gjykatës në shqyrtimin e kërkesës për lirim me kusht. Sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të

dënuarit. Pikerisht duke pasur në vëmendje rrezikshmërinë e lartë shoqërore të veprave penale të kryera nga kërkuesi, trupi gjykues në këtë rast ka bërë një analizë të hollësishme të çdo të dhënë në lidhje me riedukimin e tij, sjelljen e vazhdueshme në institucion, angazhimin e të dënuarit në programet rehabilituese, të cilat në këtë rast kanë qenë në nivele shume të mira (gjejnë pasqyrim në vendimin konkret dhe aktet e përcjella nga institucionet ndihmëse të procesit gjyqësor me objekt lirimin me kusht).

Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit ka përfshirë në cilësinë e rrethanave dhe provave të reja edhe uljen e dënimit të dhënë me 45 ditë, në datën 1.12.2016, ndërsa vendimi i Apelit daton 5.12.2016, sqaroj se një gjë e tillë jo vetëm që nuk vjen ndesh me ligjin, por është pjesë e hetimit të thelluar që ka bërë në vijimësi trupi gjykues, me qëllim krijimin e bindjes se ky i dënuar paraqet nivel të kënaqshëm rehabilitimi dhe paraqet mundësi reale për t'u riintegruar në shoqëri nëpërmjet lirit me kusht. Kjo pasi, ulja e dënimit si më sipër, nuk është gjë tjetër veçse përfitim në masën e dënimit të vuajtur, si sintezë e gjithë sjelljes së të dënuarit në institucionin e vuajtjes së dënimit. Ulja e dënimit është tregues rehabilitimi për një të dënuar dhe ky është misioni i gjykatës në gjykimin për lirimin me kusht, të evidentojë sa më afër reales, situatën e rehabilitimit të të dënuarit.

Ky vendim paraqet fuqi të plotë ligjore për sa gjykata ka pranuar kërkesën e të dënuarit pasi, në kushtet që procesi i uljes së dënimit ka vetëm një palë procedurale, kërkuesin (të dënuarin) dhe kërkimi i tij është pranuar, vendimi është i paankimueshëm, thënë ndryshe me ekzekutim të menjëhershëm, pasi i njeh të dënuarit të drejta që lidhen me lirinë personale të tij. Në nenin 462, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: 'Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes'. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, vendimi që ul dënimin për një të gjykuar në bazë të nenit 63 të ligjit të posaçëm nr. 8328, datë 16.4.1998, 'Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim', i ndryshuar me ligjin nr. 9888, datë 10.3.2008, 'Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve', është përjashtim i pjesshëm i të gjykuarit nga dënimi, në masën e ulur nga gjykata dhe, për rrjedhojë, është vendim që vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes, duke u reflektuar në dinamikën e vuajtjes së dënimit. Eventualisht mund të ndodhë që masa e dënimit e ulur nga gjykata të jetë e barabartë me masën e dënimit të mbetur pa vuajtur për një të dënuar dhe në këto raste, pikërisht për shkak të ekzekutimit të menjëhershëm, gjykata urdhëron lirimin e të dënuarit. Këto lloj vendimesh ndikojnë drejtpërdrejtë në lirinë personale, e për këtë shkak ligji procedural penal i ka paraparë te vendimet që ekzekutohen menjëherë pas shpalljes.

Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit në datën 31.10.2016 ka shtyrë seancën për administrim të tri vendimeve të themelit, për më shumë se 10 ditë sipas parashikimit të bërë në nenin 427/5 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht seanca është zhvilluar në datën 5.12.2016, veprim i cili ka mundësuar edhe depozitimin e vendimit të lartpërmendur i uljes së dënimit me 45 ditë, sqaroj se, prokurori ka kuptuar gabim përcaktimin e nenit 427, pika 5, e Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo dispozitë me të gjithë përcaktimet e saj i referohet një gjykimi themeli në çështjet penale dhe bën fjalë për marrjen e provave të reja në një gjykim themeli, ku pozita e subjektit është 'i pandehur'. Në kushtet e nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale jemi në zhvillim e sipër të një procesi gjyqësor me të pandehur që garantohet nga parimi i prezumimit të pafajësisë dhe detyrimi i gjykatës për përfundimin e gjyimit në afate të arsyeshme, ndërsa çështja e lirit me kusht është kërkesë e të dënuarit në fazën e ekzekutimit të një vendimi penal dënimi me burgim, ku statusi i kërkuesit që ka investuar gjykatën me pretendimin e tij, nuk është i tillë që detyron gjykatën në këtë afat për marrjen e akteve. Në këtë rast, aktet e marra nuk janë prova fajësie në kuptimin procedural të provës, por janë akte zyrtare (në këtë rast vendime gjyqësore) që nevojiten për të verifikuar ekzistencën e kushteve

ligjore në kërkesën e të dënuarit që ka investuar gjykatën dhe nuk kanë asnjë lidhje detyruese me afatin 10-ditor.

Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit ka administruar dinamikën e vuajtjes së dënimit, e cila është përdorur për uljen e dënimit me 45 ditë, si dhe ka administruar vendimin e kësaj uljeje dënimi. Këto dy akte nuk mund të konsiderohen sipas pikës 2, të nenit 427, të Kodit të Procedurës Penale, prova të zbuluara pas daljes së vendimit të shkallës së parë, ose të atyre që dalin aty për aty. Në këtë logjikë, në këtë moment i lindte e drejta të dënuarit për të kërkuar lirimin para kohe me kusht, ndërsa kjo gjykatë po shqyrtonte një vendim të shkallës së parë, sqaroj se ky pretendim e merr pjesërisht përgjigjen më sipër pasi nuk kemi të bëjmë me prova të reja fajësie në një gjykim akuze të ngritur ndaj një të pandehuri, por me akte me tregues rehabilitimit të dënuarit në një proces dinamik, siç e vlerësoj unë si gjyqtare procesin e lirimimit me kusht. Do të ishte e njëjta gjë nëse çështja do të kishte ardhur në Gjykatën e Apelit mbi ankimin e prokurorit dhe gjatë kohës nga dhënia e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e deri në vendimmarrjen e apelit i dënuari të kryente vepër tjetër penale, edhe në këtë rast aktet që vërtetojnë kryerjen e veprës penale do të duhet të vlerësoheshin kundër vijimit të lirimimit me kusht, pasi procesi i lirimimit me kusht është proces dinamik, që synon të evidentojë aftësitë riintegruese të të dënuarit, sjelljen e tij, aftësinë për t'u përfshirë në shoqëri pa problematikë me natyrë penale. Jo më kot ligji penal ka parashikuar edhe mundësinë e revokimit të lirimimit me kusht, nëse i dënuari i liruar kryen vepër tjetër penale, apo shkel detyrimet e përcaktuara nga gjykata. Vlerësoj se prokurori, nëpërmjet këtyre pretendimeve, nuk e bën qartë dallimin ndërmjet një gjykimi themeli dhe këtij gjykimi të veçantë në fazën e ekzekutimit të dënimit. Çdo e dhënë pro apo kundër lirimimit me kusht, duhet vlerësuar nga të dyja gjykatat e faktit jo vetëm gjatë zhvillimit të gjyqimit, por edhe gjatë ekzekutimit të vendimit që jep lirimin me kusht. Në rastin konkret, në çmuarje të të dhënave shkresore të ardhura nga institucionet ndihmëse të këtij procesi si IEVP Durrës dhe Zyra e Shërbimit të Provës, trupi gjyqësor ka konkluduar se jemi para rastit të një të dënuari që, pavarësisht rrezikshmërisë së veprave penale për të cilat ka qenë dënuar, provonte nivel të lartë rehabilitimi me kohë qëndrimin në burgim. Nga aktet i dënuari L. B. prezantohet një i dënuar shembullor, model i reflektimit të thellë nga vuajtja e dënimit, shpërblyer me leje, gjithë kohës i punësuar në institucion, fakt për të cilin kishte përfituar edhe zbritje të dënimit sipas përcaktimeve ligjore.

Në lidhje me këtë të dënuar, në kuadër të asaj që e vlerësoj procesin e lirimimit me kusht një proces dinamik që nga fillimi shqyrtimit të kërkesës e deri në ekzekutimin plotësisht të detyrimeve ligjore gjatë gjithë kohës së kushtit, rezulton se ky i dënuar gjatë ekzekutimit të vendimit të gjykatës, përgjatë gjithë kohës së kushtit, nga ku kanë kaluar rreth 3 vjet e 8 muaj nga lirimi i tij, nuk ka asnjë sjellje me natyrë penale, që automatikisht do të çonte gjykatën në revokimin e vendimit të lirimimit me kusht, provuar me gjendjen e ekzekutimit të vendimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës“.

Subjekti ka kërkuar që qëndrimi i saj si subjekt rivlerësimi në cilësinë e anëtarit të trupit gjyqësor në këtë vendimmarrje të mos ndikojë në vlerësimin e kriterit profesional, pasi vendimi është dhënë bazuar në provat e shqyrtuara, në zbatim të kriterëve ligjore të gjetura kumulativisht të plotësuar dhe në bindjen e brendshme të gjyqtarit, krijuar në mënyrë të pavarur bazuar vetëm në prova dhe në ligj.

Subjekti¹⁰⁵ ka depozituar edhe një kthim-përgjigje të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në funksion të dy dokumenteve shoqëruese të saj, lidhur me procesin e ekzekutimit të vendimit ndaj këtij të dënuari, si dhe lidhur me mbajtjen e kontakteve të këtij të fundit me Shërbimin e Provës, në zbatim të urdhërimeve të gjykatës.

¹⁰⁵ Me e-mail-in datë 9.7.2020.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar lidhur me këtë çështje dhe shpjegimeve të subjektit në prapësime, arsyeton si vijon:

Është provuar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 16.7.2014, të Gjykatës së Lartë, ndryshimi i masës së dënimit të të dënuarit L.B. nga burgim i përjetshëm në dënimin e tij me 25 vjet burgim. Kjo vendimmarrje i ka dhënë mundësinë ligjore të dënuarit që t'i drejtohet gjykatës me kërkesa për ulje dënimi. Po ashtu, është provuar me vendim gjyqësor nr. ***Akti, datë 27.2., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, “Ndryshimi i llojit të sigurisë së burgut për kërkuesin L.B. nga burgu i sigurisë së lartë në një burg të sigurisë së zakonshme.” Gjithashtu edhe kjo vendimmarrje i ka dhënë të drejtë ligjore të dënuarit të përfitojë ulje dënimi jo deri në 45 ditë, por në plotësim të kushteve dhe kriterëve të pasqyruara në dinamikën e vuajtjes së dënimit, deri në 90 ditë në çdo vit kalendarik, vendimmarrje të cilat iniciohen në gjykatë vetëm mbi bazë kërkesë nga i dënuari. Nga verifikimet e këtyre vendimeve gjyqësore dhe aktet e administruara në dosjet gjyqësore ka rezultuar se këto vendimmarrje (që nuk janë dhënë nga subjekti i rivlerësimit) kanë reflektuar dhe janë bazuar në dinamikën e vuajtjes së dënimit, administruar në mënyrë të herë pas hershme, të cilat depozitohen nga institucioni ku i dënuari vuan dënimin. Në çdo rast dinamika e vuajtjes së dënimit pasqyron edhe sjelljen e të dënuarit, punën e kryer si dhe vlerësimet e institucionit, duke përfshirë këtu edhe lejet e përfituara nga i dënuari. Ndër disa vendime të marra për ulje dënimi rezultoi se me vendimin nr. ***, datë 11.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të dënuarit i është ulur dënimi me 675 ditë, nga data 6.4.2006 deri më 7.4.2015. Pra, siç edhe renditen faktet, trupi gjykues konstaton se nga gjyqtarë të tjerë janë ndërmarrë disa vendimmarrje gjyqësore, të cilat i kanë mundësuar të dënuarit që hap pas hapi të arrijë deri në kërkimin e lirit para kohe me kusht, ku subjekti i rivlerësimit, vetëm në këtë të fundit, ka rolin e njërit prej anëtarit në shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe, më tej, edhe nëvendimmarrjen në fjalë.

Trupi gjykues, nga leximi literar i bërë pikës 2, të nenit 462, të Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se: “*Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimidhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes*“, çmon se nëse vendimi i uljes së dënimit (i cili iniciohet vetëm me kërkesë të të dënuarit) me 45 ditë vlerësohet si përjashtim i të konsideruarit të të dënuarit me një dënim me 45 ditë më shumë se realiteti, atëherë në logjikë të drejtë ligjore kuptohet që përse kohë ky dënim ishte dhënë përpara se të vendosej lirimi para kohe me kusht, automatikisht nuk mund të dilte jashtë sferës së përlllogaritjes, pasi vendimmarrja do të bazohej mbi një situatë precedente dhe jo mbi atë të përditësuar. Dhe gjithsesi, edhe një refuzim i mundshëm i kërkesës me të vetmin arsyetim që kishte dhënë edhe Gjykata e Shkallës së Parë – pra vetëm për mosplotësim të kushtit të vuajtjes së $\frac{3}{4}$ të dënimit – ishte i destinuar për t’u riformuar, apo zëvendësuar/superuar nga një vendim i mëtejshëm që do të përfshinte në përlllogaritje dhe nuk mund të injoronte efektet e një tjetër vendimmarrjeje më të hershme (jo të subjektit), të datës 1.12.2016, përuljen e dënimit të dhënë me 45 ditë, pas të cilit tejkalohet vuajtja e $\frac{3}{4}$ të dënimit total. Pra, në thelb nuk rezulton të jetë deformuar situata faktike e rrethanave që plotësonin kriteret ligjore, por maksimalisht mund të diskutohet mbi momentin e vendimmarrjes.

Po ashtu, sikurse u citua më sipër një nga provat që merr vlerë të caktuar në uljet e dënimit apo lirim para kohe me kusht është pikërisht dinamika e vuajtjes së dënimit, dokument që është atribut dhe përgjegjësi¹⁰⁶ e institucionit të vuajtjes së dënimit. Në këtë këndvështrim, sikurse ligji ka parashikuar dhe besuar çdo institucioni kompetencën dhe rolin e tij, vlerësimi i dinamikës së vuajtjes së dënimit del jashtë çmuarjes së trupit gjykues në vlerësimin e kësaj çështjeje, pra thënë ndryshe, trupi gjykues nuk mund të kryejë përlllogaritje mbi ato të

¹⁰⁶ Referuar nenit 31/6 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar.

pasqyruara në dinamikë. Trupi gjykues, në analizën procedurale, mban në konsideratë linjën e ndjekur me të cilën është paraprirë vendimmarrja e lirit para kohe me kusht. Në këtë drejtim, Komisioni renditi më sipër të gjitha veprimet ligjore të ndodhura, duke nisur nga ndryshimi i masës së dënimit, i cili lidhet ngushtësisht edhe me nivelin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit, ndryshimi i zëvendësimit të institucionit të vuajtjes së dënimit, pranimi i kërkesave të njëpasnjëshme, por në kohë sipas parashikimit ligjor për të përfituar ulje dënimi, administrimi në çdo rast i dinamikës së vuajtjes së dënimit për përfitim të uljes së dënimit, veprime ligjore të cilat të mbledhura së bashku janë finalizuar me vendimmarrjen e lirit para kohe me kusht.

Në lidhje me sa më lart – pa dashur të zëvendësohet logjika e vendimmarrjes, për sa kohë nuk është kompetencë e Komisionit të kryejë vlerësime mbi themelin e çështjes – duke analizuar materialin e administruar dhe krahasuar atë me plotësimin e kriterëve të kërkuara për pranimin (ose jo) të kërkesës në fjalë, konstatohet se përtej kriterit të plotësimit të vuajtjes së $\frac{3}{4}$ të dënimit, nuk janë konstatuar mangësi dhe madje as nuk ka pasur dyshime dhe nuk janë pretenduar mosplotësime të kriterëve të tjera ligjore për lirim me kusht, as nga prokurori që ka paraqitur rekurs ndaj vendimit të subjektit dhe as nga Gjykata e Shkallës së Parë, që e ka rrëzuar kërkesën vetëm për moskryerjen e $\frac{3}{4}$ të dënimit.

III/2.a Trupi gjykues, në ndryshim nga pretendimi i bërë prezent nga subjekti në parashtrimet e saj se prokurori e ka kuptuar gabim përcaktimin e nenit 427/5¹⁰⁷ të Kodit të Procedurës Penale, në rastin kur Gjykata në datën 31.10.2016 ka shtyrë seancën për administrim të tri vendimeve të themelit, për më shumë se 10 ditë sipas parashikimit të bërë në nenin 427/5 të Kodit të Procedurës Penale dhe se konkretisht seanca është zhvilluar më 5.12.2016 (mbi një muaj nga parashikimi ligjor), veprim i cili ka mundur edhe depozitimin e vendimit të uljes së dënimit me 45 ditë, vëren se gjykata në vendimmarrjen¹⁰⁸ e saj, për të shtyrë seancën e kërkesës për lirim para kohe me kusht, me qëllim administrimin e vendimit të dënimit me burgim të përjetshëm, ka përdorur pikërisht këtë dispozitë. Nën këtë argument, trupi gjykues çmon se, trupa gjykuese ku subjekti është anëtare e saj, ndërsa ka aplikuar nenin 427/5 të Kodit të Procedurës Penale, nuk i është përmbajtur afatit të parashikuar nga kjo dispozitë për caktimin e seancës së radhës.

Në këtë çështje objekt vlerësimi, trupi gjykues çmon se një argument tjetër që merr vlerë në këtë arsyetim është edhe konkluzioni i prokurorit në mbyllje të procesit gjyqësor në shkallë të parë, i pasqyruar shprehimisht në procesverbalin e datës 28.7.2016, si vijon: *“Duke e konsideruar parimisht një të drejtë të ligjshme të të dënuarit, kërkuarit L.B., të drejtën për t’u liruar para kohe me kusht, duke marrë të mirëqena edhe rrethanat e posaçme të karakterit special, shqetësimet dhe problemet familjare, arritjet e qëllimit të riedukimit, konsideroj një anomali thelbësore në diskutimin e kërkesës, përmbushjen e kriterit formal të masës së dënimit, të dhënë ndaj të pandehurit. Pretendimi i ngritur për trajtimin e periudhës nga vendimi i apelit në Gjykatën e Lartë, mendoj se do parë objekti i posaçëm i gjykimit dhe duhet trajtuar domosdoshmërisht nga Gjykata e Lartë, pasi është një fenomen i rrallë, në këto kushte unë jam për rrëzimin”*.

Në këtë këndvështrim përsa kohë çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë e cila ka në kompetencë jo vetëm ta zgjidhë atë, por edhe të unifikojë praktikën gjyqësore të çështjeve me natyrë të veçantë dhe me mundësi interpretimi të shumëfishtë, trupi gjykues, bazuar në nenin 72/4 të ligjit nr.96/2016, çmon se nuk ka tagrin të vlerësojë gjykimin e korrektësisë së vendimit

¹⁰⁷ Neni 427/ Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor (shtuar e ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) ... 5. Për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, të vendosur në bazë të paragrafëve të mësipërm, procedohet menjëherë dhe kur kjo nuk është e mundur, shqyrtimi gjyqësor shtyhet për një afat jo më të gjatë se 10 ditë.

¹⁰⁸ Për sa kohë nuk është proceduar menjëherë.

apo të analizojë themelin e çështjes gjyqësore, përsa kohë lehtësisht konstatohet se ankimi i organit të akuzës kryesisht i përket këtij niveli, pra, themelit të çështjes.

❖ Në tërësi, përsa është arsyetuar, trupi gjykues vlerëson se konstatimi ligjor i arsyetuar në pikën III/2.a, pa synuar të zëvendësojë apo cenojë logjikën e arsytimit të subjektit në këto parashtrime dhe as në vendimmarrje lidhur me këtë çështje, përbën rrethanë që të konkludojë për dërgimin e kësaj çështjeje pranë organit të inspektimit për verifikime të mëtejshme nëse ka shkaqe për procedim disiplinor.

III/3 Komisioni, në vlerësimin e kontrollit profesional të subjektit, ka administruar edhe dokumentacionin e përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë 4.1.2018, lidhur me kontrollet e ushtruara në disa gjykata të vendit, me objekt të përgjithshëm, por edhe tematik.

i. Nga aktet e administruara, ndër të tjera, konstatohet se është inspektuar çështja penale në ngarkim të shtetasit B.P., akuzuar për veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese e mbetur në tentativë dhe prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka vendosur mbi kërkesën e të pandehurit me vendimin nr. ***, datë 15.5.2015, zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest me burg” dhënë me vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, në detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

ii. Në arsytimin e zëvendësimit të masës, ndër të tjera, subjekti ka arsyetuar bazuar në kriteret e parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, në raport edhe me pikën 6 të nenit 246 të po këtij kodi. Subjekti ka arsyetuar mbi personalitetin e të dyshuarit, duke cituar se nuk ka rrethana bindëse që i dyshuari të kryejë krime të tjera të rënda apo të të njëjtit lloj. Po ashtu është arsyetuar se i dyshuari ka qenë i padënuar më parë dhe, për pasojë, nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë.

iii. Mbi këtë vendim është ushtruar ankim nga organi i prokurorisë, i cili, ndër të tjera, ka pretenduar se masa e sigurimit që është aplikuar është e vetmja masë e përshtatshme sipas kriterëve të nenit 230/1 të Kodit të Procedurës Penale, për të bërë një hetim të plotë dhe objektiv në raport me rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit.

iv. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e saj nr***, datë 11.6.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest me burg”. Ndaj vendimit nuk është ushtruar rekurs.

v. Ka rezultuar se gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit B.P., për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për masën e sigurimit “arrest me burg”, ai nuk është gjendur.

vi. Për këtë çështje, Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. ***prot., datë 9.6.2016, i ka dërguar subjektit raportin përkatës mbi shkeljet e konstatuara, për të paraqitur pretendime dhe prova mbi faktet e konstatuara.

vii. Subjekti, në datën 23.6.2016, ka dërguar observacionet mbi relacionin e inspektimit. Ndër të tjera, ka shpjeguar se ka konsideruar në cilësinë e provave të reja ekspertimet e kryera nga organi i akuzës të cilat ishin cilësuar që në vleftësimin e arrestit si veprime hetimore që do të kryheshin në vijim. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se çështja shqyrtohet edhe në kuadrin e të drejtave të njeriut, duke cituar detyrimin e sanksionuar që gjykimi të caktohet, zhvillohet dhe përfundojë në një kohë sa më të shpejtë dhe të arsyeshme, duke u verifikuar nëse i arrestuari është duke u gjykuar në gjendje arresti për një kohë të gjatë jo të arsyeshme.

viii. Me shkresën nr. *** prot., datë 6.9.2016 konstatohet se Ministria e Drejtësisë në informacionin e dhënë Ministrisë së Punëve të Brendshme ka konkluduar se për gjyqtarët e inspektuar për të cilët ka rezultuar se nuk janë zbatuar dispozitat procedurale lidhur me kriteret

e caktimit të masës së sigurimit apo zëvendësimit të saj, shkeljet nuk kanë qenë të asaj shkalle që të passjellin fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve, por ato duhen mbajtur në konsideratë në rast përsëritjeje.

ix. Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, duke u përqendruar në pretendimet e organit të akuzës në ankimin e ushtruar ndaj vendimit të zëvendësimit të masës së sigurimit, në raport edhe me vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të gjykimit të themelit të kësaj çështjeje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera është shprehur se: *“... me vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, kam vendosur: ‘1.Të vlerësoj të ligjshëm arrestimin në flagrancë të të dyshuarit B.P., i dyshuar për veprën penale ‘vrasje në rrethana të tjera cilësuese’, e mbetur në tentativë dhe ‘prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit’, të parashikuar nga nenet 79/dh e 22 dhe 278/5 të Kodit Penal. 2.Të caktojë si masë sigurimi personal ndaj të dyshuarit B.P. atë të ‘arrestit në burg’, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale...’.Duke mbajtur në konsideratë se në nenin 230 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi ka parashikuar kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, e konkretisht në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet se: ‘Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit’, si dhe faktin se në rastin konkret nga ana e gjykatës u disponua me caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’,pretendimeve të të arrestuarit dhe mbrojtjes së seancës gjyqësore, në arsyetimin e vendimit i kam lënë detyrë organit të akuzës të administronte sa më shpejt të ishte e mundur rezultatet e veprimeve të para hetimore. Konkretisht në vendim kam argumentuar: ‘Në lidhje me rastin konkret gjykata çmon dhe i bën me dije përfaqësuesit të akuzës se është i nevojshëm administrimi sa më shpejtë të jetë i mundur i rezultateve të para hetimore, për të cilat është proceduar me vendim nga prokurori dhe të vihet menjëherë në dijeni gjykata në lidhje me këto rezultate. Kjo në mënyrë që nga ana e gjykatës të verifikohet sa më shpejtë që të jetë e mundur çdo pretendim i të arrestuarit që i është privuar liria, në funksion të respektimit të lirive dhe të drejtave të tij themelore. I arrestuari dhe mbrojtja ngritën pretendime për mospërfshirjen fare në ngjarje për sa i përket momentit të qitjes me armë zjarri, duke pretenduar se ky i arrestuar nuk ka qenë poseduesi i armës së sekuestruar dhe as ka qëlluar me armë.Në kushtet që në funksion të hetimit të këtyre fakteve prokurori ka vendosur kryerjen e ekspertimeve përkatëse, gjykata çmon të nevojshme shqyrtimin sa më shpejt të rezultateve të ekspertimeve konkrete, në funksion të dhënies së drejtësisë dhe respektimit të të drejtave procedurale të personit nën hetim’¹⁰⁹...Përfaqësuesja e akuzës në seancë gjyqësore paraqiti informacion me shkrim për të arrestuarin B.P. në lidhje me gjendjen e procedimit dhe provat e rezultuara pas caktimit të masës së sigurimit.Në material ishin përfshirë të gjitha provat që akuza kishte grumbulluar ndaj të dyshuarit pas momentit të caktimit të masës së sigurimit, pikërisht në lidhje me ato momente që ishin të paverifikuara në seancën e caktimit të masës së sigurimit, për të cilat ishte lënë detyrë nga gjykata që të administroheshin dhe të informohej gjykata, nga ku ka rezultuar se ishin administruar aktekspertizat përkatëse. Në vendim (shprehet subjekti) kam arsyetuar se: ‘Në vlerësim të rrethanave të këtij rasti, gjykata çmon se ekzistojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara nga ligji për vendosjen e personit nën një masë sigurimi personal, parashikuar nga neni 228, pikat 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo pasi vazhdon të ekzistojë dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova në ngarkim të shtetasit B.P., tashmë si autor i mundshëm i veprës penale të parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal dhe ndaj tij nuk provohet asnjë shkak padënueshmërie. Nga ana tjetër, gjykata, në një vlerësim të kushteve të veçanta çmon se në*

¹⁰⁹ Për më tepër shihni vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, f.4.

rastin konkret nevojat e sigurimit mund të përmbushen edhe me një masë më të butë, pasi nuk ekziston asnjë rrezik apo shkak i rëndësishëm që vënë në rrezik marrjen apo vërtetësinë e provave ... Kjo për faktin se në këtë fazë të hetimit provat janë marrë dhe janë vënë nën kontroll nga ana e organit të akuzës dhe nuk provohet asnjë mundësi objektive që personi nën hetim të ndikojë në vërtetësinë e këtyre provave. Së dyti, personi nën hetim B.P. është një person me një personalitet të mirë, i padënuar më parë. Së treti, gjykata çmon se nuk ekzistojnë rrethana të tilla të faktit apo të personalitetit të të dyshuarit, që ai të kryejë krime të tjera të rënda apo të të njëjtit lloj me atë për të cilin rezultojnë të dhëna provuese sipas nenit 300/1 të Kodit Penal. Vepra penale për të cilën dyshohet aktualisht personi nën hetim, nuk dyshohet të përsëritet më prej tij, pasi gjykata çmon se pavarësisht veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal ndaj këtij personi, me provat e reja të administruara nga organi i akuzës, përjashtohet dyshimi për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/1dh e 22 dhe 278/1/5 të Kodit Penal, dhe vazhdon të ketë dyshime se ka kryer veprën penale ‘moskallëzim të krimit’, parashikuar nga neni 300/1 i këtij Kodi”¹¹⁰. Ne nenin 260/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku gjen mbështetje vendimi për zëvendësimin e masës së sigurimit, parashikohet se: ‘Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose denimit që mund të caktohet, gjykata zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë’. Në zbatim të drejtë të kësaj dispozite mikse (procedurale dhe materiale, pasi referon në vlerësim të faktit dhe provave në raport me zbutjen e kushteve për masën e sigurimit) dhe provat e reja të rezultuara në dinamikë të hetimit, në respektim dhe të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale që legjitimon gjykatën të rivlerësojë kushtet dhe kriteret për zbatimin e masës ekstreme arrest në burg, kam vlerësuar drejt se në këtë rast nuk mund të vijohej me zbatimin e arrestit në burg, pasi tashmë faktet në ngarkim të shtetasit B. P. për shkak të të dhënave përjashtuese të akteve të ekspertimit (përshkruara më lart), nuk ishin më të rëndësishme për të cilën ishte regjistruar procedimi penal në ngarkim të tij, por shkonin në çdo rast (eventualisht) deri në moskallëzimin e krimit...”.

Subjekti ka pohuar se në këtë çështje ka zbatuar me përpikmëri të gjitha dispozitat e Kodit të Procedurës Penale lidhur me solemnitetin e gjykimit.

Gjithashtu është shprehur se: “...çmuarja e provave, shqyrtimi apo interpretimi i tyre është në tagrin absolut të gjykatës dhe një organ administrativ nuk mundet kurrësi të bëjë interpretim të provave. Për më tepër, që në rastin konkret edhe sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, rezultoi se nga ana ime provat janë vlerësuar tërësisht në përputhje me ligjin, konstatimet ligjore bazuar mbi prova që unë kam bërë në vendimin e zëvendësimit të masës së sigurimit, kanë rezultuar aq të drejta sa dhe vetë përfaqësuesi i akuzës, pasi e mban çështjen në hetim dhe për disa muaj të tjerë pa marrë me asnjë provë të re (në shkelje të të drejtave procedurale të personit nën hetim dhe afateve të hetimit) ka konkluduar në ndryshimin e akuzës për këtë shtetas, madje prokurori është treguar aq jokohorent në qëndrimin e tij, sa ka bërë akrobacira të tipit, komunikoi akuzën e moskallëzimit të krimit, shfuqizo pa asnjë bazë të re provash këtë akuzë, njofto më pas akuza për armëmbajtje pa leje, sjellje këto të pastra subjektive të organit të akuzës.

Në një sërë vendimesh të saj Gjykata e Strasburg-ut ka theksuar faktin se elemente si ‘rrezikshmëria e veprës penale’, ‘rrezikshmëria e personit’ apo ‘rreziku i ikjes’, nuk mund dhe nuk duhet të referohen në mënyrë të përgjithshme nga gjykata. Ato duhet të analizohen dhe provohen rast pas rasti duke u marrë në konsideratë nga gjykata përveç parashikimeve ligjore (lloji i veprës dhe marzhi i dënimit) edhe moshë e të pandehurit, arsimit, gjendja familjare dhe sociale, të cilat do ta çonin gjykatën në konkluzionin se i dyshuari do i shmangej hetimit apo gjykimit. ... Për sa i përket rrezikut të largimit, GJEDNJ-ja gjithashtu ka deklaruar se ai nuk mund të matet vetëm në bazë të ashpërsisë së dënimit të mundshëm që personi rrezikon, por,

¹¹⁰ Për më tepër shihni fq.4 të vendimit.

duhet të vlerësohet duke iu referuar disa faktorëve të tjerë të rëndësishëm, si veçanërisht, karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht, si dhe lidhjet e tij ndërkombëtare (çështja ‘Neumeister kundër Austrisë’, GjEDNj, 27 qershor 1968, para. 10; çështja ‘Smirnova kundër Rusisë’; çështja ‘Letellier kundër Francës’, GjEDNj, 26 qershor 1991, para. 43).

Është detyrim i gjykatës që në caktimin e masës së sigurimit, e aq më tepër në verifikimin e saj pas afatit dymujor të zbatimit në përputhje me nenin 246 të Kodit të Procedurës Penale (diligjenca e gjykatës) të vlerësojë provat e grumbulluara në korrelacion me faktin penal dhe fatin e procedimit penal. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Apelit, i cili mbeti i pazbatueshëm nuk ka sjellë asnjë pasojë. Madje vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë (objekt i vlerësimit tuaj) ka shërbyer si garant i lirisë personale të personit nën hetim, në kushtet kur për veprat e regjistruara fillimisht organi i akuzës nuk i komunikoi ndonjëherë akuzë personit nën hetim, madje edhe për akuzën përfundimtare, personi nën hetim është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë...”.

Subjekti ka vijuar të japë shpjegime të thelluara lidhur me qëndrimin e organit të akuzës dhe po ashtu edhe me procedurën e ndjekur prej saj në gjykimin e kësaj çështjeje, duke kundërshtuar çdo konstatim.

Gjithashtu, subjekti ka qartësuar edhe mbi statusin e çështjes së themelit. Më konkretisht ka pasqyruar se në përfundim të hetimeve Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i është drejtuar gjykatës me kërkesë për gjykimin e të pandehurit B.P., akuzuar për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Me vendimin nr***, datë 15.11.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur “deklarimin e pafajshëm të të pandehurit B. P. për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal...”. Subjekti ka depozituar vendimmarrjet e gjykimit për këtë çështje.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të shpjegime të subjektit lidhur me këtë çështje gjyqësore, si dhe provave të administruara, çmon se subjekti ka argumentuar ligjërisht të gjithë procedurën e ndjekur lidhur me gjykimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurisë. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se përsa kohë, është shqyrtuar çështja e themelit, madje rezulton se i pandehuri është shpallur i pafajshëm¹¹¹, në një logjikë të drejtë, të bazuar në prova dhe ligj edhe zëvendësimi i masës së arrestit ndaj të pandehurit rezulton të jetë trajtuar nga subjekti në mënyrë korrekte, në kohë dhe procedurë, duke u bazuar në kërkesa procedurale ndaj organit të akuzës, grumbullim të provave dhe fakteve të reja në dobi të procesit deri në zëvendësimin e masës.

Në këtë kontekst, trupi gjykues nuk konstaton problematika apo shkelje të kryera nga subjekti lidhur me këtë çështje.

III/4. Nisur nga konkludimet e bëra prezent në raportin e DSIK-së (sikurse është pasqyruar më sipër) për të vlerësuar në kontrollin e kriterit profesional:

i. Komisioni, me shkresën nr. ***prot., datë 30.7.2019, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës kopje të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 16.1.2015, dhënë në ngarkim të shtetasve G. B. dhe E.B., akuzuar për veprën penale “korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, bazuar në nenet 259 dhe 25 të Kodit Penal.

¹¹¹ Me vendimin nr. ***, datë 30.11.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës.

ii. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën e saj nr. *** prot., datë 1.8.2019, ka bërë me dije se çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Lartë.

iii. Gjykata e Lartë ka dërguar dosjen gjyqësore.

iv. Nga verifikimi i akteve të administruara në dosje ka rezultuar si vijon:

a. Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. ***, datë 16.1.2015 (ku subjekti i rivlerësimit ka cilësinë e relatorit të çështjes) ka vendosurdeklarimin e pafajshëm të të pandehurit G.B.pasi nuk provohet ekzistenca e faktit penal në ngarkim të tij dhe deklarimin fajtor të të pandehurit tjetër E.B. me 2 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e tij me 1 vit e 4 muaj.

b. Në këtë vendimmarrje njëri prej anëtarëve të trupit gjykues është shprehur me mendim pakice, duke arsyetuar se:

c. Në kronologjinë e ngjarjes së ndodhur, faktet tregojnë që i pandehuri G.B. së bashku me të pandehurin tjetër kanë kryer veprën penale në bashkëpunim.

ç. Pakica ka renditur, ndër të tjerë, faktin se shoqëria private është kontrolluar për shkelje të rregullave të mjedisit, nga të dy të pandehurit me detyrë funksionale publike në Drejtorinë e Mjedisit, ku i pandehuri G. B. ka mbajtur detyrën e drejtuesit, duke ushtruar presion se do t'i vendosej gjobë në shumën 5.000.000 lekë.

Pas një jave ka rezultuar se të dy të pandehurit, së bashku me administratorin e shoqërisë dhe financieren e kësaj të fundit, janë takuar në një lokal.

Pakica ka vijuar në arsyetimin e saj se sasia e lekëve të dhëna (200.000 lekë) si gjobë mujore, të të pandehurit E. B. nga administratori i shoqërisë, e cila i është kapur gjatë kontrollit të policisë të dy shtetasve, është provuar nga numrat serialë se ishte shuma e tërhequr në bankë nga administratori dhe se ky është një tjetër fakt që implikon të dy të pandehurit, pavarësisht se fillimisht i janë dhënë të pandehurit E.B. .

Po ashtu, pakica ka arsyetuar se pretendimi reciprok i të pandehurve se shuma e dhënë nga i pandehuri E.B. dhe marrja nga i pandehuri G. B. ka qenë një shlyerje borxhi, nuk qëndron bëhet e pabesueshme për faktin se i pandehuri E. B. mund të kishte dhënë të gjithë shumën e marrë nga administratori i shoqërisë dhe kështu do të likuidonte më parë borxhin e pashlyer të pandehurit G.B. .

Gjithashtu, ka cituar se pas dhënies së shumës nuk është vendosur gjobë ndaj shoqërisë private. Nën këto argumente mendimi i pakicës është se i pandehuri G. B. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

d. Ndaj vendimit të shkallës së parë ka ushtruar ankim i dënuari E.B., shtetasja D.N., si dhe organi i prokurorisë.

dh. Organi i prokurorisë në ankimin e tij, ndër të tjera, ka paraqitur si shkaqe për prishjen e vendimit:(i) pjesëmarrjen e të pandehurit G.B. në kryerjen e veprës penale si tërësisht të provuar dhe se roli i tij ka qenë tepër aktiv;(ii) të dy të pandehurit pa ndonjë shkak kanë ushtruar kontroll në ambientet e kompanisë “****” sh.p.k.:(iii) analiza e provave nga gjykata është bërë e njëanshme duke i marrë faktet të shkëputura dhe duke anashkaluar faktet që implikojnë të pandehurin G. B.; dhe se (iv) faktet e pohuara nga kallëzuesja me iniciale D.N. (me detyrë ekonomiste e shoqërisë) provojnë plotësisht akuzën në ngarkim të tyre.

e. Ka rezultuar se Gjykata e Apelit me vendimin e saj nr. ***, datë 24.11.2015, ka prishur vendimin e shkallës së parë duke e rikthyer çështjen për rigjykim në shkallë të parë. Ndër të tjera, kjo gjykatë ka argumentuar se për të dy të pandehurit, përkatësisht shtetasen D.N. me detyrë ekonomiste dhe shtetasin X. W., administrator i shoqërisë (i cili kishte bërë edhe

kallëzimin e veprës penale) ka pasur papajtueshmëri (pasi e pandehura është dënuar mbi kallëzimin e administratorit të shoqërisë) marrja e të njëjtës mbrojtje. Në këto kushte gjykata ka cilësuar prishjen e vendimit për shkelje të nenit, në shkelje të germës “c”, të nenit 128/1, të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenit 54/2 të po këtij kodi me arsyetimin se gjykata duke konstatuar papajtueshmërinë duhet të deklaronte atë me vendim dhe të bënte zëvendësimet e nevojshme.

ë. Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në raport me arsyetimin e saj në vendimin përkatës, me qëndrimin e organit të prokurorisë në vendimarrje dhe në ankimin e gjykatës së Apelit, me arsyetimin e gjykatës së një shkalle më të lartë si ajo e apelit, e cila ka prishur dhe kthyer çështjen për rigjykim, si dhe me mendimin e pakicës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në lidhje me vendimin nr. ***, datë 16.1.2015, dhënë në ngarkim të shtetasve G.B. dhe E. B., akuzuar për veprën penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të kryer në bashkëpunim, bazuar në nenet 259 dhe 25 të Kodit Penal, në funksion dhe mbështetje të shpjegimeve në lidhje me këtë çështje, në të gjitha aspektet e kërkuara nga Komisioni ka paraqitur:(i) procesverbale të seancave gjyqësore të gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ka qenë gjyqtar kryesues i kësaj çështjeje;(ii) vendimin nr. ***, datë 16.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (arsyetuar nga ana e saj me cilësinë e kryesuesit);(iii) aktin procedural të ankimit të prokurorit të çështjes në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës;(iv) aktin procedural titulluar “kërkesa paraprake” të prokurorit të Apelit Durrës, datë 18.6.2015;(v) vendimin nr. ***, datë 24.11.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës (i cili ka prishur vendimin objekt vlerësimi, duke kthyer aktet për rigjykim); (vi) vendimin nr. ***, datë 20.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (rigjykimi); (vii) konkluzione të Prokurorit të Apelit Durrës datë 3.11.2016 (në rigjykim); si dhe (viii) vendimin nr. *** datë 20.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës (në rigjykim).

Subjekti ka sqaruar se: “... në lidhje me shkakun procedural të aplikuar nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila me vendimin e saj nr. *** datë 24.11.2015 ka prishur dhe kthyer çështjen për rigjykim, me argumentin se i njëjti avokat ka pasur papajtueshmëri për të mbrojtur dy nga të pandehurit e këtij procedimi penal të lidhur, nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 26.11.2014 mbajtur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (faqja 3) rezulton qartësisht se nga ana ime me cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues, pikërisht për të shmangur çdo eventualitet papajtueshmërie të mbrojtjes, kjo çështje është trajtuar me avokatin dhe prokurorin e çështjes, të cilët të dy kanë deklaruar se ndërmjet dy të pandehurve nuk ka deklarime kundërthënëse, që sipas ligjit do të ishte i vetmi shkak që çon në papajtueshmërinë e mbrojtjes”.

Vetëm pas trajtimit të kësaj çështjeje me palët është proceduar me marrjen e akteve të kërkuara. Kjo çështje ka përfunduar me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe i njëjti mbrojtës që ka përfaqësuar dy të pandehurit në gjykim ka mbrojtur ata edhe në çdo veprim procedural në fazën e hetimit paraprak, ku prania e mbrojtjes është e domosdoshme (shihni aktet e dosjes hetimore). Çdo deklaram i këtyre dy të pandehurve, marrja të pandehur, njoftimi i akuzës, pyetja me cilësinë e të pandehurit dhe çdo akt tjetër në drejtim të tyre është kryer nga prokurori nëpërmjet mbrojtjes së tyre me të njëjtin avokat, pikërisht për faktin se prokurori ka pasur vlerësimin se të pandehurit nuk kishin kundërthënie dhe nuk ishin në kushtet e papajtueshmërisë së mbrojtjes. Subjekti ka qartësuar se këtë qëndrim si gjyqtare e ka vlerësuar të drejtëdhe se ka vijuar gjykimin dhe ka sqaruar se nëse do të qëndronte shkaku procedural që është konsideruar si pavlefshmëri e procesit, atëherë për të njëjtin shkak (papajtueshmërinë e mbrojtjes), prokurorit do t’i bëheshin të pavlefshme shumë akte procedurale të fashikullit hetimor dhe, për rrjedhojë të papërdorshme shumë prova të vëna në themel të akuzës, gjë që në fakt nuk ka ndodhur. Çështja është rigjykuar sërish me gjykim të shkurtuar, duke marrënë cilësinë e provës po ato

akte hetimore, ku në fakt dy të pandehurit ishin mbrojtur sërish me të njëjtin mbrojtës dhe gjykata e shkallës së parë në rigjykim nuk ka pasur asnjë konsideratë në lidhje me pavlefshmëritë që shkakton qëndrimi i Gjykatës së Apelit Durrës, as prokurori në apel gjatë rigjykimit nuk ka mbajtur asnjë qëndrim në këtë drejtim. Subjekti është shprehur se jemi para një alogjizmi në zbatimin e ligjit ndërmjet qëndrimit të prokurorit të apelit, Gjykatës së Apelit dhe çfarë ka ndodhur në hetim dhe gjykimin në shkallë të parë. Në një zbatim të drejtë të ligjit procedural penal, asnjë akt i hetimit paraprak ku dy të pandehurit janë përfaqësuar me të njëjtin mbrojtës nuk do të kishte më vlerë juridike, pasi do të konsideroheshin të marra në kundërshtim me dispozita urdhëruese të ligjit, si rrjedhojë e cenimit të së drejtës së mbrojtjes në kuptim tëgermës “c”, të nenit 128/a, të Kodit të Procedurës Penale.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të akteve të depozituara, si dhe parashtrimeve të prezantuara nga subjekti, vëren se prokurori i çështjes ka ankuar themelin, me qëllim deklarimin fajtor të të pandehurit G.B. për të cilin gjykata kishte vendosur deklarimin e tij të pafajshëm, ndërsa gjykata ka kthyer çështjen për procedurë.

Më konkretisht, Gjykata e Apelit ka kthyer çështjen për rigjykim duke vënë në diskutim mbrojtjen e të pandehurve, (jo për shtetasin G. B.) nga i njëjti përfaqësues ligjor, veprim të cilin në fakt ligji ia garanton të pandehurit.

Nga aktet rezulton se nga gjykata e shkallës së parë (ku bën pjesë subjekti i rivlerësimit) është reflektuar me përpikmëri në procesverbalin¹¹² e seancës gjyqësore, fakti se të pandehurit e mbrojtur nga i njëjti avokat nuk kanë pasur konflikt në lidhje me faktet dhe kundërshtime në lidhje me njëri-tjetrin. Po ashtu, po në këtë akt provohet dakordësia e prokurorit të çështjes që të pandehurit mund t'i mbrojë i njëjti avokat, pasi të pandehurit nuk kanë kundërthënë. Neni 54/2 i Kodit të Procedurës Penale do të gjente zbatim pikërisht nga organi procedues në rast të papajtueshmërisë së interesave të të pandehurve, ndërsa gjykata mbi bazë edhe të këtij neni ka kthyer çështjen për rigjykim.

Përtej vlerësimit ndaj subjektit është fakti i provuar drejtpërdrejtë që në Gjykatën e Apelit, gjykimi ndaj të pandehurit G.B. nuk ka marrë vëmendje, ndërsa gjykimi i çështjes është kanalizuar në procedurë, me pasojë kthim për rigjykim për një procedurë që në fakt ishte ezauruar nga subjekti.

Pra, në tërësi ajo që vërehet në këtë rast dhe që krijon një kontradiktë lidhur me ankimin e ushtruar nga prokurori i çështjes mbi vendimmarrjen e subjektit ndaj të pandehurit G. B. dhe vendimmarrjes së gjykimit të çështjes në apel, duke u vendosur kthimi dhe rigjykimi i saj pikërisht për papajtueshmëri të faktit se të pandehurit e tjerë të kësaj çështjeje (përjashtuar të pandehurin G. B.) janë mbrojtur nga i njëjti avokat, bie ndesh me provat dhe veprimet procedurale të ndjekura në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga subjekti. Gjithsesi, gjykimi në apel është çmuarje e një gjykate më të lartë, por që në rastin objekt hetimi nuk ndikon ndaj veprimtarisë së subjektit. Më konkretisht, duke qenë se në kthimin për rigjykim janë lënë detyra të cilat ishin trajtuar nga subjekti, atëherë çështja kurrësi nuk mund të shtrohet në disfavor të subjektit.

Defektet procedurale¹¹³ të konstatuara në kthimin për rigjykimin (megjithëse janë vlerësim i gjykatës dhe që nuk i referohen çështjes mbi provueshmërinë e kryerjes së veprës penale nga shtetasi G. B.) duket se nuk qëndrojnë, për më tepër, kur edhe në rigjykimin në shkallë të parë

¹¹² E seancës gjyqësore datë 26.11.2014, depozituar së bashku me praktikën e kësaj çështjeje gjyqësore, nga subjekti në prapësime.

¹¹³ Të kërkuara nga prokurori në apel.

është hetuar mbi të njëjtat akte hetimore të organit të akuzës (ku dy të pandehurit ishin mbrojtur nga i njëjti përfaqësues ligjor).

Trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje pikërisht gjykimet e kësaj çështjeje nga një gjykatë në tjetrën, kërkimin e organit të akuzës gjithashtu, nga njëra gjykatë në tjetrën, si dhe faktin se vendimi i subjektit të rivlerësimit deri aktualisht ka mbetur në fuqi¹¹⁴ megjithë gjykimet dhe rigjykimet e çështjes, por edhe nisur nga fakti që aktualisht çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë, organ i cili do të vendosë mbi ligjërimin e vendimeve gjyqësore të ndërmarra më parë, çmon se deri aktualisht nuk diktohen problematika, që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit dhe, për pasojë, as edhe në konkludimet e raportit të DSIK-së.

Në lidhje me denoncimet¹¹⁵ e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ku disa prej dononcuesve kanë depozituar të njëjtin ankim dy ose më shumë herë, për të njëjtin objekt dhe me të njëjtat pretendime, ka rezultuar si vijon:

1) Denoncim¹¹⁶ i shtetasit F.Gj.

Denoncuesi ankohet për ndryshim të trupës gjyqësore në vendimmarrjen për ndreqje të gabimeve materiale duke u zëvendësuar njëri prej anëtarëve të trupës që ka gjykuar themelin e çështjes (për qartësim pretendohet ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 20.3.2017, me vendimin nr. ***, datë 8.11.2017 me objekt “ndreqje gabimi”). Këtë veprim denoncuesi ia atribuon subjektit të rivlerësimit duke pretenduar se e ka kryer apo arritur të krijojë shumicën e vendimmarrjes duke dhënë një vendim skandaloz dhe duke sajuar një fakt të rremë që nuk ka lidhje me gjendjen faktike.

Denoncuesi ka vënë në dispozicion edhe dokumentacionin me të cilin i është drejtuar organit të prokurorisë në nëntor të vitit 2011, me kallëzimin e bërë ndaj subjektit të rivlerësimit dhe anëtarit zëvendësues të trupës gjyqësore nën akuzën e shpërdorimit të detyrës.

Denoncuesi pretendon se kërkues në rastin e ndreqjes së gabimit ka qenë Gjykata e Apelit që kishte dhënë vendimin e parë dhe, në këtë rast, denoncuesi është cilësuar si palë ndërgjyqëse në pozicionin e personit të tretë.

Denoncuesi parashtron se, më tej, në vendimin e ndreqjes së gabimit është hequr personi i tretë, ndërsa ishte cituar në kërkesë.

Ai vijon në pretendimet e tij se ndërsa vendimi mban datën 8.11.2017 në dokumentin e nxjerrë nga sistemi mban datën 13.11.2017.

Po ashtu, denoncuesi saktëson se duke qenë se vendimi i referohet nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile, atëherë nuk është vepruar sikurse përcakton ky nen “thirrjen e palëve në gjykim si dhe ushtrimin e së drejtës së ankimit”. Kjo dispozitë, qartëson denoncuesi, e ndalon ndryshimin e vendimit të parë.

Denoncuesi ka depozituar vendimin e parë, dokumentin e nxjerrë nga sistemi që pasqyron datën 13 dhe jo datën 8.11.2017, sikurse pasqyrohet në vendimmarrje, dokumentin e nxjerrë nga sistemi i gjykatës ku pasqyrohet pala e tretë, ndërsa në vendim nuk pasqyrohet, si dhe dokumentin e nxjerrë nga sistemi ku pasqyrohet ora e zhvillimit të seancës, si dhe vendimin nr. ***, datë 20.3.2017, etj.

Nga analizimi i provave të paraqitura apo edhe nga kallëzimi i depozituar nga denoncuesi në organin e prokurorisë, trupi gjykues ka konstatuar në tërësi se ankuesi megjithëse parashtron

¹¹⁴ Me vendimin nr.***, datë 30.1.2017, të Gjyktës së Apelit Durrës.

¹¹⁵ Njëri prej denoncimeve është trajtuar te kontrolli i kriterit të figurës.

¹¹⁶ Nr. ***prot., datë 5.12.2017.

si më sipër, ankimin e synon lidhur me gjykimin e themelit të çështjes ku Gjykata e Apelit, me relatore subjektin e rivlerësimit, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë me objekt detyrimin e shtetasit Gj. për të kthyer shumën 10.000 euro në favor të paditësit, ankesë për të cilën ka depozituar njëkohësisht edhe rekurs në Gjykatën e Lartë. Ndërsa sa i përket ndreqjes së gabimit material, lehtësisht, konstatohet se ndryshimi i identitetit të gjyqtarit është bërë sa i përket pjesës hyrëse të vendimit të themelit, pasi në dispozitivin e vendimit të këtij të fundit ka nënshkruar pikërisht gjyqtari për të cilin edhe është kërkuar ndreqja e gabimit. Pra, sa i përket themelit të çështjes rezulton se kjo e fundit ndodhet e rekursuar në Gjykatën e Lartë, ndërsa veprimi i kryer për pasqyrimin e saktë të njërës anëtar të trupës gjyqësore në pjesën hyrëse të vendimit të themelit, kur në fakt ai është nënshkruar i kësaj vendimmarrjeje, është tërësisht një gabim material.

✓ Në të tilla kushte duket se nuk konstatohen problematika, të cilat ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

2) Denoncim¹¹⁷ i shtetasit I.C.

Në parashtrimet e tij, denoncuesi ankohet në përgjithësi për veprime të padrejta të kryera nga disa gjyqtarë e prokurorë, duke renditur disa emra ku citon edhe subjektin e rivlerësimit, nën pretendimin se po ndërtohet në tokën e tij në kundërshtim me ligjin. Ai nuk jep të dhëna ose detaje lidhur me veprime konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi, ndër të tjera, ka depozituar:

- vendimin e datës 8.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, me palë ndërgjyqëse denoncuesin në cilësinë e kërkuarit, me objekt ankim ndaj vendimit të organit të prokurorisë për “mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues të vitit 2015, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve”;
- vendimin gjyqësor nr. ***, datë 22.6.2017, të Gjykatës së Lartë, si dhe të tjera dokumente pronësore.

Në analizë të provave të depozituara konstatohet se subjekti ka zhvilluar proces gjyqësor pronësor ndaj të cilit është vendosur “pushimi i çështjes”. Më tej, denoncuesi i është drejtuar organit të prokurorisë dhe, në vijim, ka kundërshtuar vendimmarrjen e këtij të fundit për “mosfillim procedimi penal” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, gjykuar nga subjekti i rivlerësimit. Vendimi i dhënë nga subjekti, në favor të organit të prokurorisë, ka ndjekur shkallët e tjera të gjyqësorit dhe në përfundim edhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë nga denoncuesi.

✓ Në kushte të tilla nuk rezultojnë problematika, të cilat ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3) Denoncim¹¹⁸ i shtetasit N.P.

3.1 Denoncuesi, në parashtrimet e tij, ankohet për një proces gjyqësor të zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit pas 10 viteve që kishte ezauruar në rrugë gjyqësore një çështje pronësore të tij dhe familjes së tij, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.11.2001. Ai ankohet se vendimi nr. ***, datë 23.12.2010, i marrë mbi rivendosjen në afat pas 10 viteve, është në shkelje të ligjit kur një kërkesë e tillë mund të paraqitet brenda një viti, për më tepër se nuk është njoftuar sipas nenit 151 dhe 152 të Kodit të Procedurës Civile. Ai ankohet gjithashtu për zbardhje të vendimit pas tre muajve nga marrja e tij. Denoncuesi qartëson se mbi ankimin e tij Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të gjykimit të themelit, marrë në vitin 2001. Ai kërkon të verifikohet veprimtaria e punës së kësaj gjyqtareje dhe të merren masat e nevojshme. Denoncuesi ka

¹¹⁷ Nr***, datë.12.12.2017.

¹¹⁸ Nr. *** prot., datë 26.12.2017.

depozituar vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, vendimin nr. ***, datë 14.10.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe disa raporte mjeksore, për të cilët pretendon se i takojnë personave të dhunuar të familjes së tij për shkak të situatës së krijuar pas dhënies së vendimit nga subjekti i rivlerësimit. I ndjeri babai i denoncuesit (me cilësinë e ish-pronarit) i është drejtuar me ankim edhe KLD-së në vitin 2011, duke i parashtruar të njëjtat pretendime për shkeljet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në gjykimin e çështjes civile me objekt rivendosje në afat, duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës. Në ankimin e tij drejtuar gjyqësorit, denoncuesi ka kërkuar kthimin për rigjykim të rivendosjes së afatit për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë pasi nuk janë thirrur në gjykim.

Në analizë të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 23.12.2010, me objekt “rivendosje në afat”, ndër të tjera, nga subjekti i rivlerësimit është arsyetuar se nga verifikimi i dëftesës së komunikimit të vendimit të themelit, shtetases H. P., konstatohet se nga njëra anë temarrësi i aktit pasqyrohet të ketë nënshkruar kjo e fundit me cilësinë e kërkueses, ndërsa tek komunikuesi mungon tërësisht nënshkrimi i ftuesit gjyqësor.

Në vijim, nga provat e administruara Komisioni vëren se Gjykata e Apelit Durrës, e vënë në lëvizje nga ankimi i trashëgimtarëve të palës që ushtroi të drejtën e rivendosjes në afat ndaj vendimit nr. ***, datë 14.10.2013, ka argumentuar se nga aktet e dosjes gjyqësore të themelit nuk ekziston asnjë shkak për cenimin e vendimit të gjykatës si për njoftimin e palëve për seancat gjyqësore, si dhe për zgjidhjen e themelit të çështjes. Gjykata në arsyetim ka sqaruar se e paditura, në themelin e çështjes dhe njëkohësisht kërkuese në rivendosjen në afat të ankimit ndaj themelit, është njoftuar rregullisht dhe se fletëthirrjet janë të firmosura në prani të ftuesit, pavarësisht mosparaqitjes së saj. Nën këtë arsyetim, kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin e vitit 2001, që i përket themelit të çështjes.

3.1.i Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin¹¹⁹ provues mbi të cilin është bazuar dhe argumentuar vendimmarrja nr. ***e rivendosjes në afat.

3.2 Subjekti ka kundërshtuar pretendimet në denoncim, si të pabazuara, duke qartësuar se ka vepruar në zbatimin korrekt të nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet mundësia e rivendosjes në afat të ankimit kundër një vendimi që ka marrë formë të prerë, dispozitë në të cilën thuhet shprehimisht: *“Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara Gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të tij mund të bëhet ankim i veçantë”*. Subjekti ka shpjeguar se ka vepruar në përputhje me ndryshime të ligjit nr.8812, datë 17.5.2001, ku e drejta e palës për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit nuk kushtëzohet me afat prekluziv nga koha e dhënies së vendimit, afat që hedh në dekadencë vetë të drejtën, siç parashikohej para ndryshimeve, por mund të realizohet në çdo kohë, kur pala vjen në dijeni dhe provon pavlefshmërinë e njoftimit të vendimit të dhënë në mungesë, siç ka ndodhur në rastin konkret, për të cilin ka sqaruar se është konstatuar pavlefshmëria e njoftimit të vendimit për palën për të cilin vendimi ishte shpallur në mungesë e, në përputhje me kriteret e neneve 122, 128 dhe 130 të Kodit të Procedurës Civile.

Subjekti është shprehur se: *“Pavarësisht faktit se Gjykata e Apelit Durrës, pas shqyrtimit të çështjes nëpërmjet ankimit të rivendosur, ka lënë në fuqi vendimin e themelit të çështjes, duke mos konstatuar shkelje procedurale në njoftimet e gjykimin, seancave gjyqësore, kjo nuk e bën vendimin tim në kundërshtim me ligjin, pasi në vendimin e rivendosjes unë si gjyqtar nuk kam marrë në shqyrtim njoftimet e seancave gjyqësore, kjo nuk mund të jetë atribut i gjyqtarit të rivendosjes, por e Gjykatës së Apelit kur shqyrton çështjen në themel. Në këtë rast, nga ana*

¹¹⁹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

ime është konstatuar pavlefshmëri e njoftimit të vendimit përfundimtar shpallur në mungesë të palës kërkuese. Gjykata, që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat të ankimit, shqyrton vetëm ligjshmërinë e akteve që kanë njoftuar vendimin përfundimtar dhe jo akte që kanë synuar njoftimin e palëve gjatë gjykimit të çështjes në themel”.

Subjekti ka depozituar aktin “dëftesë komunikimi/njoftim vendimi”, për të qartësuar në pabazueshmërinë e pretendimeve të denoncuesit, si dhe vendimin gjyqësor nr. ***. Subjekti pretendon se në dëftesën njoftim vendimi del qartë fakti se njoftimi i vendimit në mungesë për palën kërkuese, ka pasur shkaqe haptazi pavlefshmërie. Ndërkohë që i njëjti ftues gjyqësor e ka respektuar ligjin kur i ka njoftuar vendimin Bashkisë Durrës edhe kjo palë në proces (shihni dy dëftesat e njoftimit të vendimit për palët në mungesë) dhe nuk e ka respektuar për kërkuesen H. P. .

3.3 Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe provave të depozituara si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, vlerëson faktin se vërtet rivendosja në afat ka pasur lidhje të drejtpërdrejtë me pavlefshmërinë e aktit të njoftimit të vendimit të themelit të çështjes së vitit 2001, për shkak të mungesës së njëres palë në shpalljen e vendimit, por nga ana tjetër padyshim që pasoja e vendimmarrjes lidhet ngushtësisht me vijueshmërinë e ankimit për themelin e çështjes. Kjo mënyrë kërkimi hap rrugën e zhvillimit të procesit gjyqësor të themelit për të cilin në fakt u provua që vetë pala që rezultonte në mungesë të kishte qenë pjesë e një marrëdhënieje kontraktore shitje të pasurisë objekt gjykimi i themelit, pas shpalljes së vendimit të themelit, çka në mënyrë të drejtpërdrejtë tregon për marrje dijani të saj lidhur me vendimin. Në këto kushte, ky ka qenë një element i rëndësishëm për t’u vlerësuar nga gjykata në rast të njoftimit të palës kundërshtarë (sikurse e ka paraparë neni 152, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile¹²⁰) në procesin e rivendosjes, përveçse vlerësimit të afatit kohor tepër të gjatë të kërkimit të rivendosjes në afat nga gjykimi i themelit të çështjes, i cili duhet të bënte një lidhje logjike me pretendimin për mosmarrje dijani të një vendimi për 10 vite radhazi. Por në vlerësim të përgjithshëm të rastit nuk konstatohen problematika që të mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

4) Denoncim¹²¹ i shtetases R.H.A.

Denoncuesja ankohet për zvarritje të proceseve gjyqësore dhe dhënie të vendimeve në kundërshtim me ligjin.

✓ Denoncuesja ka depozituar vendimin gjyqësor nr. *** datë 7.12.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është pjesë e trupit gjykues.

5) Denoncim¹²² i shtetasit E. M.

Denoncuesi, në ankimet e tij pretendon për zvarritje të procesit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa saktëson se pas shumë zvarritjesh ai/procesi ka përfunduar. Po ashtu, në denoncim ai ka renditur disa emra gjyqtarësh për të cilët pretendon se janë të korruptuar dhe se ka prej 23 vitesh që endet nëpër gjykatë për çështje pronësore. Denoncuesi nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument dhe as nuk jep detaje nëse ka ushtruar ankim ndaj ndonjë vendimmarrjeje.

✓ Në të tilla kushte duket se nuk ka rrethana që ndikojnë në vlerësimin e subjektit.

6) Denoncim¹²³ i shtetasit I. S.

¹²⁰ I ndryshuar në vitin 2008, ndërsa rivendosja në afat është gjykuar në vitin 2010.

¹²¹ Nr.***prot., datë 18.1.2018.

¹²² Nr. *** prot., datë 8.2.2018, nr. *** prot., datë 22.1.2019.

¹²³ Nr. *** prot., datë 21.2.2018.

Denoncuesi, ndër të tjera, ankohet ndaj vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Durrës duke cituar edhe subjektin e rivlerësimit. Ai ankohet se i është cenuar me pa të drejtë pronësia e motrës së tij, përmes një vendimmarrjeje të marrë në kundërshtim me ligjin.

Në analizë të dokumentacionit të depozituar nuk pasqyrohet asnjë lidhje midis denoncuesit (qoftë edhe me tagrin e përfaqësuesit ligjor) dhe palëve ndërgjyqëse në vendimmarrjen nr. ***, datë 21.12.2016, të Gjykatës së Apelit, por as edhe në aktet e tjera shoqëruese si prokura apo dokumentacione pronësie të cilat duket të jenë administruar në procesin gjyqësor të vendimmarrjes së cituar. Njëkohësisht konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk është pjesë përbërëse e trupës gjyqëse të vendimit të sipërcituar.

- ✓ Në kushte të tilla denoncimi nuk paraqet fakte apo rrethana që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

7) Denoncim¹²⁴ i shtetas E.M. H.

Denoncuesja është në lidhje të afërt me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit (konkretisht vajza e hallës së tij). Ajo denoncon subjektin e rivlerësimit për lidhjet e saj dhe bashkëshortit të saj me personatë tjerë, të cilët kanë ndikuar në padrejtësitë që i janë bërë në gjykatë për 27 vite për shkak të dhunimit të pronësive që ka nëpër procese gjyqësore, që siç duket nga parashtrimet, pasuritë pretendohen sitë përbashkëta me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, por që kanë përfunduar gjyqeve. Shtetasja pretendon se ndikimi i tyre ka mundësuar ndërtime pa leje dhe probleme të shumta familjare.

Komisioni konstaton se denoncuesja nuk ka vënë në dispozicion asnjë vendim gjyqësor apo akt tjetër për të provuar denoncimin e saj, pra, në tërësi për të provuar paligjshmëritë e kryera nga subjekti i rivlerësimit.

- ✓ Në këto kushte denoncimi nuk paraqet fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

8) Denoncim¹²⁵ i shoqërisë “****” sh.p.k. (si kredimarrëse), përfaqësuar nga znj. A.Ç.

8.1 Denoncuesit ankohen për një proces gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë me objekt “lëshimin e urdhrin të ekzekutimit” mbi kërkesën e “Credins Bank”, ndërsa janë në proces gjyqësor themeli për një kontratë kredie afatgjatë në vlera të konsiderueshme dhe njëkohësisht referojnë në denoncim se janë në të njëjtën situatë të gjykimit të një çështjeje me të njëjtin objekt si më sipër të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit për “lëshim urdhri ekzekutimi për kontratë *overdraft*, nen i parashikuar në kontratën e kredisë afatgjatë”. Denoncuesi pretendon se Gjykata e Apelit, me vendimmarrjen e saj, cenoi dhe mund të cenojë kontrollin gjyqësor mbi themelin e çështjes.

Denoncuesi pretendon se gjykata ndërsa duhet të gjykonte pa praninë e palëve kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, pra, të gjykonte në dhomë këshillimi pa praninë e tyre, ajo ka pranuar nga pala të tjera dokumente duke shkelur nenin 511 e Kodit të Procedurës Civile.

Denoncuesi ka depozituar disa dokumente të cilat duket se kanë të bëjnë me pretendimet e procesit të themelit, por nuk ka depozituar as vendimmarrjet e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit dhe as nuk ka dhënë detaje mbi ecurinë e mëtejshme të ushtrimit ose jo të së drejtës ankimore.

8.1.i Për të qartësuar pretendimin e denoncuesit, Komisioni i ka kërkuar¹²⁶ subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë vendimmarrje, të depozitojë vendimin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, si dhe të qartësojë mbi pretendimet e denoncuesit për marrje të provave në

¹²⁴ Nr.***prot., datë 19.1.2018.

¹²⁵ Nr. ***prot., datë 5.2.2019.

¹²⁶ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

tejkalim të parashikimit ligjor për mënyrën se si procedohet dhe vendoset lidhur me lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

8.2 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka kundërshtuar ankimin e denoncuesit dhe, ndër të tjera, ka shpjeguar se lëshimi i urdhrin të ekzekutimit është një proces gjyqësor që sipas ligjit inicohet në gjykatë vetëm nga një palë, që është pala kreditore, e cila kërkon të hapë rrugën e ekzekutimit të detyrueshëm të një detyrimi, përballë palës debitore që pretendohet se nuk ka përmbushur detyrimet e marra përsipër, në rastin konkret nëpërmjet kontratës së kredisë. Gjykimi në fjalë është iniciuar nga pala kërkuese “CredinsBank” me objektin konkret dhe bashkëlidhur kërkesës janë paraqitur edhe aktet provuese. Në kushtet që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka rrëzuar kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit me arsyetimin se mungojnë aktet e njoftimit të palës debitore për shlyerjen e detyrimit, pala kërkuese ka ankuar vendimin dhe ankimit i ka bashkëngjitur aktet provuese, që tregonin qartë se shkak i rrëzimit të kërkesës, aplikuar nga gjykata e shkallës së parë nuk qëndron. Pas depozitimit të akteve gjykata e apelit ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore dhe, në përfundim, ka vendosur ndyshimin e vendimit të shkallës së parë dhe pranimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të kontratës së kredisë nënshkruar mes dy palëve (përkatësisht, denoncuesit dhe “CredinsBank”). Subjekti ka qartësuar se ka vepruar në përputhje me nenin 465/a të Kodit të Procedurës Civile, duke i dhënë mundësinë palës kërkuese (kredidhënëse) që të paraqesë provat e nevojshme në dobi të gjykimit.

Subjekti ka depozituar:(i) kërkesat ankimore;(ii) shkresat e komunikimit ndërmjet palëve;(iii) vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; si dhe (iv) vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës.

8.3 Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e dhëna si dhe dokumentacionin e depozituar, konkretisht vendimet gjyqësore, por edhe provat mbi të cilat ishte bazuar gjykata e apelit për dhënien e vendimit, vlerëson se subjekti ka qartësuar bazuar në ligj dhe në prova kërkimin e Komisionit. Në arsyetimin e vendimit gjyqësor prej subjektit rezulton të jenë administruar pikërisht provat e cituara nga subjekti si akte të padepozituara në shkallë të parë dhe që, për pasojë, në të gjithë problematikën e denoncuar, trupi gjykues nuk vëren shkelje të natyrës procedurale, ndërsa përse kohë ndaj kësaj vendimmarrjeje parashikohet ankimi i veçantë, atëherë ligjërimi i saj i takon gjykatave të shkallëve më të larta.

9) Denoncim¹²⁷ i paidentifikuar (anonim)

Denoncuesi, ndër të tjera, informon mbi disa problematika të një tjetër subjekti rivlerësimi, ndërsa ndër rreshta identifikon edhe marrëdhënien e kësaj të fundit me subjektin e rivlerësimit, qartëson se në bashkëpunim kanë liruuar kriminelë e po ashtu se subjekti i rivlerësimit vepron duke pasur si sekserë djemtë e tezes së saj të dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda për Trafik Ndërkombëtar droge.

Fakti që denoncuesi është anonim, fakti që nuk identifikon vendimmarrje konkrete që i përkasin subjektit të rivlerësimit dhe, po ashtu, nuk depoziton asnjë dokument, me qëllim analizimin e tyre, Trupi gjykues çmon se nuk ka shkaqe apo rrethana të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

10) Denoncim¹²⁸ i shtetasit R.L.

10.1 Denoncuesi ankohet ndaj vendimit penal nr. ***, datë 23.2.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës në të cilin subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e relatores dhe kërkon inspektimin e veprimtarisë së trupit gjykues të kësaj vendimmarrjeje. Denoncuesi ankohet se prej gjykatës në

¹²⁷Nr. ***prot., datë 10.4.2018.

¹²⁸Nr. *** prot., datë 28.5.2018.

këtë vendimmarrje është zbatuar keq ligji, se nuk ka pasur prova të reja nga administrimi i atyre në shkallë të parë, sikurse e kërkon neni 427/4 i Kodit të Procedurës Penale me ndryshimet e reja, ku dhe ishte shpallur i pafajshëm. Ai ka shpjeguar se në riçeljen e hetimit në shkallë të dytë janë pyetur të njëjtët persona dhe kanë deklaruar ekzaktësisht si në shkallë të parë dhe se është përsëritur shqyrtimi gjyqësor i zhvilluar në shkallë të parë.

10.1.i Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar¹²⁹ subjektit të japë shpjegime në mbështetje të arsyetimit në vendimmarrje, të depozitohet vendimin gjyqësor të shkallës së parë si dhe çdo dokumentacion mbështetës të arsyetimit të saj në vendimmarrje.

10.2 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka kundërshtuar ankimin e denoncuesit duke qartësuar në detaje se nga tërësia e akteve të depozituara në proces gjyqësor në apel ka pasur edhe të tjerë persona në hetim, në ndryshim nga pretendimi i denoncuesit se është vendosur mbi të njajtat prova dhe fakte sikundër është administruar në shkallë të parë, ku denoncuesi ishte shpallur i pafajshëm. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se në këtë rast ka pasur një ndarje të procedimit penal nga prokurori i çështjes, shoqëruar me vendim të prokurorit për pushimin e procedimi penal, para ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr.35/2017, ku para ndryshimeve vendimin e pushimit e merrte vetë prokurori. Po ashtu, ka qartësuar se në gjykimin ku ajo ka marrë pjesë përfaqësuesi i akuzës në apel ka mbajtur një tjetër qëndrim nga ai i shkallës së parë. Subjekti ka qartësuar se pikërisht në shkallë të parë organi i akuzës ka vendosur pushimin e akuzës ndaj të akuzuarve Sh.S., R.L. dhe B.C., për kryerjen e veprës penale “ushtrimi ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike dhe korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga nenet 245/1/2 dhe 259 të Kodit Penal, qëndrim ky që është vlerësuar jo i drejtë dhe i bazuar në prova e ligj nga prokurori i apelit. Prokurori, në apel, ka vlerësuar se pushimi i akuzës i kryer nga prokurori sipas parashikimeve të mëparshme të ligjit procedural para ndryshimeve të ligjit nr. 35/2017 është i gabuar dhe vjen në mospërputhje të plotë me provat e administruara, prova këto të cilat kanë provuar tej çdo dyshimi kryerjen e veprës penale “ushtrimi ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1/2 i Kodit Penal, nga të tre të akuzuarit.

Subjekti, nën këto argumente, ka sqaruar se më tej ka vepruar në përputhje me parashikimin e pikës 4, të nenit 427, të Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se: *“Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast Gjykata e Apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor”*. Në këtë këndvështrim, subjekti ka shpjeguar se kishte vend për çmuarje të ndryshme provash, se kishte vend për përsëritjen e pjeshme të shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë përsëritje ligji procedural penal nuk bën fjalë për marrjen e provave të reja, por për marrjen edhe një herë nga vetë gjykata e apelit dhe shqyrtimin rishtas të provave të shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë pikë denoncuesi e ka kuptuar gabim përcaktimin ligjor të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo dispozitë nuk pengon marrjen e provave të reja në përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, por përsëritja nuk është domosdoshmërisht për prova të reja, ajo nënkupton rimarrjen dhe rishqyrtimin e atyre provave të gjyqësorit. Në këtë rast, prokurori në apel, në mbështetje të ankimit dhe respektim të detyrimit të mësipërm ligjor, ka kërkuar riçeljen e pjeshme të shqyrtimit gjyqësor dhe pyetjen nga trupi gjyqësor në apel të dëshmitarit Sh.S. dhe e vetë të pandehurit R.L., të cilët u pyetën para gjykatës për të gjitha faktet objekt akuze. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të pjeshme dhe në vlerësimin e provave në tërësinë e tyre, bashkë me marrjen e tyre para trupit gjyqësor në apel, u çmua se provohej plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri R.L. ka

¹²⁹Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

përdorur dokumentin e falsifikuar, duke konsumuar elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

Subjekti ka pretenduar se trupi gjykues nuk ka kryer asnjë shkelje procedurale në zbatimin e nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale siç pretendon denoncuesi, mënyra e zgjidhjes së çështjes në themel të sajështë pjesë e meritave të zgjidhjes së çështjes, bindjes së brendshme dhe pavarësisë së gjyqtarit në vendimmarrje dhe nuk duhet të bëhet pjesë e këtij lloj vlerësimi për mua si subjekt. Në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes në themel, i pandehuri ka rrugën ligjore të ushtrimit të rekursit në Gjykatë të Lartë dhe është kjo e fundit që ka atributet për të vlerësuar vendimin e denoncuar.

Subjekti ka depozituar: (i) vendim nr. *** datë 29.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; (ii) kërkesë datë 6.12.2017 të prokurorit në apel, për përsëritje të pjesshme të shqyrtimit gjyqësor; (iii) konkluzione datë 22.2.2017 të prokurorit në apel; dhe (iv) procesverbale të seancave gjyqësore të gjykimit në apel.

10.3 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti dhe pretendimeve të paraqitura, vëren se subjekti ka analizuar dhe argumentuar ligjërisht ecurinë e procesit gjyqësor, më konkretisht, riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor, kërkuar nga organi i akuzës dhe pasqyruar në procesverbalin¹³⁰ e gjykatës datë 6.12.2017, me qëllim pyetjen e dëshmitarëve dhe të pandehurit, si dhe ka administruar më tej faktet dhe provat mbi të cilat është shprehur me vendimin gjyqësor përkatës. Në kushte të tilla, përsa kohë ligjshmëria e vendimit gjyqësor kontrollohet nga gjykatat e shkallëve më të larta, nuk vërehen shkelje apo problematika që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit.

11) Denoncim¹³¹ i shtetasve N.K. dhe S.V.

11.1 Denoncuesit ankohen ndaj vendimit datë 24.10.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës (ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues) me të cilin është prishur vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ku kjo e fundit kishte vendosur zhvillimin e hetimeve ndaj një gjyqtareje me inicialet Dh.B., për shkak se denoncuesit e kishin kallëzuar penalisht në prokurori për korrupsion, shkelje të rënda procedurale, etj. Ata shpjegojnë se prokuroria ka pushuar kallëzimin e tyre dhe, më tej, është vijuar me proceset gjyqësore.

11.1.i Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar¹³² subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë vendimin gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës ku ka qenë në cilësinë e anëtares, si dhe çdo dokument tjetër të vlerësuar në mbështetje të shpjegimeve të saj.

11.2 Subjekti, në shpjegimet e saj, ka sqaruar se: “... kallëzuesit kanë ushtruar kallëzim penal ndaj gjyqtarës Dh. B. për kryerjen e veprës penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak të një vendimmarrjeje të gjyqtarës ku ata kanë qenë palë e paditur gjyqshme. Për sa i përket këtij pretendimi të tyre, nga ana jonë si trup gjykues është gjetur tërësisht i pabazuar, pasi jo vetëm që në vendimmarrjen e saj gjyqtarja është e pavaruar në zgjidhjen në themel të çështjes, por aktualisht (është shprehur ajo), vërtetohet se vendimi i gjyqtarës se kallëzuar, vendim civil me palë paditëse Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, është shqyrtuar për ligjshmëri, zbatim të ligjit procedural civil dhe zgjidhjen e çështjes në themel, nga të gjitha shkallët e gjyqësorit, duke u konfirmuar si vendimi drejtë. Në këto rrethana, nga trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Durrës është gjetur i drejtë konkluzioni i prokurorit. Në vlerësimin e trupit gjykues në këtë çështje, primar ka qenë respektimi i standardit ligjor dhe vlerësimi i drejtë i të dhënave pretenduese, ku fjalët e qytetarëve

¹³⁰Shihni dokumentacionin shoqëruar të subjektit në parashtrimet e saj.

¹³¹ Denoncim nr. *** prot., datë 22.10.2018.

¹³² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

gjqhumbës, nëse nuk kanë asnjë mbështetje në prova faktike, nuk mund kurrsesi të shërbejnë si bazë procedimi penal për gjyqtarin që i ka gjykuar. Një gjë e tillë vetëm do të dëmtonte dhënien e drejtësisë, duke cenuar thellësisht pavarësinë e gjykatës në dhënien e vendimit, nëpërmjet certifikimit të presioneve të palëve”.

Subjekti ka depozituar:(i) vendim nr. ***, datë 4.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; (ii) vendimin nr. ***, datë 24.10.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës; si dhe (iii) deklaratën datë 25.4.2014 të shtetasve N.K. dhe S.V. .

11.3 Trupi gjyqësor, në analizë të shpjegimeve të subjektit, vëren se subjekti ka qartësuar me argumente ligjore bindëse lidhur me vendimmarrjen e trupës gjyqësore ku ka qenë me cilësinë e anëtares. Më konkretisht, konstatohet sesi pasojë e vendimmarrjes së gjykimit të themelit të gjyqtares së kallëzuar, çështje e cila rezultoi e përfunduar në të tria shkallët e gjykimit¹³³ ka marrë zgjidhje edhe çështja gjyqësore e denoncuar. Në kushte të tilla, përsa kohë ligjërimit i vendimmarrjes gjyqësore i takon gjykatave të shkallëve më të larta atëherë ushtrimi i së drejtës ankimore është mjet efektiv në përmbushje të qëllimit të denoncuesit.

12) Denoncim¹³⁴ i shtetasit P.Gj.

Denoncuesi, në ankimin e tij, ankohet ndaj vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Durrës, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupës gjyqësore, duke pretenduar se është vendosur padrejtësisht ndaj tij, në kundërshtim me provat e paraqitura. Denoncuesi ka depozituar vendimet gjyqësore të shkallës së parë nr. ***, datë 5.6.2017 dhe Apelit Durrës nr. *** datë 28.2.2019, rekursin e ushtruar prej tij, si dhe të tjera dokumente.

Në analizë të dokumenteve të depozituara konstatohet se denoncuesi, në vendimet gjyqësore, është në cilësinë e palës së paditur dhe se në të dy vendimet gjyqësore është gjyqhumbës. Njëkohësisht denoncuesi ka ndjekur dhe ushtruar të drejtën e ankimit në shkallët më të larta të gjyqësorit. Në dukje, ankimi kryesisht i referohet themelit të çështjes, çmuarjes së provave të administruara nga gjykata dhe, në kushtë të tilla, duket se nuk ka *indicie* për të ndikuar në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

13) Denoncim¹³⁵ i shtetasit S. K.

Denoncuesi ankohet për një vendim të padrejtë në lidhje me një çështje pronësie të dhënë nga subjekti i rivlerësimit. Ai ankohet se nga subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e gjyqtares, nuk është marrë në konsideratë dokumentacioni i depozituar dhe gjithashtu informon se rastin e ka bërë prezent edhe në emisionin “Fiks Fare”, më 30.11.2018.

Denoncuesi ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 25.7.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe dokumente të tjera që duket të kenë qenë pjesë e provave të administruara në procesin gjyqësor civil.

Në analizë të vendimit gjyqësor konstatohet se denoncuesi nuk është palë ndërgjyqëse, ndërsa ankohet si kufijar i pronësisë trajtuar nga ky vendim. Palë e paditur në këtë vendim janë institucione publike dhe jo individë. Komisioni konstaton se nuk provohet asnjë lidhje midis denoncuesit dhe vendimmarrjes së trupës gjyqësore, ku subjekti i rivlerësimit ka cilësinë e kryetarit të çështjes.

✓ Në kushte të tilla nuk rezultuan *indicie* që denoncimi të çmohet në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

¹³³ Shihni vendimin nr. ***, datë 7.3.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, së bashku me shënimet e vendimmarrjeve të shkallëve më të larta deri në mospranimin e rekursit, akt i depozituar nga subjekti së bashku me parashtrimet e saj.

¹³⁴ Nr. *** prot., datë 25.3.2019.

¹³⁵ Nr***prot., datë 7.5.2019.

14) Denoncim¹³⁶ i shtetases R.Rr.

Denoncuesja ankohet për vendimmarrje të njëanëshme të trupës gjyqësore, ku bën pjesë në cilësinë e njëres prej anëtareve edhe subjekti i rivlerësimit. Denoncuesja, ndër të tjera, ka depozituar vendimin nr. ***, datë 6.03.2019, ndaj të cilit edhe ankohet.

Nga analiza e vendimit konstatohet se denoncuesja në cilësinë e palës ankuese ka kundërshtuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal datë 8.11.2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ishte shprehur mbi kallëzimin e bërë nga denoncuesja ndaj prokurorit E.M. dhe OPGJ me inicialet G. M., për një çështje penale që ata kishin trajtuar mbi denoncimin e znj. Rajmonda Rroshi për shkak të një konflikti të biznesit të saj me të tretë. Gjykata e Apelit, me vendimin e saj, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë sipas të cilit nuk ishte pranuar ankimi i denoncueses. Njëkohësisht, nga aktet e depozituara por edhe nga shpjegimet e denoncueses në ankim nuk konfirmohet nëse ajo ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor.

- ✓ Në këto kushte denoncimi nuk paraqet fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

15) Denoncim¹³⁷ i shtetasit V.L.

15.1 Denoncuesi ankohet ndaj vendimit nr. *** datë 7.6.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës ku subjekti ka qenë në cilësinë e relatores. Denoncuesi denoncon shkelje të ligjit në këtë vendimmarrje, pasi kjo gjykatë ka lejuar shkeljet e bëra në shkallë të parë në kundërshtim me nenin 158/6 të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se nuk i është komunikuar deklarata e mbrojtjes së palëve të paditura dhe as kërkesa e këtyre të fundit për pezullim procesi. Denoncuesi, në tërësi, pretendon se janë shkelur dispozitat mbi njoftimet sipas neneve 128 - 133/b të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, ai sqaron se ka ushtruar rekurs ndaj vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit.

Subjekti ka depozituar:

- vendimin nr. ***, datë 2.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës sipas të cilit është vendosur pezullimi i çështjes objekt gjykimi me paditë denoncuesin për shkak të kërkimit të palës së paditur se njëkohësisht kishte nisur një proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës që kishte lidhje me procesin civil;
- vendimin nr.***, datë 7.6.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e relatores së çështjes; si dhe
- rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të ndërmjetëm të pezullimit.

15.1.i Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, duke mbajtur në vëmendje kërkesën e parashikuar në nenin 158/6 të Kodit të Procedurës Civile në koherencë edhe me germën “dh”, të pikës 2, të nenit 158/a, të po këtij kodi.

15.2 Subjekti, në parashtrimet e saj ndër të tjera, ka shpjeguar se me ndryshimet ligjore të bëra në Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr.38/2017, sipas pikës 1, të nenit 158, të këtij Kodi, i padituri lëshon deklaratën e mbrojtjes, që përfaqëson në vetvete prapësime të tij në lidhje me themelin e pretendimit të kërkesë padisë dhe çdo shkak tjetër ligjor të vlerësuar nga i padituri. Deklarata e mbrojtjes lëshohet në veprimet paraprake të gjyqtarit të vetëm dhe ndryshe nga sa pretendon denoncuesi, në zbatim të drejtë të pikës 6, të nenit 158, në lidhje dhe me germën “dh”, të pikës 2, të nenit 158/a, të Kodit të Procedurës Civile, deklarata e mbrojtjes do të duhet t'i njoftohet palës paditëse, vetëm në rast se nuk provohet ndonjë shkak pezullues për gjykimin e

¹³⁶ Nr. ***prot., datë 21.5.2019.

¹³⁷Nr. *** prot., datë 10.7.2019.

çështjes, atëherë kur gjykata do të vlerësonte se ishin kushtet për kalimin e çështjes në seancë përgatitore sipas nenit 158/b të Kodit të Procedurës Civile dhe vijimin më tej të gjykimit të themelit. Në pikën 1, të nenit 158/b, të Kodit të Procedurës Civile përcaktohen vendimet, të cilat detyrimisht duhet të merren nga gjyqtari në seancë përgatitore në prani të palëve dhe në këto vendime që citon dispozita, nuk përfshihet vendimi për pezullimin e gjykimit. Ndërkohë në pikën 2, të nenit 158/b, të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se për vendime të tjera, ku përfshihet edhe vendimi jopërfundimtar i pezullimit të gjykimit çmohet nga gjykata nëse duhet të kryhet seancë përgatitore dhe të thirren palët (ku do të ishte dhe detyrim i gjykatës për njoftimin e deklaratës së mbrojtjes për palën paditëse) dhe në rastin konkret nuk ishte çmuar një gjë e tillë me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, pasi nga aktet e gjykatës i është provuar plotësisht shkaku pezullues i gjykimit. Denoncuesi e kupton gabim ligjin procedural civil, pasi vetëm nëse nuk do të kishte shkak pezullues dhe duhet të vazhdohej me gjykimin e themelit, gjykata kishte detyrimin e njoftimit të deklaratës së mbrojtjes palës paditëse. Subjekti ka depozituar vendimin nr***, datë 7.6.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës.

15.3 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit në raport me ligjin e zbatueshëm dhe vendimin gjyqësor nr***, datë 7.6.2018 (i vënë në lëvizje nga denoncuesi si paditës nëpërmjet ankimit të veçantë) me të cilin është lënë në fuqi vendimi i ndërmjetëm i pezullimit i marrë në shkallë të parë mbi pezullimin e çështjes nuk konstaton problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit. Trupi gjykues nuk argumenton dhe as zëvendëson logjikën e gjyqtarit në arsyetimin e vendimit. Është e drejta e gjykatës që të veprojë bazuar në ekzistencën e njërit prej kritereve të parashikuara në nenin 297 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me pezullimin e gjykimit të një çështjeje dhe që, në këtë kuptim, përsëri ligjshmëria e kësaj vendimmarrjeje konfirmohet mbi ushtrimin e së drejtës ankimore, sikurse denoncuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të dhënë nga subjekti.

16) Denoncim¹³⁸ i shtetasit P. R.

Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të padrejtë nga Gjykata e Apelit Durrës, ku ndër të tjerë përmend edhe subjektin e rivlerësimit. Ai sqaron se ka kallëzuar një gjyqtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Më tej, denoncuesi sqaron se e ka ankimuar këtë vendim në shkallën e parë të gjyqësorit Durrës, ku dhe i është rrëzuar kërkesa. Në vijim, ai ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës dhe ka kërkuar disa herë me kërkesa të depozituara, përjashtimin e trupës gjyqëse ku sipas tij bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit dhe se kërkesat e tij nuk janë pranuar. Denoncuesi nuk jep të dhëna mbi ecurinë e procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Durrës.

Duke iu referuar kërkesave për përjashtim, por edhe vendimeve të gjyqtarëve për mospranimin e tyre, duket se nuk specifikohen të dhëna konkrete lidhur me arsyet e përjashtimit të subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i çështjes dhe, në këto kushte, duke qenë se denoncimi është parashtruar deri në këtë fazë të procesit gjyqësor, nuk konstatohen problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

17) Denoncim¹³⁹ i shtetasit Th.M.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit penal nr***, datë 31.3.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhënë nga trupi gjykues, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e njërit prej anëtarëve. Denoncuesi ankohet se është dënuar 12 vite me pa të drejtë, në mungesë të çdo prove. Denoncuesi ka depozituar edhe fletën e lirit datë 20.9.2019, të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale Durrës.

¹³⁸ Nr. *** prot., datë 11.9.2019.

¹³⁹ Nr. *** prot., datë 11.10.2019, nr. *** prot., datë 30.12.2019.

Sikurse konstatohet edhe nga dokumentacioni i depozituar, denoncuesi ka kryer vuajtjen e dënimit, pra, thënë ndryshe është ekzekutuar vendimi i dënimit të dhënë nga gjykata.

- ✓ Në kushte të tilla duket se nuk ka rrethana apo *indicie* që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

18) Denoncim¹⁴⁰ i shoqërisë “***” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i saj J.S.

Denoncuesi ankohet për disa procese gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës, që sipas tij janë zhvilluar në mënyrë të njëpasnjëshme për të njëjtën çështje e cila ka përfunduar në favor të palës kundërshtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan, me objekt, kthim shume dhe lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Denoncuesi ankohet se në rastin që ka gjykuar subjekti i rivlerësimit (ka gjykuar çështjen e themelit mbi ankimin e denoncuesit në cilësinë e palës së paditur) ai nuk ka dëgjuar që të shprehej edhe kthimi i çështjes për rigjykim dhe pretendon se është njohur me këtë fakt vetëm kur ka marrë kopje fizike të vendimit. Denoncuesi ka depozituar disa dokumente, ndër të cilët, edhe vendimin gjyqësor nr. ***, datë 20.2.2018, të dhënë nga trupi gjykues me relator të çështjes, subjektin. Denoncuesi ka depozituar edhe një rekurs drejtuar Gjykatës së Lartë.

Nga verifikimi i vendimit gjyqësor rezulton se në dispozitivin e tij gjykata ka cituar shprehimisht prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dërgimineçështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Njëkohësisht, vërehet se gjykata në dispozitiv është shprehur edhe mbi të drejtën e palëve për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Nga verifikimi i rekursit të depozituar konstatohet se denoncuesi nuk është ankuar ndaj vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

- ✓ Në kushte të tilla duket se nuk ka rrethana apo *indicie* të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

19) Denoncim¹⁴¹ i shoqërisë së sigurimit të jetës “***”, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm G. K.

19.1 Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës, ku pjesë e trupit gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi sqaron në parashtrimet e tij se në procesin civil ka qenë në cilësinë e palës së tretë. Ai ka qartësuar se çështja është regjistruar në gjykatë në datën 17.5.2019 dhe vendimi përfundimtar është dhënë më 15.11.2019. Denoncuesi ka bërë prezent shkeljen procedurale të kryer nga trupi gjykues. Konkretisht, denoncuesi evidenton se në datën 11.7.2019 janë dhënë pretendimet me shkrim të çështjes gjyqësore se po në këtë datë gjykata është tërhequr për të marrë vendimin dhe për ta shpallur atë të arsyetuar në datën 19.7.2019 dhe se kjo ka qenë edhe seanca e fundit e zhvilluar nga kjo gjykatë. Denoncuesishpjegon se në seancat e mëtejshme kjo gjykatë megjithëse ishte tërhequr për të shpallur vendimin të arsyetuar nuk e ka shpallur atë për katër seanca të ardhshme, me postulatit për mosformim të trupit gjykues. Denoncuesi parashtron gjithashtu se vendimi është publikuar një muaj pas shpalljes së tij. Mbi këto arsye, denoncuesi shprehet se trupi gjykues ka cenuar besimin e publikut duke shmangur pa asnjë objektivitet zbatimin e afateve procedurale të mirëpërcaktuara në ligj.

19.1.i Për sa më sipër, nisur nga pretendimet e denoncuesit, Komisioni i ka kërkuar¹⁴² subjektit të japë shpjegime, si dhe të depozitojë çdo dokumentacion mbështetës përfshirë edhe vendimin e dhënë në datën 15.11.2019.

¹⁴⁰ Nr. *** prot., datë 18.10.019.

¹⁴¹ Nr. *** prot., datë 24.12.2019.

¹⁴² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

19.2 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka kundërshtuar ankimin e denoncuesit, ka depozituar me cilesinë e provës procesverbalet e seancave gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Në vijim, ka shpjeguar se: “...nga aktet e paraqitura rezulton se në datën 11.7.2019 pasi është relatuar çështja nga relatori dhe janë dëgjuar palët në ankimin dhe shpjegimet e tyre, seanca gjyqësore është ndërprerë duke u shtyrë për më 19.7.2019 jo për shpallje të vendimit të arsyetuar siç pretendon denoncuesi, por me shkakun e njohjes së anëtarëve të trupit gjykues me aktet e dosjes, në raport me pretendimet e palëve, në kushtet që çështja ka qenë voluminoze dhe me dy padi të bashkuara në të njëjtin gjykim (paraqet kompleksitet, ankime voluminoze). Seanca gjyqësore e datës 19.7.2019 është shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, ky gjyqtari D. A. për shkak të mbajtjes së pozicionit të kryetarit të gjykatës (pjesëmarrje në raport me institucionet e tjera si përfaqësues i gjykatës), nuk e kishte të mundur të paraqitej në gjykim. Në kushtet e ndërprerjes së gjykimeve për shkak të lejes vjetore, seanca e radhës është caktuar më 18.9.2019 dhe kjo është seanca gjyqësore, ku trupi gjykues bazuar në kërkesat e nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur të shpallë vendimin e arsyetuar për më 3.10.2019, seancë e cila është shënuar me procesverbal administrativ të sekretarit gjyqësor, pasi dy nga anëtarët e trupit gjykues janë ndodhur në gjykim penal, ku varur nga ngarkesa e skajshme me gjykime, rast pas rasti duhet t’u jepet prioritet gjykimeve penale me të arrestuar. Seanca e radhës është caktuar në datën 25.10.2019, e cila nuk është zhvilluar pasi gjyqtari D. A. ishte me leje vjetore pjesore. Pas këtij momenti, duke llogaritur përfundimin e periudhës së lejes së gjyqtarit D. A. seanca e pazhvilluar për shpalljen e vendimit është caktuar në datën 5.11.2019, datë kur dhe është shpallur vendimi.

Përsa sqarova nëdetaje më sipër dhe rezulton nga procesverbalet e seancave gjyqësore, ndryshe nga sa pretendon denoncuesi, nuk kam kryer asnjë lloj veprimi në cilësinë e anëtarit të atij trupi gjykues, që cenonjë besimin e publikut te drejtësia. Denoncuesi ka shtrembëruar faktet e ndodhura, e gjithë veprimtaria gjyqësore e trupit gjykues ka qenë tejet korrekt, për çdo rast që për shkak të ligjshëm nuk ka funksionuar seanca gjyqësore, janë njoftuar palët sipas ligjit, në procesverbale gjen pasqyrim në mënyrë të detajuar çdo procedurë e ndjekur me vendime të ndërmjetme. Arsyetimi i vendimit është pjesë e relatorit të çështjes. Denoncuesi nuk ka qenë vetë përfaqësues në gjykim, por ka shkruar me cilësinë e drejtorit të palës person juridik, ku përfaqësuesit me autorizim të kësaj pale kanë deformuar prezantimin e fakteve të ndodhura në gjykim”.

Subjekti ka depozituar: procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimin nr. ***, datë 5.11.2019 të Gjykatës së Apelit Durrës.

19.3 Trupi gjykues pas verifikimit të procesverbaleve të seancave gjyqësore, konstaton se subjekti ka sqaruar me vërtetësi e saktësi arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore, deri në vendimarrjen e trupës gjyqësore. Rezulton se në këtë çështje subjekti i rivlerësimi është në cilësinë e anëtares së trupës gjyqësore, pozicion që nuk e lidh drejtëpërdrejtë me veprimet procedurale, lidhur me i) seancën e shpalljes së vendimit, ii) monitorimin e mbajtjes së procesverbaleve nga sekretaria gjyqësore, nga seanca në seancë për të paraqitur me saktësi motivet e shtyrjes në rast mungese të një anëtari të trupës, etj. Nën këto argumente, trupi gjykues nuk konstaton problematika që lidhen apo ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimi.

20) Denoncim¹⁴³ i shtetases J. K.

20.1 Denoncuesja, në cilësinë e përmbaueses gjyqësore në një çështje të ndjekur dhe trajtuar prej saj përgjatë të gjithë procedurës së ekzekutimit të një kontrate bankare, ka sqaruar se pala debitore ka nisur një proces civil për pavlefshmëri të urdhrave të ekzekutimit. Njëkohësisht,

¹⁴³ Nr. *** prot., datë 28.3.2019.

debitori së bashku me hipotekën kanë depozituar edhe kallëzim penal në organin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan ndaj saj, nën akuzën e shpërdorimit të detyrës si përmbareuese, me pretendimin për mosvlerësim të plotë të pasurisë së debitorit që ishte vënë kolateral. Më tej, denoncuesja ka sqaruar se është pushuar kallëzimi penal dhe se mbi ankimin e debitorit/kallëzuesit, gjykata e rrethit gjyqësor ka vendosur pranimin dhe vijimin e hetimeve të mëtejshme. Denoncuesja, megjithëse është ankuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, ka hequr dorë prej tij me qëllim që të vijonin hetimet duke qenë e bindur për moskryerje të ndonjë shkeljeje. Ajo qartëson përsëri se organi i prokurorisë ka vendosur pushimin e çështjes. Më tej, denoncuesja sqaron se përsëri çështja ka vijuar në procese gjyqësore dhe se pas pranimit të kërkesës së përsëritur të debitorit në gjykatën e shkallës së parë dhe ankimit të përsëritur të ushtruar prej saj në apel, subjekti i rivlerësimit ka vendosur me vendimin e saj nr. ***, datë 19.12.2018, lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë nën dispozitivin e kryerjes së hetimeve të mëtejshme nga organi i prokurorisë.

20.1.i Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar¹⁴⁴ subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimet e denoncueses, të depozitojë çdo dokumentacion në mbështetje të argumentimit të saj, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të kësaj çështjeje.

20.2 Subjekti, në parashtrimet e saj, ka kundërshtuar ankimin e denoncueses dhe, ndër të tjera, në shpjegimet voluminoze ka sqaruar se: *“... ndryshe nga sa pretendon denoncuesja, në këtë rast çështja penale në ngarkim të saj nuk është kthyer për kryerjen e mëtejshme të hetimeve nga organi i prokurorisë, por siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë në vendimin e ankimit, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, nga trupi gjykues ku kam qenë me cilësinë e kryesueses, në këtë rast Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan është urdhëruar të formulojë dhe ngrejë akuzë ndaj denoncueses, duke e marrë atë të pandehur për kryerjen e veprës penale ‘shpërdorim detyrë’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në vlerësimin e gjykatës, hetimet në këtë rast kanë qenë të plota dhe nga tërësia e njoftimeve mbi faktet që japin provat e grumbulluara, provohen plotësisht elementët e figurës së veprës penale të mësipërme dhe personi nën hetim J.K. duhet të merrej e pandehur. Në këtë rast prokurori i ka kryer hetimet plotësisht, por nuk i konsideron veprimet e kësaj shtetaseje në nivelin e veprës penale. Prokurori pavarësisht se konstaton ekzistencën e faktit, nuk e quan atë vepër penale, duke vlerësuar gabim provat. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit në këtë rast, kanë marrë vendimin si rezultat i çmuarjes së provave ndryshe nga përfaqësuesi i akuzës që ka kërkuar pushimin e çështjes dhe në këtë kuptim, nuk mund të vlerësohet vendimi, pasi vjen ndesh me parimin e pavarësisht së gjykatës në vendimmarrje dhe bindjes së saj të brendshme krijuar si rrjedhojë e çmuarjes së provave”.*

Subjekti ka pasqyruar vendimmarrjet e gjyqësorit, ku sipas saj ndryshe nga sa pretendon denoncuesja, nuk bëhet fjalë për vijim të mëtejshëm të hetimit, i cili ishte plotësuar me vendim të mëparshëm të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ndërsa trupi gjykues që ka kryesuar ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila ka konkluduar se në këtë rast hetimi ka qenë i plotë dhe nëpërmjet provave provohen plotësisht elementët e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe, për këto arsye, kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal me të drejtë nuk është pranuar, duke u urdhëruar prokurori të formulojë akuzën në ngarkim të personit J. K.i, ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi hetimet janë të plota dhe ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës.

¹⁴⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

Subjekti ka bërë një përshkrim të plotë të pozicionit të punës së kësaj shtetaseje si përmbaruese gjyqësore private në raport me të gjithë historikun gjyqësor të pronësisë për të cilën ajo është involvuar me funksionin e saj, në dobi të institucionit kredidhënës.

Subjekti, lidhur me statusin e kësaj çështjeje gjyqësore, ka qartësuar se denoncuesja J.K. ka shkuar për gjykim me akuzën e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 26.6.2020 e ka deklaruar të pafajshme. Subjekti ka depozituar vendimin e shkurtuar të rastit, ndërsa ka shpjeguar se ligjshmëria mbi të i përket gjykatave të shkallëve më të larta dhe nuk mund të cenohet në vlerësimin e saj. Subjekti, gjithashtu, është rezervuar për të sqaruar mbi vendimmarrjen aktuale pasi qartëson se nuk disponon vendimin e plotë të zbardhur. Subjekti ka depozituar:(i) vendimin nr***, datë 21.5.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, duke e trajtuar këtë akt si provë indirekte në mbështetje të pretendimeve të saj; si dhe (ii) ka depozituar shkurtimin e vendimit nr. *** akti, datë 26.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

20.3 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, në raport me provat e administruara përgjatë hetimit administrativ, por edhe në prapësime, konkludon se vendimmarrja e subjektit është atribut i gjyqësorit bazuar mbi prova, fakte dhe bindje të brendshme sigurisht brenda kufijve që lejon ligji, sikurse rezulton edhe në rastin e vendimit nr. ***, datë 21.5.2019 po të Gjykatës së Apelit Durrës, gjykuar po nga subjekti i rivlerësimit (me cilësinë e kryesuese së trupit gjykues), ku denoncuesja ka qenë pjesë e procesit gjyqësor dhe për shkaqet e arsytet e argumentuara në vendimmarrjen e shkallës së parë dhe të dytë, vendimi ka rezultuar në favorin e saj. Në kushtet kur kryesisht trajtohen pretendime të themelit të çështjes, hetimi dhe vlerësimi del përtej kompetencave të parashikuara në nenin 72/4 të ligjit nr.96/2016. Në të tilla rrethana, vlerësimi i ligjshmërisë së vendimmarrjeve i takon gjykatave të shkallëve më të larta dhe, për pasojë, në këtë rast objekt shqyrtimi, nuk evidentohen problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

21) Denoncim¹⁴⁵ i shtetases E.M.

Denoncuesja ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 9.1.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Denoncuesja pretendon për vendim të padrejtë të dhënë nga gjykata lidhur me veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor për ekzekutimin e pensionit ushqimor që ajo përfiton për rritjen dhe edukimin e fëmijës.

Denoncuesja ka depozituar vendimet gjyqësore të shkallës së parë dhe apelit Durrës, përgjigjen e dhënë nga Ministria e Drejtësisë të cilës gjithashtu i është drejtuar me ankesë për veprimet e padrejta sipas saj të kryera nga ana e përmbaruesit gjyqësor, aktet përmbarimore, etj.

Në analizë të dokumentacionit të depozituar konstatohet se Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Po ashtu, edhe Ministria e Drejtësisë në përgjigjen e saj i ka konfirmuar ankueses se pretendimet e saj ndaj përmbaruesit gjyqësor nuk qëndrojnë pasi ka rezultuar se pagesat në favor të fëmijës së mitur janë kryer në mënyrë të rregullt në llogarinë bankare të saj nga ish-bashkëshorti dhe njëkohësisht edhe organi i prokurorisë ka vendosur mosfillimin e çështjes pas kallëzimit të bërë nga ankuesja në ngarkim po të përmbaruesit gjyqësor për shpërdorim detyre. Nga aktet e depozituara nuk rezulton që denoncuesja të ketë depozituar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

✓ Në tërësi të parashtrimeve në ankim, por edhe provave shoqëruese nuk vërehen problematika të natyrës procedurale lidhur me vendimmarrjen dhe, për pasojë, denoncimi nuk ndikon në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

¹⁴⁵ Nr. *** prot., datë 10.2.2020, nr. *** prot., datë 10.1.2020, nr. *** prot., datë 4.2.2020, si dhe denoncim me e-mail datë 27.4.2020.

22) Denoncim¹⁴⁶ i shoqërisë me administrator me initiale A. Ç.,

Denoncuesi ankohet se ka rënë në dijeni të seancës gjyqësore që pritej të zhvillohej në apel si e caktuar në kundërshtim me aktet normative të nxjerra për shkak të situatës së Covid – 19. Ndër të tjera, parashtron se janë paditur nga shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “shpërblim i dëmit pasuror” dhe se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e saj nr. ***, datë 24.12.2018 ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë, etj. Mbi ankimin e depozituar nga OSHEE-ja, Avokatura e Shtetit dhe disa kompani sigurimesh, çështja është duke u gjykuar në gjykatën e apelit, ku në përbërje të trupit gjykues është edhe subjekti i rivlerësimit. Më tej, denoncuesi sqaron se është zhvilluar një seancë gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës, në datën 29.1.2020, ku dhe kanë kërkuar riçeljen pjesërisht të hetimit duke parashtruar disa arsye, seancë e cila është shtyrë për mosformim të trupit gjykues, ndërsa është caktuar për t’u zhvilluar në datën 18.3.2020. Denoncuesi ka sqaruar se për shkak se u pezullua veprimtaria e gjykatave nëpërmjet vendimit të KLGJ-së, deri më 22.4.2020 dhe, gjithashtu, veprimtaritë insitucionale u normuan edhe nga akti normativ nr. 9, datë 25.3.2020, ku edhe u parashikua shtyrja e seancave gjyqësore për shkak të pandemisë Covid -19, nuk mund të caktohet një seancë në këtë situatë pasi nuk gjendej (shprehet ai) në kushtet e ndonjë çështjeje me natyrë të ngutshme. Denoncuesi duket se i paraprin me këtë denoncim ndonjë seance gjyqësore të hamenduar se do të caktohet apo zhvillohet, pasi ai nuk specifikon nëse është lënë një e tillë, në kushtet kur veprimtaria gjyqësore rezulton të jetë e pezulluar. Ai kërkon verifikim të problematikës nga ILD-ja dhe vlerësim nga KLGj-ja për mosrespektimin e akteve të këtij të fundit nga gjykata dhe në këtë këndvështrim kërkon edhe ndjekjen e procesit të rivlerësimit duke konsideruar edhe shqetësimin e paraqitur prej tij në ankim.

- ✓ Trupi gjykues, nga parashtrimet e paraqitura, konstatoi se çështja është në gjykim e sipër dhe për pasojë zbatohet pika 2 (fjalja e fundit) e germës “E” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

23) Denoncim¹⁴⁷ i shoqatës “****”

Përfaqësuesi i shoqatës në këtë denoncim ankohet ndaj zvarritjes së procesit gjyqësor civil, në Gjykatën e Apelit Durrës, duke qartësuar se në trupin gjykues subjekti i rivlerësimit mban cilësinë e anëtares. Denoncuesi ka qenë në cilësinë e palës paditëse me objekt lirim dhe dorëzimin e një godine, pronë e shoqatës. Ai kryesisht ankohet mbi vonesën e treguar në zbardhjen e vendimit gjyqësor të marrë nga Gjykata e Apelit Durrës në datën 6.2.2020 deri në depozitim të denoncimit (maj 2020) dhe për këtë bën përgjegjës relatorin e çështjes.

Në të tilla kushte konstatohet se problematika e përcjellë në denoncim, lidhur me zbardhjen e vendimit gjyqësor, nuk ka lidhje me rolin dhe kompetencën e subjektit të rivlerësimit.

24) Denoncim¹⁴⁸ i shtetasit R.D.

Denoncuesi (me cilësinë procedurale të të dëmtuarit apo viktimës në kryerjete veprës penale në çështjen për gjykim në ngarkim të të pandehurve R.K., E. H., I. P., A. L., etj., akuzuar për veprën penale “vjedhje” me pasoja të rënda dhe “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 134/3 dhe 348 të Kodit Penal), parashtron ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. ***, datë 27.11.2019, i cili ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Denoncuesi pretendon se nëvendimmarrjet e dhëna “kanë ndikuar elementë të tjerë” dhe jo zbatimi me korrektësi i ligjit. Ai pretendon se vendimmarrjet janë marrë në shkelje flagrante të ligjit duke cenuar të drejtën e tij për një proces të rregullt

¹⁴⁶ Nr. *** prot., datë 16.4.2020.

¹⁴⁷ Nr***prot., datë 27.6.2020.

¹⁴⁸ Nr. ***prot., datë 16.6.2020.

ligjor nëpërmjet garantimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, parimin e barazisë para ligjt, të sigurisë juridike, etj. Denoncuesi ka depozituar vendimet gjyqësore, përkatësisht, vendimin nr. ***, datë 8.7.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendimin nr. ***, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Nga verifikimi i akteve rezulton se subjekti i rivlerësimit në çështjen objekt gjykimi është në cilësinë e anëtares së trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Durrës. Çështja penale i përket kallëzimit të bërë nga denoncuesi ndaj disa shtetasve, punonjës të një banke të nivelit të dytë, të cilët i akuzon se në bashkëpunim me administratorin e një shoqërie (“****” sh.p.k.) kanë krijuar mundësinë e përvetësimit të padrejtë të një kredie të përfituar nga denoncuesi si administrator i një tjetër shoqërie (“****” sh.p.k.) në dëm të interesave të këtij të fundit. Nisur nga pretendimet e denoncuesit dhe dokumentacioni i administruar, nuk vërehen problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, pasi kryesisht ato gjejnë zgjidhje në shqyrtimin dhe gjykimin e shkallëve më të larta të gjyqësorit nëpërmjet ushtrimit të së drejtës për ankim.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se:(i) nuk u provuan dyshimet e DSIK-së; (ii) u provua se subjekti kishte deklaruar në funksion të raportit të DSIK-së, marrëdhënien me të afërmit e saj/djemtë e tezes, të dhënat e tyre personale, lidhjen e gjakut, si edhe veprën penale për të cilën janë akuzuar e dënuar dhe që, për pasojë, ndaj saj nuk mund të zbatohet ndonjë masë penalizuese brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr.84/2016.
- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr.84/2016, çmon se dërgimi për inspektim i njëres prej dosjeve të gjykuara nga subjekti me cilësinë e anëtares së trupës gjyqësore, arsyetuar në pikën III/2.a, është e pamjaftueshme¹⁴⁹ për të arritur në vlerësimin e saj, sipas germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr.84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit

¹⁴⁹ Nenin E, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuara për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”;- nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; - vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 e Komisionit të Venecias).

ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Durrës.
2. Transferimin e çështjes gjyqësore, regjistruar me nr. ***, datë 9.9.2016, përfunduar me vendimin nr***, datë 5.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.8.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta